

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# GJYKATA EUROPIANE E AUDITUESVE 40 VJET AUDITIM PUBLIK 1977-2017

*Seria: botime KLSH - 13/2017/80*

Tiranë, 2017



GJYKATA  
EUROPIANE  
E AUDITUESVE  
**1977-2017**  
**40 VJET**  
AUDITIM  
PUBLIK





*Titulli:*

Gjykata Europiane e Audituesve  
1977 – 2017  
40 Vjet Auditim Publik

*Redaktorë:* Ina Sokoli  
Redi Ahmetllari

*Përkthimi u realizua nga audituesit e KLSH-së:*

Brenton Kotorri, Dorel Balliu, Eni Kabashi, Erieta Kellici, Irma Idrizaj,  
Joana Troçe, Krisi Anastas dhe Redina Karapici

*Formatoi:* Bledi Dervishaj

Seria: botime KLSH – 13/2017/80

ISBN: 978-9928-159-64-9

Shtypur në Shtypshkronjën “Classic Print”

Tiranë, 2017



*Ky botim është realizuar në kuadër të kremtimit të 40 vjetorit të Gjykatës Evropiane të Audituesve në tetor të vitit 2017. Ky botim është përgatitur nga Rosmarie Carotti, ish kryeredaktore e ECA Journal dhe është vijimësi e pasqyrit të dokumenteve të publikuara për 35 vjetorin e Institucionit. Bazuar në dokumentet e brendshme dhe intervistat e dhëna tek redaktori, ky publikim përmbledh, pa u shterur, zhvillimet kryesore në ECA që nga themelimi i saj dhe i sjell në jetë me intervista dhe dëshmi të reja.*

*Ky botim në ditëlindjen e 40 vjetorit të ECA ka qëllime informimi dhe nuk duhet të merret si një interpretim zyrtar i rolit dhe punës së Gjykatës Evropiane të Audituesve në këto vite.*

*Falënderime të veçanta për të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë libër duke ndarë njohuritë dhe përvojën e tyre profesionale.*



---

*Rosmarie Carotti*

*ish kryeredaktore e revistës*

*ECA*

---



## PËRMBAJTJA

### NË VEND TË HYRJES PËR BOTIMIN NË SHQIP

<b>ECA – Gardiani i interesave financiare të qytetarëve të BE-së</b> .....	11
Bujar LESKAJ, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit	

### PARATHËNIE

Klaus-Heiner LEHNE, President i ECA .....	14
Eduardo RUIZ GARCIA, Sekretari i Përgjithshëm i ECA .....	17

### 1. HYRJE

<b>Një hap i rëndësishëm në ndërtimin e Bashkimit Evropian</b> .....	21
Rosmarie Carotti	
<b>Dëshmi</b>	
<b>Deklarata e Limës dhe Gjykata Evropiane e Audituesve</b> .....	23
Giorgio Clemente, ish-anëtar i ECA dhe zëvendëskryetar i <i>Gjykatës Italiane të Llogarive</i>	
<b>Një Gjykatë e Audituesve për Komunitetin?</b> .....	26
Rosmarie Carotti	
<b>Presidentët e ECA</b> .....	28
Rosmarie Carotti	

### 2. ZHVILLIMI I AUDITIMIT NË ECA

<b>Modeli i zgjedhur për ECA-n</b> .....	33
Rosmarie Carotti	
<b>Dëshmi</b>	
<b>Unë isha njeriu i cili me gjithë zemër mbrojti auditimin e bazuar në sisteme dhe menaxhim të shëndoshë financiar</b> .....	40
André J. Middelhoek, ish-Anëtar dhe President i ECA	
Intervistë nga Rosmarie Carotti	
<b>ECA si auditues i jashtëm</b> .....	45
Rosmarie Carotti	
<b>Dëshmi</b>	
<b>Procesi i integritetit Evropian</b> .....	47
<b>"Gjykata e Audituesve duhet të pranohet si auditor i jashtëm"</b>	
André J. Middelhoek, ish-Anëtar dhe President i ECA	
Intervistë nga Rosmarie Carotti	



<b>Pavarësia, kolegjaliteti dhe vazhdimësia</b> .....	50
Jan O. Karlsson, ish-anëtar dhe president i ECA Intervistë nga Rosmarie Carotti	
<b>Organet e auditimit gjithashtu duhet të japin këshilla të mira</b> .....	53
Bernhard Friedmann, ish-anëtar dhe president i ECA-së Intervistë nga Rosmarie Carotti	
<b>Gjykata e Audituesve dhe kuadri ligjor i Bashkimit Evropian</b> .....	57
Shërbimi Ligjor i ECA	
<b>Zgjerimi i vitit 2004 i Bashkimit Evropian dhe ndryshimet e tjera për ECA</b> .....	60
Rosmarie Carotti	
<b>Dëshmi</b>	
<b>Polonia, tigri i ri i Evropës</b> .....	61
Jacek Uzcikiewicz, Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë (NIK) dhe ish anëtar i ECA Intervistë nga Rosmarie Carotti	
<b>Menaxhimi i ri publik 2011</b> .....	64
Rosmarie Carotti	
<b>Llogaridhënia</b> .....	66
Rosmarie Carotti	
<b>3. AUDITIMI I EVROPËS</b>	
<b>Vlera e shtuar e punës së ECA</b> .....	68
Rosmarie Carotti	
<b>Dëshmi</b>	
<b>Bashkëpunimi në auditime mes Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të Vendeve Anëtare</b> .....	74
Jacek Mazur, Këshilltar i Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK)	
<b>Gjykata Evropiane e Audituesve dhe marrëdhëniet e saj me Gjykatën Italiane të Llogarive në kontekstin evropian</b> .....	91
Pietro Russo, anëtar i ECA	
<b>Të drejtat e reja të auditimit pas krizës financiare</b> .....	99
Rosmarie Carotti	

Dëshmi

**Auditimi i programeve të asistencës financiare** .....101  
 Kamila Lepkowska, Auditues - Rregullimi i tregjeve dhe ekonomia konkurruese

**Si të kryhen auditimet e Unionit Bankar Evropian**.....106  
 Matthias Blaas, Auditues - Rregullimi i tregjeve dhe ekonomia konkurruese

**4. ECA E PARË NGA BRENDA**

Dëshmi

**Një vështrim prapa** .....116  
 Vítor Manuel Caldeira, ish-anëtar dhe president i ECA-së

Dëshmi

**Një vështrim përpara: perspektiva për një auditues të ri** .....119  
 Olivier Prigent, Auditues i ECA  
 ECA si nënkryetare e Komitetit të Standardeve Profesionale INTOSAI  
 Ekipi i KSP i ECA-së

**Drejtoria e Përkthimeve dhe Shërbimeve Gjuhësore:  
 40 vjet në shërbim të Gjykatës Evropiane të Audituesve**.....125  
 Gailë Dagilienë, Drejtore në ECA

**40 vjet IT në ECA**.....129  
 Magdalena Cordero, Drejtore në ECA

**5. ECA E PARË NGA JASHTË**

Dëshmi

**40 vjet histori: datat, njerëzit, partnerët**.....139

Dr Arūnas Dulkys, Auditues i Përgjithshëm i Republikës së Lituaniës

**Të punojmë së bashku për të zhvilluar dhe përmirësuar Standardet**

**Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit** .....144

Lone Strøm, Auditues i Përgjithshëm, Danimarkë

**Zyra Kombëtare e Auditimit në Mbretërinë e Bashkuar** .....148

Sir Amyas Morse, Auditues i Përgjithshëm NAO, Britani e Madhe

**Gjykata e Llogarive e Luksemburgut - bashkëpunimi dhe miqësia** .....149

Isabelle Nicolay, Zyrtare Ndërlidhëse e Gjykatës së Llogarive të Luksemburgut

<b>Zhvillimi i Gjykatës Evropiane të Audituesve të parë nga Alumni që punon në SNK</b> .....	151
ECA Alumni që punojnë në Komisionin e SNK	

<b>Prezenca e ACCA në Evropë</b> .....	159
Maggie McGhee, Drejtore e ACCA	

## **6. RRUGA PËRPARA**

### **Dëshmi**

<b>Vazhdimësia dhe ndryshimi ndërmjet institucioneve</b> .....	163
Dr Ingeborg Gräßle, Kryetar i Komisionit për Kontrollin Buxhetor, MEP	

<b>Përvjetori i 40-të i ECA-së, Gjykatës Evropiane të Audituesve</b> .....	165
Martina Dlabajová, nënkryetare e Komitetit të KE-së, MEP	

<b>Vitet e ardhshme të raportit vjetor</b> .....	168
Lazaros S. Lazarou, anëtar i ECA	

<b>Strategjia e ECA për 2018-2020: Nxitja e besimit përmes auditimit të pavarur</b> ....	173
Gaston Moonen dhe Andreas Bolkart, Drejtorja e Presidencës, ECA	

<b>Tabela: Anëtarët e Gjykatës Evropiane të Audituesve që nga viti 1977</b> .....	178
---	-----

<b>Kolegji ECA më 7 shtator 2017</b> .....	179
--	-----

## NË VEND TË HYRJES PËR BOTIMIN NË SHQIP

### BUJAR LESKAJ

Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

#### *ECA-Gardiani i interesave financiare të qytetarit të BE-së.*



*Bujar Leskaj  
Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit*

Në tetor 1977, 40 vjet më parë themelohej Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), struktura përgjegjëse për kontrollin dhe auditimin e fondeve dhe programeve të Bashkimit Evropian për Shtetet e tij Anëtare dhe për vendet candidate e aspirante për t'u anëtarësuar në BE.

Që në ditët e para të aktivitetit të tij, ky institucion, që konsiderohet një nga pesë institucionet themelore të Evropës së Bashkuar, së bashku me Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës, Komisionin Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane, ka vepruar si një ruajtës, gardian i pavarur i interesave financiare të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Me

kalimin e viteve, Gjykata provoi të jetë një gardiane tejet profesionale dhe thellësisht e bindur në misionin dhe vlerat e saj.

Çdo vit, ECA kontrollon dhe auditon shpenzimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet të buxhetit të BE-së, në nivel të mbi 140 miliardë euro, ose rreth 285 euro për çdo qytetar të komunitetit, si fonde dhe programe të përbashkëta të Bashkimit Evropian. Shpenzimet e BE-së janë një instrument i rëndësishëm për arritjen e objektivave të politikave të Evropës së Bashkuar.

Ndërsa BE, pas Brexit dhe kërkesës për pavarësi të Parlamentit rajonal të Katalonjës në Spanjë, po ballafaqohet me sfida edhe më të mëdha dhe presion të shtuar mbi financat e saj publike, roli i ECA-së merr sot një rëndësi në rritje. Gjykata paralajmëron për rreziqet, ofron siguri dhe jep udhëzime për politikëbërësit e BE-së, të cilët e kanë domosdoshmëri të marrin këshilla të besueshme se si të përmirësojnë menaxhimin e financave publike. ECA përpaket të sigurojë që qytetarët e BE-së të jenë të mirëinformuar dhe të dinë sa më shumë dhe qartë si shpenzohen paratë e tyre. Ky është thelbi i kontributit të ECA-s në forcimin e legjitimitetit demokratik dhe qëndrueshmërisë së Bashkimit Evropian.

Nëpërmjet auditimeve të saj, ECA ia ka arritur që të përmirësojë menaxhimin financiar të BE-së. Ajo promovon fuqishëm llogaridhënien dhe transparencën në menaxhimin e fondeve të Unionit, duke synuar të jetë një organizatë efiçente në pararojë të zhvillimeve në auditimin publik dhe në administratën publike.

Në fjalën e hapjes së Takimit Jubilar të 40 Vjetorit më 12 tetor 2017 në Luksemburg, Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Klaus-Heiner Lehne u shpreh se “ECA

*është e vendosur të sigurojë që çdo euro e shpenzuar në nivel evropian të sjellë vlerë të shtuar në jetën e qytetarëve, duke qenë një zë i pavarur për të evidentuar progresin kur gjërat shkojnë mirë, por edhe duke bërë publike të vërtetat e pakëndshme kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç duhet<sup>1</sup>.*

Në përpjekjet e saj që fondet e BE-së të arrijnë vlerën për para (value for money), ECA ka kontribuar, duke dhënë mendimin e saj të ekspertizës përmes qindra raporteve dhe opinionëve objektive dhe të rëndësishme të auditimit. Në raportet më të fundit të zbatimit të buxhetit vjetor, Gjykata ka bërë thirrje për një qasje krejtësisht të re për investimet dhe shpenzimet e BE-së. Ajo tërheq vëmendjen kundrejt ecurisë së politikave dhe programeve të Unionit, duke zhvendosur fokusin e raportimit financiar nga më shumë informacione rreth çmimit të shpenzimeve të BE-së drejt më shumë informacione rreth vlerës së parasë së harxhuar. Ligjvënësit e BE-së duhet të sigurojnë që jo vetëm fondet e BE-së të shpenzohen në përputhje me kuadrin rregullator, por edhe që rezultatet e synuara të arrihen. Kjo është një këshillë dhe qasje e rekomanduar për të gjithë ne, SAI-t në Evropë, gjatë hartimit të raporteve tona vjetore lidhur me zbatimin e buxhetit faktik të Shtetit.

Në këtë mënyrë, ECA u tregon politikbërësve të BE-së me fuqinë më bindëse se si financat e BE-së mund të menaxhohen më mirë dhe të bëhen më të përgjegjshme për qytetarët. Llogaridhënia dhe transparenca në menaxhimin e parave të taksapaguesve evropianë është ajo që ka rëndësi për Gjykatën Evropiane të Audituesve. Me “armatën” e saj të raporteve vjetore, raportet specifike vjetore, raportet e veçanta dhe raportet e aktiviteteve, ECA kontribuon në mënyrë efektive në profesionin e auditimit më të lartë publik.

Përveç të qenit një element thelbësor i zinxhirit të llogaridhënies së BE-së, ECA nxit fuqishëm bashkëpunimin midis institucioneve të larta të auditimit, bazuar në moton e INTOSAI-t "Experientia mutua Omnibus prodest (Nga eksperiencia e përbashkët fitojnë të gjithë)". Ajo bashkëpunon në mënyrë efektive, sepse beson në vlerat dhe mesazhet e Deklaratës së Limës, të quajtur ndryshe Magna Carta, Kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit, të miratuar në Kongresin INCOSAI I IX-të të INTOSAI-t në vitin 1977.

ECA ka ditur të jetë një promotore e fuqishme e zhvillimit profesional të SAI-ve evropiane, sidomos të atyre në vendet kandidatë dhe aspirante për kandidatë në BE. Pjesëmarrja e ECA-s në auditimet e përbashkëta ose të koordinuara me SAI-t e tjera në Evropë, por edhe në të gjitha Grupet e Punës dhe Task Focat e EUROSAI-t, i ka sjellë vlerë të shtuar auditimeve publike në të gjithë Evropën.

---

<sup>1</sup> [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/speech-CONTACT-COMMITTEE/speech-CONTACT-COMMITTEE\\_EN.pdf](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/speech-CONTACT-COMMITTEE/speech-CONTACT-COMMITTEE_EN.pdf)

Për ne si KLSH, si SAI, të kemi ekspertë të ECA-s në auditimet tona është si një ëndërr e tjerrur gjatë dhe shpresojmë që një ditë kjo ëndërr do të realizohet. Me këtë botim, falënderojmë ECA-n për programin e internship-eve që ka afruar vitet e fundit për audituesit tanë. Audituesit e KLSH-së pjesëmarrës në praktikën e punës së ECA-s përfaqësojnë një pjesë ndër më cilësoret të trupës sonë audituese. Ne i angazhojmë ata në auditimet më të rëndësishme dhe në prodhimin e dokumenteve strategjike të KLSH-së. Nëpërmjet këtij botimi në shqip, audituesit tanë, por edhe lexuesi i interesuar shqiptar, njohin Gjykatën Evropiane të Audituesve, institucionin-gardian të parasë së taksapaguesve evropianë, misionin, vlerat dhe zhvillimet e saj në katër dekada aktivitet intensiv e të suksesshëm.

*Bujar Leskaj*



## PARATHËNIE

KLAUS-HEINER LEHNE,  
President i ECA (European Court of Auditors – Gjykata Europiane e Audituesve)

Më 13 shtator 2016, anëtarët e ECA-s zgjodhën Klaus-Heiner Lehne-n, anëtarin gjerman, që të shërbente si President për një mandat trevjeçar. Ai e mori detyrën më 1 tetor 2016.



*Klaus Heiner Lehne  
President i ECA*

Teksa Gjykata Europiane e Auditimit festoon katër dekada të ekzistencës së saj, është me rëndësi të shohim se mbi shpatullat e kujt po qëndrojmë. Anëtarët dhe stafi i mëparshëm i Gjykatës, ku secili prej tyre ka dhënë kontributin e vet për ta bërë këtë institucion atë që ne shohim sot.

Cilat ishin sfidat e tyre dhe si mundën ata t'i tejkalonin këto sfida?

A janë të aplikueshme për kontekstin e sotëm, mjetet që ata përpunuan dje? Duke qenë se jemi një institucion i vogël dhe i ri, a është ende me ne “shpirti i themelimit” të Gjykatës? Si ka ndryshuar roli i audituesit dhe pritshmëritë që qytetarët kanë ndaj tij, gjatë këtyre 40 viteve të fundit, dhe a jemi përshtatur ne me sukses? Në fjalë të tjera, vokacioni ynë mund të jetë të mbajmë vesh (audire), por a mundet gjithashtu ne të dëgjojmë? A e kemi gjetur ne ekuilibrin e duhur midis auditimit të performances dhe atij financiar? Sa këmbëngulëse është Gjykata në përktimin e rekomandimeve të saj në realitetin në terren? Ose për ta pare më gjerë, a është e mundur të përcaktojmë se çfarë impakti ka pasur Gjykata “Fuqi e Butë” në drejtimin që ka marrë Bashkimi Europian?

Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve dhe të mësuarit nga e kaluara jonë do të jetë gjithashtu një mundësi për të hartuar një trajektore për të ardhmen.

BE është e rrethur nga sfida - qoftë humbja e besimit dhe perceptimi midis shumë qytetarëve se ajo është disi kali i trojës së globalizimit dhe rreziqet e tij, negociatat mbi tërheqjen e një shteti anëtar, pas një krize të rëndë ekonomike dhe financiare, dhëkërcënimet e paraqitura nga fuqitë e huaja që synojnë të provojnë se modeli evropian i paqes, integrimi, demokracia liberale dhe të drejtat e njeriut duke përfshirë lirinë e shprehjes është një dështim.

Për shumë evropianë të brezit tim të lindur në vitet pas Luftës së Dytë Botërore, bashkimi i Europës do të thoshte në radhë të parë premtim për paqe. Megjithatë, një premtim i tillë për paqe nuk flet në të njëjtën mënyrë ndaj një tridhjetë vjeçari që u bë i papunë prej krizës ekonomike sikurse ndaj një tetëmbëdhjetë vjeçari i cili do të ketë të drejtën e votës në zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin Europian. Ne sidoqoftë nuk duhet ta harrojmë kurrsesi premisën themelore të Bashkimit, dhe mungesën e precedentit nëpër botë e në

histori për ndërtimin e një demokracie ndërkombëtare, bashkë me institucionet dhe shtetet e tjera anëtare të një narrative bashkëkohore për Europën – Cilën Europë duam për fëmijët tanë, më shumë se sa çfarë na ndihmon Bashkimi që të shmangim.

Në momentin kur retorika politike ndonjëherë është duke arritur nivelin më të lartë në mbarë botën, ku artet e bllokimit, keqinformimit dhe manipulimit janë bërë gati kudo në mendjen e publikut dhe sidomos në internet, qytetarët tanë presin që qeveritë të punojnë bashkarisht dhe me efektivitet, e të japin rezultate konkrete dhe jo rezultate në tym. Dhe kjo është hapësira ku Gjykata e Audituesveka një rol të qartë për të luajtur, si kujdestar i interesave të qytetarëve, si një zë i pavarur i aftë për të siguruar që gjërat të funksionojnë, por gjithashtu theksojnë të vërteta të pakëndshme ku gjërat nuk po funksionojnë siç duhet.

Megjithëse buxheti i BE - së është relativisht i vogël në krahasim me shpenzimet publike në Shtetet anëtare, qytetarët me të drejtë presin që çdo euro i shpenzuar në nivel të BE-së të sjellë vlerë të shtuar krahasim me shpenzimet e të njëjtit euro në nivel kombëtar. Sikurse parimi i subsidiaritetit duhet të jetë parulla jonëkur bëjmë ligje, kështu duhet të jetë edhe kur të vendosim se si të shpenzojmë paratë nga buxheti i përbashkët.

Për më tepër, menaxhimi i nivelit të lartë i krizës që u zhvillua në dhjetë vitet e fundit nëfusha të ndryshme, për shembull për të mbështetur financat e shteteve anëtare gjatë krizës, për të mbështetur shtetet që kanë pritur refugjatët dhe emigrantët, ose në mbështetjen e disa vendeve të treta, morën njëshije dalluese ndërqeveritare. Kjo ka bërë rolin e Gjykatës edhe më sfiduese, me shfaqjen e një sërë fondesh dhe instrumentesh financiare - disa do të thoshin një 'Galaktikëbuxhetesh' - jo të gjitha që i nënshtrohen të njëjtave rregulla dhe llogaridhënie, qoftë nga parlamentarët ose nga audituesit. Si President i Gjykatës së Audituesve, unë qëndroj për "Metodën e komunitetit" - jo vetëm sepse është legjislativisht më efikase, jo vetëm sepse siguron qartësi ligjore dhe korrigjim gjyqësor, por edhe për shkak se u garanton qytetarëve tanë kompetenca të plota të auditimit, pa asnjë mangësi.

Si president i njëmbëdhjetë i Gjykatës së Audituesve, do të doja të ndaja katër reflektime me ju se si Gjykata mund të adresojë më mirë sfidat e sotme.

Së pari, ne duhet të jemi në gjendje të nxjerrim produktin e duhur në kohën e duhur. Kjo do të thotë duhet të vendosim për programin tonë të punës në mënyrë strategjike, duke publikuar punën tonë në momentin e duhur, për shembull kur legjislativi ose programet po rishikohen. Gjithashtu do të thotë, përshtatje e Raporti tonë Vjetor me sfidat e sotme, dhe jam optimist se tani jemi në rrugën e duhur për të parë këtë të ndodhë.

Së dyti, ne kemi nevojë për bashkëpunim më të ngushtë me të gjithë palët e interesit, duke filluar me PE, Këshilli, Komisioni dhe Institucionet Supreme të Auditimit, me partnerët



socialë, me shoqërinë civile dhe me partnerët tanë anembanë botës. Të qenit i pavarur nuk duhet të thotë të veprosh në një vakum, si fantazmat gri që imagjinonte Terry Pratchett.

Së treti, Gjykata duhet të komunikojë më mirë punën e saj në media dhe të bëjë veten më shumë të kuptueshme për qytetarët. Gjykata e Auditorëve duhet të jetë një model i dallueshëm, i njohur dhe zë i respektuar në debatin publik, jo vetëm në "filuskën" institucionale, por edhe tek shtetet anëtare, në parlamentet kombëtare dhe në botën akademike.

Së katërti, kjo mund të jetë e mundur vetëm me një organizim të brendshëm solid dhe efektiv, me një nivel të lartë fuqi punëtore të kualifikuar dhe të motivuar, të cilët përfitojnë nga trajnimet e vazhdueshme.

Kam besim se ky botim, me kontributet dhe dëshmitë e shumta që shkaktojnë mendime, mundet të na ndihmojë t'i përgjigjemi disa prej pyetjeve që kam ngritur më lart dhe të hartojmë të ardhmen tonë me aq shumë mençuri sa të jetë e mundur. Ju uroj një lexim të këndshëm!



Klaus – Heiner Lehne

## PARATHËNIE

EDUARDO RUIZ GARCIA,  
Sekretar i Përgjithshëm i ECA

“Stafi ynë është aseti ynë kryesor...”

Aset:

**“Avantazh, ndihmë, përfitim, bekim, burim, shërbim... të mira, pasuri”.**

Paperback Thesaurus. Collins, 1986).

**“...dije, teknikë, njohuri, aftësi... personel”.**

Roget's Thesaurus of English words and phrases (ref 629). Penguin Editions, 1987.



Eduardo Ruiz Garcia  
Sekretar i Përgjithshëm i ECA

"Stafi ynë është aseti ynë kryesorë ..." Kjo është një gjë shumë e zakonshme që thuhet nga CEO-të apo menaxherët e rangut të lartë, por deri në kjo deklaratë është e sinqertë dhe deri në çfarë masë është e vërtetë se stafi ynë është pasuria jonë më e vlefshme? Do të përpiqem t'u përgjigjem këtyre pyetjeve nga këndvështrimi i 40-të vjetorit të Gjykatës Evropiane të Auditorëve (ECA).

Më 1 janar 1978, kishte 47 punonjës në ECA. Kjo shifër përfshin anëtarët, stafi i zyrave të tyre private, audituesit, përkthyesit, stafi administrativ dhe shoferët. Në fillim të vitit 2017, ECA kishte rreth 1000 punonjës, që përfshinë anëtarët, zyrtarët, stafi i kontraktuar, ekspertë kombëtarë dhe praktikant.

Në këtë udhëtim 40-vjeçar, më shumë se 2700 njerëz kanë punuar për institucionin dhe kanë kontribuar në arritjen e misionit dhe objektivave të tij.

Numri i stafit është rritur, por "numrat" nuk janë parametri i vetëm për vlerësimin e vlerës sënjë pasurie, dhe nuk është aselementi më i rëndësishëm.

Në përgjithësi, stafi ynë është bërë më i larmishëm. Në 1978, kishte nëntë kombësi; tanika 28 kombësi të BE-së, plus njerëz që vijnë nga vende të tjera si Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë, Turqia dhe Serbia. Çdo ditë, në korridoret, kalojnë kolegë të cilët nuk janë vetëm me origjinë evropiane, por gjithashtu mund të jenë me origjinë afrikane, aziatike, karaibe dhe amerikane. Në vitet e para, shumica e audituesve tanë ishin avokatë ose ekspertë të kontabilitetit; tani, megjithëse shumica e tyre ende kanë sfond të tillë, shumë të tjerë kanë diploma në ekonomi, inxhinieri, shkencë politike ose administrim biznesi.

Profili i moshës së stafit të ECA tregon se institucioni është "i ri"; në fund të vitit 2016, mbi 50%e anëtarëve të stafit ishin 44 vjeç ose më pak. "Rinia" ka qenë një karakteristikë e stafit tonë nga vetëfillimi; kjo është rezultat i rritjes në përmasa dhe transferimeve të

rregullta në dhe nga institucionet e tjera. ECA është një "çerdhe audituesish" e njohur, duke ushqyer nevojat e Komisionit Evropian, Parlamentit dhe institucioneve të tjera.

Barazia gjinore është me rëndësi të madhe për të siguruar që organizata të jetë në gjendje të përballet me probleme në perspektiva të ndryshme; ajo lejon një larmi të gjerë të stileve të menaxhimit dhe na ndihmon të gjejmë zgjidhje alternative. Gjendja gjinore është përmirësuar gjatë këtyre 40 viteve; sidomos në 10 vitet e fundit, më shumë gra janë bashkuar në ECA në nivele më të larta të hierarkike. Në vitin 2006, vetëm 33% e grave ishin të punësuar si administratore; në vitin 2016 shifra ishte afër 42%. Megjithatë, përparimi i mëtejshëm është ende i nevojshëm në nivelin e menaxherëve të auditimit, meqë përqindja e grave është e pakënaqshme.

Diversiteti është ndërtuar nga kombësi, sfonde, mosha të ndryshme dhe balanca gjinore. Diversiteti është pasuruar nga karaktere dhe cilësi individuale: kreativiteti, korrektesa, matura, kurioziteti, pragmatizmi, guximi, vetëkritika, vetëbesimi, këmbëngulja dhe diplomacia ... stafi i ECA-së është i bekuar me të gjithë këto cilësi. Rezultati është një kapacitet më i lartë për të punuar së bashku dhe për të bërë të mundur që gjërat të bëhen shumë mënyra të ndryshme, sepse ka shumë rrallë vetëm një mënyrë të vetme për të bërë gjërat.

Çdo organizatë ka një vlerë jomateriale të lidhur me asetet të cilat janë jomateriale dhe jo fizike, siç janë ndërtesat apo pajisjet e saj. Vlera jomateriale e organizatës do të ishte e barabartë me vlerën totale të saj minus vlerën e pasurive të saj fizike ose materiale. Është shumë e vështirë të llogaritet dhe është edhe më e vështirë për një institucion të sektorit publik. Shpesh asetet jo-materiale nuk janë në pasqyrat financiare dhe nuk u dihet vlera. Megjithatë, ekziston një dakordësi e gjerë midis ekspertëve, se asetet jomateriale kanë vlerë afatgjatë që përfshijnë, ndër të tjera, reputacionin, markën, dhe njohuritë. Le të shqyrtojmë shkurt disa nga këto karakteristika.

Gjatë 40 viteve të fundit, ECA ka fituar një reputacion të fortë dhe është njohur nga kolegët dhe institucionet e tjera si një organ i pavarur dhe profesional i auditimit. Nuk ka një formulë të vetme për të krijuar reputacion, ajo ka nevojë për përbërës të ndryshëm të përzier në doza komplekse. Por ka gjithmonë një përbërës që është i nevojshëm në sasi të mëdha: reputacioni i çdo individi që e përbën organizatën. ECA ka krijuar një kuadër për të lehtësuar sjelljen etike dhe profesionale të stafit të saj, duke përfshirë ndërgjegjësimin, trajnimin, këshilla dhe monitorimin. Por në fund të ditës, sjellja e tyre do të varet nga vlerat e individëve në fjalë dhe vendimet që ata mund të marrin.

Sot, ne i referohemi ECA si një "organizatë njohurish"; duke vepruar kështu, ne jemi duke respektuar një qasje të re të menaxhimit që e konsideron njohurinë si një faktor lëvizës për arritjen e objektivave strategjike. Cilado politikë e menaxhimit të njohurive që përdorim, njohuria gjenerohet dhe përdoret gjithmonë nga qeniet njerëzore; njohuria është kapur, shpërndarë dhe përhapur për qeniet njerëzore. Një "organizatë e njohurisë"

---

vendos STAFIN në qendër. STAFI është me shkronja të mëdha sepse përfshin jo vetëm aftësitë dhe kapacitetin e punës së të punësuarve, por edhe njohuritë e tyre individuale dhe njohuritë e tyre kolektive. Për të qenë i suksesshëm, një institucion duhet të hartojë qeverisjen, strukturën, politikat, metodologjinë dhe teknologjinë e tij në lidhje me STAFIN e tij.

Gjatë katër dekadave, ECA ka zhvilluar metodologjinë e auditimit, proceset e përkthimit dhe ato të administrimit, një kulturë menaxhimi, infrastrukturë dhe mjete të IT-së ... Këto janë gjithashtu pasuri jomateriale shumë të vlefshme dhe të gjitha ato janë krijuar nga STAFI ynë. Pas çdo zhvillimi ka ide, inteligjencë dhe përpjekje individuale; ka edhe shumë punë sëbashku, sepse puna në grup dhe kolegjaliteti janë ndër pikat kryesore të organizatës.

Për ta përmbledhur, vlera e ECA-s përcaktohet kryesisht nga pasuritë e saj jomateriale: reputacioni, sjellja etike, profesionalizmi, njohuritë, metodologjitë dhe proceset e menaxhimit. Vlera e këtyre asetëve është shumë e varur nga cilësia e stafit të saj dhe nga kapaciteti i tyre për të punuar së bashku dhe për të gjeneruar produkte auditimi.

Në këto 40 vjet, Gjykata ka fituar vlerë duke rritur cilësinë, madhësinë dhe diversitetin e personelit të saj. Kjo vlerë më e madhe është përkthyer në përfitime konkrete për Bashkimin Evropian.

Në vitin 1978, Gjykata publikoi Raportin e saj të parë vjetor dhe Raportin e saj të parë special (në atë kohë të njohur si "vëzhgime") mbi funksionimin e Asociacionit Evropian për Bashkëpunim (E.A.C.), një organ pionier për menaxhimin e politikës së jashtme, i cili u zhduk vite më parë. Për 20 vjet, numri i produkteve mbeti i qëndrueshëm dhe Gjykata emetonte diçka më pak se dhjetë raporte speciale në vit. Në vitin 1998, u emetuan 25 raporte speciale. Që atëherë, numri i raporteve ka vazhduar të rritet, jo vetëm për shkak të numrit të Raporteve Speciale të prodhuara, por edhe për shkak të numrit më të madh të Raporteve Speciale Vjetore në lidhje me Agjencitë dhe Organet Europiane.

Në vitet e fundit, rezultati i Gjykatës është bërë më i larmishëm dhe janë shfaqur lloje të reja produktesh, siç janë rishikimet e horizontale, Raporti vjetor i aktivitetit dhe "Auditimi i shkurtuar". Në vitin 2016, Gjykata prodhoi 95 produkte të ndryshme: dy raporte vjetore, 52 raporte specifike vjetore, 36 raporte speciale dhe pesë mendime dhe të tjera. Raporti më i fundit i publikuar i referohet një vlerësimi të mbylljes së marrëveshjeve për programet 2007-2013 për kohezionin dhe zhvillimin rural.

Asnjë nga këto produkte, as një vëzhgim apo rekomandim i vetëm, nuk do të ishte i mundur pa anëtarët e stafit tonë. Çdo gjë është rezultat i bashkëpunimit midis audituesve, përkthyesve, asistentëve, administratorëve, menaxherëve dhe stafit në logjistikë, burime njerëzore, financa, protokoll, komunikim dhe siguri, si dhe anëtarët dhe stafi në zyrat e tyre private.

Po, "STAFI ynë është pasuria jonë kryesore" . Stafi ynë i mirë dhe profesional është pasuria jonë më e rëndësishme; ato janë përbërësi kryesor i cili kontribuon në përmirësimin e menaxhimit financiar të BE-së, duke promovuar llogaridhënien dhe transparencën dhe duke bërë të mundur që Gjykata të veprojë si kujdestare e pavarur e interesave financiare të qytetarëve të Bashkimit.

Me qellim që të vazhdoi të jetë një institucion i rëndësishëm dhe për të shtuar më shumë vlerë për qytetarët e BE-së, ECA duhet të ruajë dhe të rrisë vlerën e stafit të saj. Duhet të risi diversitetin dhe barazinë gjinore; ajo duhet të zhvillojë më tej aftësitë e saj aktuale dhe të rekrutojë aftësi të reja; ajo ka nevojë për të menaxhuar dhe rritur njohuritë e saj dhe për ta hapur atë në botën e jashtme. ECA duhet të ruajë sjelljen profesionale dhe etike të stafit të saj dhe të sigurojë një kulturë menaxhimi dhe mjedisi pune që lehtëson bashkëveprimin dhe fokusimin në rezultate. Ky është një program realist dhe ambicioz për 40 vitet e ardhshme.



Eduardo Ruis Garcia

# 1. HYRJE



Objektet e para të Gjykatës, Rruga Aldringen, 29, në Qytetin e vjetër të Luksemburgut. © ECA

ROSMARIE CAROTTI

## NJË HAP I RËNDËSISHËM NË NDËRTIMIN E BASHKIMIT EVROPIAN

Një hap i rëndësishëm në ndërtimin e Bashkimit Evropian ishte krijimi i institucioneve dhe organeve të reja të aftë për të kontribuar në mënyrën e tyre specifike për ndërtimin e një baze të fortë evropian.

Një nga pengesat e para të hasura në rrugën drejt këtij koncepti të ri të Evropës ishte natyra e improvizuar e kuadrit ligjor. Për shembull, Traktati i themelimit të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, pararendës i institucioneve të sotme evropiane, siguroi vetëm një komisioner të llogarive. Më vonë, u krijua një bord auditimi për Komunitetet Evropiane.

Deri në vitin 1970, kishte vetëm kontribut financiar të Shteteve Anëtare për Komunitetet dhe nuk kishte burime vetjake. Prandaj auditimi kishte të bënte vetëm me shpenzimet dhe përfundimisht ishte nën përgjegjësinë e Këshillit. Krijimi i burimeve të veta dhe dhënia e kompetencave buxhetore në Parlamentin Europian nënkupton një rishpërndarje të përgjegjësive edhe në fushën e auditimit. Ideja e krijimit të një Gjykate të Audituesve u ngrit në Parlament.

Deklarata e Limës e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (1975) përcaktoi shtyllat kryesore të një institucioni të pavarur të auditimit. Traktati i vitit 1975 dhe Rregullorja e Përgjithshme Financiare e Komuniteteve përcaktuan përgjegjësitë dhe kompetencat e ECA-s.

Rruga ishte e vështirë dhe plot pengesa. Zgjedhjet e para të drejtpërdrejta universale në Parlamentin Evropian u mbajtën në shtator 1976. Gjithashtu ishte e rëndësishme të krijohet një Gjykatë Evropiane e Audituesve për të përforcuar rolin e Parlamentit Evropian. Gjykata Evropiane e Audituesve u krijua në vitin 1977.

Mbajtja e informimit të Parlamentit mbetet një nga detyrat kryesore të Gjykatës Evropiane të Audituesve. Megjithatë, gjatë viteve Gjykata ka zgjeruar dhe konsoliduar rolin e saj si auditues i jashtëm i Bashkimit Evropian. Ajo është bërë një stimul për një bashkëpunim të vërtetë evropian, pasi ndarja e përgjegjësive të BE-së me organet kombëtare ndihmon gjithashtu për të forcuar Bashkimin.

Në vitin 2017, Gjykata Evropiane e Audituesve feston 40 vjetorin e saj. Shumë ka ndodhur në keto 40 vjet. Një lloj si në jetën njerëzore, zhvillimet kanë ardhur të pritura dhe të pa pritura. Ndonjëherë, ato janë ndikuar nga ngjarje të jashtme; në raste të tjera, ato kanë ndodhur pa ndikim nga jashtë. Nuk është gjithmonë e lehtë të japësh një gjykim objektiv për këto zhvillime në retrospektivë, madje edhe tek ata që i kanë dëshmuar. Për të ndihmuar kuptueshmërinë, le të përpiqemi të ringjallim frymën e asaj kohe.

## GIORGIO CLEMENTE, ISH-ANËTAR I ECA DHE ZËVENDËSKRYETAR I GJYKATËS ITALIANE TË LLOGARIVE

### DËSHMI

#### Deklarata e Limës dhe Gjykata Evropiane e Audituesve



*Giorgio Clemente, pjestar krijues i ECA dhe President i gjykatës së audituesve*

Një përmbledhje sistematike e bazave të auditimit të financave publike, të vlefshme për një periudhë të pacaktuar kohore dhe brenda çdo sistemi shtetëror, u konsiderua veçanërisht për herë të parë me rastin e takimit të Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit që kryen auditimin e jashtëm të Shteteve Anëtare të Komuniteteve Evropiane, mbajtur në Itali (në Palermo) në mars të vitit 1974, gjatë debatit në rendin e ditës në lidhje me një "shkëmbim pikëpamjesh mbi Kongresin e VIII-të të INTOSAI" (Madrid).

Tema 4 e këtij Kongresi ka të bëjë veçanërisht me bazat e auditimit të financave publike, me theks të veçantë në rekomandimet e miratuara në Kongreset e mëparshme të INTOSAI-t, dhe kjo zgjedhje bazohej në rrethanat që nga viti 1953 e tutje, ato Kongrese kishin të bënin me çështje të auditimit financiar, ku disa prej të cilave kanë të bëjnë me

"çështjet e parimit". Prandaj ishte koha e duhur për të provuar një analizë të thellë të rezolutave të miratuara dhe për të verifikuar vlefshmërinë e tyre.

Puna e Kongresit të VIII-të të INTOSAI u zhvillua në Madrid në maj të vitit 1974. Në kontekstin e temës së katërt në axhendë, u paraqit një mocion i posaçëm italian për të ngarkuar Sekretariatin e Përgjithshëm për të hartuar dhe më pas për të paraqitur për miratim në Kongres (në Lima), një "tabelë" ose "Deklaratë" mbi parimet themelore të auditimit të burimeve publike, duke përdorur për këtë qëllim rekomandimet dhe rezolutat e Kongreseve të mëparshme të INTOSAI-t.

Mocioni italian u pranua nga Kongresi, duke pasur parasysh se Sekretariati do të kishte bashkëpunimin e SAI-ve<sup>2</sup> gjermane dhe italiane.

Si rrjedhojë, *Gjykata Italiane e Llogarive* mori iniciativën, bashkë me SAI-n gjerman, për mbledhjen e një Grupi Pune Special në Romë, i përbërë nga përfaqësues të dy institucioneve dhe Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

Gjatë vitit 1975 Grupi i Punës i lartpërmendur kreu punën e tij, duke u përballur me problemin e limitimit të burimeve nga të cilat do të tërhiqnin parimet themelore për t'u

<sup>2</sup> SAI: Institucion Suprem Auditimi; institucion kombëtar auditimi në vendet anëtare.



përfshirë në projektin e "Deklaratës": ky grup miratoi kriterin bazë të njohjes vetëm të rezolutave dhe rekomandimeve nga tetë Kongreset e INTOSAI-t si burime të detyrueshme, të cilat do të garantojnë një analizë të shëndoshë dhe të saktë nga SAI-të.

Deklarata e hartuar nga Grupi i Punës i lartpërmendur u transmetua, gjatë vitit 1976, anëtarëve të INTOSAI-t, të cilët i dërguan komentet e tyre në kohë për diskutimin në Lima (1977), ku u miratua, pas një debati të gjerë, në versionin origjinal.

Deklarata përbëhet nga një preambulë, shtatë tituj dhe njëzetepesë paragrafë.

- Titulli i parë përfshin katër paragrafë dhe ka të bëjë me parimet themelore të auditimit;
- i dyti ka të bëjë me pavarësinë e SAI-ve (tre paragrafë);
- i treti ka të bëjë me marrëdhëniet me Parlamentin, Qeverinë dhe Administratën (dy paragrafë);
- pika e katërt fokusohet në kompetencat e Institucioneve Supreme të Auditimit (në tre paragrafë);
- pika e pestë merret me metodat dhe procedurat e auditimit, personeli i caktuar për auditim dhe shkëmbimet e përvojave ndërkombëtare (tre paragrafë);
- i gjashti i përket raporteve drejtuar parlamentit (dy paragrafë);
- i shtati, më në fund, analizon kompetencat e auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Parimi themelor i deklaruar në Deklaratën e Limës në lidhje me auditimin e menaxhimit të burimeve publike është:

*"Objektivat specifike të auditimit të financave publike ndjekin përdorimin e duhur dhe efektiv të burimeve publike; zhvillimin e një menaxhimi të shëndoshë financiar; rregullsinë e veprimit administrativ dhe komunikimin ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve përmes publikimit të raporteve të paanshme".*

Ky përkufizim në mënyrë adekuate përmbledh rolin e duhur të auditimit, që është të analizojë aktivitetin e menaxherëve të burimeve publike për të përmirësuar rezultatet si dhe të jetë përgjegjës ndaj tatimpaguesit për përdorimin e burimeve publike nga autoriteti përgjegjës.

Në thelb, sfondi i hartimit të Deklaratës së Limës mund të gjendet, siç u tha, në Evropë midis 1974 dhe 1975 dhe kishte një ndikim në kontekstin e Bashkimit Evropian.

Parimet e Deklaratës së Limës morrën në konsideratën se menaxhimi i financave publike, veçanërisht kur përfshin shuma të mëdha parash, ka nevojë për një auditim të jashtëm të detyrueshëm dhe të përshtatshëm. Ekzistenca e buxhetit të Bashkimit Evropian, i ndarë nga buxhetet e Shteteve Anëtare dhe menaxhimi autonom i përgjegjësive të dhëna institucioneve evropiane, përfaqësuan dy arsyet për krijimin e një organi të veçantë të auditimit të jashtëm për të ardhurat dhe shpenzimet e Komunitetit.

Për më tepër, themelimi i Gjykatës Evropiane të Audituesve përkonte me dy fakte veçanërisht të rëndësishme: zgjerimin e kompetencave të Parlamentit European në çështjet e kontrollit të buxhetit, si dhe financimin e plotë të buxhetit të Bashkimit Evropian nëpërmjet burimeve të veta.

Së pari duhet të theksohet se me të njëjtin Traktat që themelohet Gjykatën Evropiane e Auditimit, Parlamenti European bëhet autoriteti me kompetencë për të dhënë shkarkimin e Komisionit për ekzekutimin e buxhetit për të cilin ishte përgjegjës.

Sa i përket "burimeve vetjake", me të ardhurat ekzistuese (taksat doganore dhe taksat bujqësore) u shtua "Burimi vetjak i TVSH-së", bazuar në vendosjen e një norme uniforme të aplikuar në bazat e të ardhurave të TVSH-së në Shtetet Anëtare. Burimi i TVSH-së, i planifikuar për vitin 1975, u zbatua vetëm disa vjet më vonë dhe u pasua nga një burim i katërt i veti bazuar në Produktin e Brendshëm Bruto.

Paralel me zgjerimin e burimeve vetjake dhe dhënien e fuqisë Parlamentit Evropian për ekzekutimin e buxhetit, u bë e nevojshme kryerja e një hapi cilësor për sa i përket auditimit të jashtëm të këtij të fundit, i cili ishte kryer deri në këtë moment nga një Komision i Auditimit (për buxhetin e përgjithshëm) dhe një Auditues (për Komunitetin European të Qymyrit dhe Çelikut - ECSC - pasqyrat financiare).

Sa i përket funksionimit dhe strukturës, ishte e nevojshme të krijohet një organ me mjete të përshtatshme. Kjo u parashtrua nga Presidenti i Komisionit të Kontrollit të Buxhetit, Heinrich Aigner, i cili, që nga viti 1973, kishte mbështetur fuqimisht nevojën për një organ auditimi në nivel komunitar. Gjykata Evropiane e Audituesve u krijua sipas Traktatit të Brukselit të datës 22 korrik 1975.

Gjykata Evropiane e Audituesve u krijua në 25 tetor 1977 por u ngrit në rangun e një institucioni më 1 nëntor 1993, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Mاستrihit.

Sa i përket kompetencave të auditimit, i është dhënë kompetenca që të organizojë në mënyrë të pavarur auditimet e veta dhe t'i zgjerojë ato për të përfshirë menaxhimin e shëndoshë financiar (madje edhe me përparësi krahasuar me disa institucione kombëtare të auditimit).

E gjithë kjo ishte për të garantuar që burimet në rritje të Komunitetit do të ishin subjekt i një auditimi të paktën të barabartë me auditimin e kryer nga institucionet kombëtare të auditimit mbi buxhetet kombëtare.

Së fundi, me siguri mund të thuhet se themelimi i Gjykatës Evropiane të Audituesve ishte përgjigjja e nevojës për të pasur një ndërgjegje financiare, siç ishte përcaktuar, kur filloi punën e saj në tetor 1977, nga Presidenti i Gjykatës së Drejtësisë, Hans Kutscher.

## NJË GJYKATË AUDITUESISH PËR KOMUNITETIN?

Ky është titulli i një artikulli të botuar në Wort Luxemburger më 26 qershor 1973<sup>3</sup>. Raporti thotë: "Claude Cheysson, anëtar i Komisionit të Komuniteteve Europiane, paraqiti propozime në komisionin e buxhetit në Bruksel, kryesuar nga z. Georges Spenale (Grupi Socialist Francez), për forcimin e kompetencave buxhetore të Parlamentit Evropian."

"Komisioni i Komuniteteve Europiane beson se kontrolli i përdorimit të fondeve publike nga institucionet e Komunitetit është i pamjaftueshëm dhe duhet të forcohet. Prandaj, propozohet të zëvendësohet komiteti i tanishëm i kontrollit me një organ të quajtur Gjykata e Audituesish."

Nga viti 1973 e tutje, Dr H. Aigner, kryetar i Komitetit për Kontrollin e Buxhetit dhe një anëtar i Parlamentit Evropian, argumentoi në favor të krijimit të një organi kontrolli në nivel komunitar.

Dr Aigner i përkiste gjeneratës që kishte përjetuar personalisht Luftën e Dytë Botërore. Si një ushtar gjerman, ai kishte qëndruar në një hendek në Montecassino. Kur ai u largua nga hendeku për një moment për të pirë duhan, ai u godit nga një guaskë. Kur u kthye, të gjithë shokët e tij ishin të vdekur. Kjo përvojë e kishte ndikuar fort dhe e thellonte besimin e tij. Për të, procesi i pajtimit ishte aventura e vërtetë e Europës, megjithëse ishte i vetëdijshëm se Europa, vendet e të cilave po zhvilloheshin në mënyra të ndryshme për shekuj, nuk mund të ngjitej së bashku në pak vite për të bërë një njësi homogjene<sup>4</sup>.

*"The European Community is there to serve its peoples and citizens who have a rightful claim to assurance that money into European coffers is spent wisely and in accordance with the principle of sound budget management. It falls to the representatives of the peoples of Europe –and the Members of the European Parliament consider themselves as such- to be the guarantors of clear-cut and responsible financial management on the part of the European Community..."*

- Heinrich Aigner, in Introduction to "The case for a European Audit Office" (European Parliament 1973: 15).

Themelimi i ECA ishte i lidhur me dispozitën e Traktatit të 1975 që ngarkonte

<sup>3</sup> "Luxemburg Wort": e enjte 26 qershor 1973, faqe 5.

<sup>4</sup> Intervistë që ju dha editorit në 1986.

Parlamentin me të drejtën e vetme për të shkarkuar Komisionin për përgjegjësinë e tij në lidhje me llogaritë e Komuniteteve. U ndje se ky transferim i përgjegjësisë nga Këshilli në Parlament duhet të shoqërohet me një intensifikim të kontrollit dhe auditimit dhe kjo mund të arrihet më së miri me krijimin e një instrumenti të ri, Gjykata Europiane e Audituesve (ECA). Ideja e krijimit të një institucioni evropian të auditimit ishte ngritur në Parlament.

Jacques Santer, President i Komisionit Evropian, bëri këto vërejtje me rastin e 20 vjetorit të Gjykatës. "Gjykata e Audituesve u krijua në një kohë kur hynë në fuqi dy faktorë të veçantë të rëndësishëm, domethënë fuqitë buxhetore të Parlamentit Evropian u zgjeruan dhe po i njëjti buxhet i Komunitetit Evropian u financua tërësisht nga burimet vetjake. Për më tepër, ajo u rrit në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa u rritën shpenzimet nën politikën e përbashkët bujqësore dhe u zhvilluan politika të tjera, të tilla si ato që lidhen me hulumtimet dhe fondet strukturore<sup>5</sup>".

### Institucioni nis punë

Më 10 tetor 1977, Luxemburger Wort shkruante: "Gjykata e re e audituesve të Komunitetit Evropian do të jetë në gjendje të fillojë punën e saj në Luksemburg në muajt e ardhshëm, kur është hequr pengesa e fundit, përkatësisht marrja e miratimit nga Parlamenti Evropian. Presidenti i Parlamentit Evropian, Emilio Colombo, ka paraqitur një mocion për rezolutë që i bën thirrje Parlamentit që të miratojë listën e kandidatëve të Këshillit të Ministrave në takimin e tij në Kirchberg këtë javë.

"Gjykata e Audituesve do të ketë nëntë anëtarë: një nga secili Shtet Anëtar. Ata do të emërohen me një votim unanim nga Këshilli, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, për një mandat prej gjashtë vitesh".

Më 25 tetor 1977, ECA filloi punën në zyrën e saj në, rue Aldringen, 29, në Luksemburg. Ndërtesa u mor me qira nga autoritetet e Luksemburgut. Në atë kohë nuk ishte ende e sigurt nëse të gjitha aktivitetet e Gjykatës do të zhvilloheshin në Luksemburg. Gjithashtu u mor parasysh edhe hapja e një zyre në Bruksel.

<sup>5</sup> Fjalë e Mr. Jacques Santer, në përvjetorin e 20-të ECA-së.

## PRESIDENTËT E ECA-S



*Sir Norman Price,  
United Kingdom  
(18.10.1977-10.11.1977)*

**Z. Norman PRICE** ishte ndër themeluesit e ECA; ai erdhi në Luksenburg në Tetor të vitit 1977 së bashku me 8 anëtarët e tjerë. Z. Norman e kaloi të gjithë karrierën e tij profesionale në Të Ardhurat e Brendshme, zyrën e taksave të Mbretërisë së Bashkuar. Bazuar në formimin e tij, z.Norman fillimisht auditoi të dhënat e Burimeve Personale.

Duke qenë se ai ishte ndër anëtarët më të vjetër, themelues të ECA, ai luajti për disa javë rolin e Presidentit të Gjykatës, deri sa u zhvilluan për herë të parë zgjedhjet për president.

Presidenti i parë i zgjedhur ishte **Michael N.MURPHY**. Gjithçka duhet të nisej nga fillimi, duke përfshirë edhe krijimin e strukturës administrative, ashtu edhe përzgjedhjen e stafit.

Michael N. Murphy ishte tepër i dobishëm në negocime dhe vendosi njëmetodologji pune (modus operandi) me Komisionin, e cili ka vazhduar deri në ditët e sotme. Shkëmbimi i vazhdueshëm i letrave mes tij dhe Christopher Tugendhat, Komisioneri i atëhershëm

përgjegjës për marrëdhëniet me Gjykatën, i hapi rrugën krijimit të “procedurës kundërshtuese”.



*Michael N  
Murphy, Ireland  
(11.11.1977-17.10.1981)*



*Pierre Lelong  
France  
(18.10.1981-17.10.1984)*

**Pierre LELONG**, Anëtar i Gjykatës nga viti 1977 deri në vitin 1989, u zgjodh President në vitin 1981. Bazuar në strukturën e Gjykatës Franceze të Auditimit, Anëtarët e Gjykatës ndaheshin në 3 “grupe auditimi”. Një grup përqendrohej tek shpenzimet bujqësore, i dyti tek ndarja e fondeve dhe ndihmave për vendet në zhvillim, dhe i treti tek transaksionet e tjera të kryera nga Komisioni dhe institucione të tjerë paralele. Në vitin 1999, Pierre Lelong ishte pjesë e “Komitetit të Njerëzve të Mençur”, puna e të cilit çoi më pas në dorëheqjen e Komisionit të Santerit.

**Marcel MART** ishte një politikan nga Luksenburgu, jurist dhe sipërmarrës. Z.Mart shërbeu gjatë qeverisjes së Pierre Werner dhe Gaston Thorn. Në vitin 1977, ai u vendos si përfaqësues i Luksenburgut dhe Gjykatës Europiane të Audituesve, pozicion në të cilën ai qëndroi për 2 mandate 6 vjeçare. Ai gjithashtu ishte në rolin e Presidentit nga viti 1984 deri në vitin 1989.



*Marcel Mart,  
Luxemburg  
(18.10.1984-20.12.1989)*

Tregu i përbashkët Europian u krijua gjatë mandatit të tij qeverisës. Spanja dhe Portugalia ju bashkuan Komunitetit Europian në 1 Janar 1986.

**Aldo ANGIOI**, i cili ishte president nga 9 Janar nga viti 1990 deri në 21 Dhjetor 1992, u vendos si Anëtar Italian i Gjykatës në Shtator të vitit 1977.



*Aldo Angioi,  
Italy  
(21.12.1989-31.12.1992)*

Aldo Angioi ishte gjykatës në Gjykatën Italiane të Audituesve. Nga 1 Gushti i vitit 1974, deri në 31 Korrik të vitit 1975, ai ishte Kryetar i Bordit të Audituesve të NATO. Ai ju bashkua ECA në vitin

1977. Në 1995, ai mori titullin “Cavaliere dell' Ordine al Merito della Repubblica Italiana”.

Z. Angioi ka qenë pjesë e Konferencës Kushtetuese të EUROSAT, Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit. Gjykata Europiane e Audituesve ka dhënë një kontribut të vlefshëm në themelimin e statutit përfundimtar të EUROSAT.



*Andre Middelhoeck,  
Netherlands  
(1.1.1993-31.12.1995)*

**André MIDDELHOEK** u bë pjesë e ECA në vitin 1977 dhe qëndroi në pozicionin e Presidentit nga 12 Janari i vitit 1993 deri në 20 Dhjetor të vitit 1995.

Gjatë mandatit të André MIDDELHOEK, nën traktatin e Mاستrihtit, Gjykata u bë një institucion me të drejta të plota. Si rezultat, kjo çoi në një balancë më të qëndrueshme mes audituesit dhe subjektit të audituar.

Tanimë, përgjegjësitë e Gjykatës së Audituesve përfshinin detyrimin për t'i ofruar organeve shtetërore siguri të arsyeshme mbi besueshmërinë e llogarive, dhe gjithashtu mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e transaksioneve rutinë.



*Bernhard Friedmann,  
Germany  
(1.1.1996-17.1.1999)*

Në Janar të vitit 1996, **Profesor Bernhard FRIEDMANN** nisi punën e tij si President i Gjykatës Europiane të Audituesve. Gjatë mandatit të tij, i cili zgjati deri në fillim të vitit 1999, Bashkimi Monetar dhe zëvendësimi i Njësisë Valutore Europiane (ECU) me euron, ishin temat më të diskutuara.

Gjatë negociatave për Traktatin e Amsterdimit në vitin 1995, Profesor Friedmann votoi kundër dhënies së autoritetin për të vendosur sanksione nga ana e Gjykatës së Audituesve. Ai argumentoi se nëse audituesve do t'u jepet kjo e drejtë, ata do të gjenden përballë një

situatë shumë të vështirë.

Gjithnjë e më tepër, Gjykatës Europiane të Audituesve, i kërkohej nga institucionet e tjera, dhënia e opinionit për masat që duhet të propozoheshin me efekt mbi buxhetin.



*Jan O. Karlsson,  
Sweden  
(18.1.1999-31.12.2001)*

Në 14 Janar të vitit 1999, Suedezi **Jan O. KARLSSON** u zgjodh President. Ai kishte qenë anëtar i Gjykatës së Audituesve që nga viti 1995. Ai kishte besim tepër të madh tek parimet e kolegjalitetit, pavarësisë dhe vazhdueshmërisë. Në lidhje me shtetet të cilët ishin duke u përgatitur për t'u bërë pjesë e BE-së, ai u shpreh se institucionet e tyre kombëtare të auditimit duhet të kryejnë një punë më të mirë.

1999 do të ishte një vit vendimtar për menaxhimin buxhetor brenda BE. Një krizë besimi mbi drejtuesit e Komisionit do të çonte në përgatitjen e dy raporteve nga Komiteti i Ekspertëve të Pavarur dhe si pasojë i gjithë Komisioni dha dorëheqjen. Komisioni i ri, që filloi punën në Shtator 1999, prezantoi menjëherë një program reforme.

Përfshirja e shteteve të rinj anëtare si pasojë e zgjerimit të Bashkimit Europian me 28 anëtarë, do të ishte një arsye më tepër për t'u shqetësuar. Siguria ligjore ishte një çështje e nxehtë dhe debati mbi Kushtetutën e re Europiane kishte si qëllim zgjidhjen e saj. U diskutua alternativa e përgatitjes së Ligjit Penal Europian dhe një Prokurori Publik Europian për të mbikëqyrur të gjithë sistemin.

Në vitin 2001, Parlamenti Europian ratifikoi vendimin mbi reformën e procedurës buxhetore dhe institucioneve buxhetore (raporti Morgan). Struktura e re buxhetore bazuar në aktivitet, do të kishte një jehonë të madhe në Gjykatën Europiane të Audituesve.



*Juan Manuel Fabra Valles,  
Spain  
(1.1.2002-16.1.2005)*

**Juan Manuel VALLÉS** u emërua në Gjykatën e Audituesve në vitin 2000, dhe e la atë në vitin 2006. Ai vdiq në Madrid në vitin 2012.

Juan Manuel Fabra Vallés ka qenë anëtar i Parlamentit në Kongresin Spanjoll nga viti 1982 deri në vitin 1994, Anëtar i Parlamentit Europian nga viti 1994 në 2006, dhe një anëtar kyç në Komitetin e Kontrollit Buxhetor.

Përgjegjësitë e tij fillestare në Gjykatën Europiane të Audituesve kishin të bënin me auditimin e Fondeve të Zhvillimit Europian, mbi të cilat ai përgatiti një sërë raportesh veçanërisht në lidhje me programet ndihmuese për zhvillim të BE-së.

Në Janar të vitit 2002, ai do të ishte anëtari i parë Spanjoll i zgjedhur si President i ECA. Në vitin 2004, gjatë mandatit të tij, 10 shtete të rinj u bënë pjesë e Bashkimit.

Në vitin 2005, në fund të mandatit të tij si President, ai u zgjodh si kryetar i dhomës së Gjykatës, përgjegjëse për auditimin e jashtëm të aktivitetit të BE.

Nga gjithë fjalët e tij të mençura për të kuptuar projektin European, përmendimveçanërisht: *“Bazuar nëpërfitimet e gjithë anëtarëve të tij, nëse Bashkimi European ka një kosto prej vetëm 1,24% e gjithë të ardhurave të gjeneruara nga shtetet anëtare, ai është një shpikje e magjishme”.*



Hubert Weber,  
Austria  
(17.1.2005-15.1.2008)

Austriaku **Hubert Weber** u bë President i Gjykatës Europiane të Audituesve në vitin 2005, pasi kishte punuar në Gjykatën Europiane që nga viti 1995, dhe më parë në Gjykatën Austriake të Audituesve për 25 vite. Pas 16 vitesh në detyrë, Dr. Weber u largua nga Gjykata në 30 Mars të vitit 2011.

Hubert Weber ishte dëshmitar i shkrimit të parë të Udhëzimeve mbi Parimet e Auditimit në Deklaratën Limës, e cila shpesh herë njihet si Karta e Madhe (Magna Carta) e auditimit financiar. Hubert Weber tha në një intervistë në vitin 2011 se: “ Siç mund të kuptohet edhe nga të dhënat e Gjykatës, ekzistonte një shkëmbim i vazhdueshëm pikëpamjesh dhe diskutimesh mes Luksenburgut dhe Vienës në atë kohë, ose ndryshe me Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI, vendosur në Gjykatën Austriake të Auditimit. Do të ishte kënaqësi e veçantë për mua, teksa gjeja emrin tim në dokumentet e takimit në Gjykatë në vitin 1995, dhe gjithashtu kjo ma bëri më të lehtë fillimin e punës. Stili i auditimit u zhvillua me një shpejtësi të madhe”.



Vitor Manuel da Silva  
Caldeira, Portugal  
(16.1.2008-30.9.2016)

**Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA**, nga Portugalia, u zgjodh President në vitin 2008. Pas mandatit të tij të dytë, ai u rizgjodh për herë të tretë në 23 Janar të vitit 2014 për një mandat tre-vjeçar. Sot, ai është President i Institucionit Suprem të Auditimit Portugez.

Që nga fillimi i krizës dhe veçanërisht në vijim të krijimit të mekanizmave mbrojtës, Gjykata Europiane e Audituesve i kushtoi vëmendje parimeve kryesorë që duhet të respektohen në rastet kur fondet publike rrezikohen. Kjo filloi me një letër drejtuar Z. Van Rompuy në Nëntor të vitit 2010 dhe vazhdoi me një Deklaratë të Gjykatës Europiane të Audituesve në Maj të vitit 2011. Në Tetor të po atij vitit, Institucionet Supreme të Vendeve Anëtare, së bashku me ECA, përsëritën së bashku dhe zhvilluan më tej këto parime në një Deklaratë të Komitetit të Kontaktit.



President Caldeira i kushtoi më tepër vëmendje 10 iniciativave adresuar aspekteve të ndryshëm si Deklarata e Sigurisë, mbi përgjegjësitë epunonjësve në fushën e auditimit, programimin e auditimit dhe proceset raportuese.

Në këtë linjë, dy iniciativa kyçe duheshin ndërmarrë për njërishikim horizontal të menaxhimit financiar dhe përbesueshmërinë e auditimit. Ato u dizenuan për të ndihmuar Gjykatën t'i demonstronte Parlamentit dhe Komisionit që ajo i kishte identifikuar nevojat e tyre.

Qëllimi ishte të përfshiheshin këto rekomandime në Strategjinë për vitin 2013-2017 të Gjykatës.



*Klaus - Heiner LEHNE,  
Germany  
(1.10.2016)*

**Klaus - Heiner LEHNE**, ishte gjermani që pasoi Vitor Caldeiran. I lindur në Düsseldorf të Gjermanisë në vitin 1957, Klaus Heiner shërbeu si Anëtar i Parlamentit Gjerman dhe Parlamentit Europian, si dhe u bë Anëtar i Gjykatës në vitin 2014. Ai ishte përgjegjës për auditimin e jashtëm.

Vitet 2018-2020 do të jenë një periudhë vendimtare për Bashkimin Europian. ECA do të duhet të ndërmarrë sfida të reja dhe tëshfrytëzojë mundësitëreja. Gjatë periudhës 2018-2020, Deklarata e Sigurisë do tëpërshtatet duke përfituar nga menaxhimi financiar i përmirësuar i Bashkimit Europian. Kjo do e lejojë ECA tëfokusojë vëmendjen dhe burimet e saj mbi auditimin në zonat me rrezik të lartë të menaxhimit financiar të BE dhe nëpërfundimin nëse BE po i përcjell rezultatet e punës tek qytetarët . Gjithashtu, në vitet që do të vijnë, ECA do tëshfrytëzojëmirëteknologjinë me qëllim inovacionin në punën audituese.

## 2. ZHVILLIMI I AUDITIMIT NË ECA



### MODELI I ZGJEDHUR PËR ECA

Në një sistem kompleks si Bashkimi Europian, fuqia buxhetore është tepër e rëndësishme: duhet të mblidhen të ardhurat, të miratohen shpenzimet, dhe si rezultat duhet të kryhet auditimi i buxhetit të programuar dhe aplikimit të tij.

Nga fillimi i vendosjes në zbatim të Traktatit që parashikonte Këshillin dhe Komisionin e përbashkët, mund të flitet për një buxhet të vetëm. Deri në vitin 1970, nuk kishte burime të tjera financimi përveç kontributevetë vendeve anëtarë të Komunitetit. Si rezultat, auditimi i referohej vetëm shpenzimeve nën përgjegjësinë e Këshillit. Krijimi i burimeve të veta të financimit, do të çonte edhe në një rishpërndarje të përgjegjësisë në fushën e auditimit.

Qëllimi i Asamblesë Parlamentare ishte të shkonte përtej rolit të saj si këshilluese, duke u bërë pjesë e sistemit të vendimmarrjes të shumë politikave të përbashkëta dhe buxhetore, në të njëjtën linjë me institucionet e tjera.

Shqetësimi i Këshillit në këtë kohë lidhej me rrezikun që sillte fuqia e madhe që po transferohej, zgjidhja e të cilës gjendej tek përqendrimi i vëmendjes në auditim. Kështu, në një situatë ku krijimi i Gjykatës së Audituesve po mbështetej masivisht, u shqyrtua mundësia për krijimin e një modeli mbi sistemet e përhershme dhe të jashtme të auditimit.

Në përputhje me dispozitat e Traktatit të vitit 1975, ECA zëvendësoi trupën audituese të mëparshme të Komunitetit: Bordine Audituesve dhe Zyrën Audituese të Komitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut. Traktati i vitit 1975 dhe Udhëzimi Financiar i Përgjithshëm i vendeve anëtare minimizoi përgjegjësitë dhe fuqitë e ECA, të cilat gëzonin statusin thuajse institucional (quasi- institucional) dhe gjithashtu ECA duhet të kryente auditime në shtetet anëtare me iniciativën e vet. ECA mund të kryente kontrole nëçdo kohë mbi çështje specifike të zgjedhura nga ajo vet dhe dhënies së opinionit mbi legjislacionin me impakt në menaxhimin financiar sipas kërkesës sëçdo institucioni.

Zgjedhjet e para të Parlamentit Europian u zhvilluan në vitin 1977 dhe krijimi i ECA u konsiderua si një faktor i rëndësishëm për fuqizimin e Parlamentit.

Me rastin e 30 vjetorit të ECA, Presidenti i Mëparshëm Juan Manuel Fabra Valles tha se: “Në vitin 1977, pas diskutimeve të gjata në Parlamentin Europian, Zyrat Kombëtare të Auditimit së bashku me Institutet e tjera Europiane, krijuan Gjykatën Europiane të Audituesve, sipas modelit që ekzistonte në shtete të ndryshme anëtare, e cila do të konsiderohej si “fuqia e katërt e Shtetit”.

Institucioni i ri do të ishte i pavarur dhe profesional, do të ushtronte kontrollin e tij pas faktit (ex-post), dhe do të ishte përgjegjës për kontrollin e jashtëm financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe menaxhimin financiar eficient. Ky institucion, do të informonte për çdo vit autoritetet buxhetore, duke i ofruar informacione tëvlefshme Këshillit dhe Parlamentit, duke i mundësuar këtij të fundit opinione mbi llogaritë, duke miratuar (ose jo) menaxhimin e buxhetit nga Komisioni, si dhe duke e shndërruar atë në instrumentin më të mirëudhërrëfyes për përgatitjen e buxhetit të vitit pasardhës<sup>6</sup>.”

Në mbledhjen e Gjykatës në 26,27 dhe 28 Tetor 1977, u krye një diskutim mbi kuptimin e shprehjes “menaxhimi financiar i qëndrueshëm” që ishte përdorur në Traktatin e vitit 1975. U pranua gjerësisht se kontrollat pas faktit dhe një qasje mbi “vlerën e parasë”, do të ishte një element i rëndësishëm në punën e Gjykatës në të ardhmen.

Problematikat e ngritura mbi politikën e Komunitetit, nuk ishin përgjegjësi e ECA, edhe pse opinioni i saj për këto çështje, do të ishte i vlefshëm për Parlamentin.

---

<sup>6</sup> Gazeta e ECA-së, Nëntor 2007, faqe 8.

<sup>7</sup> Dokument i takimit të brendshëm të ECA (DEC 14/77)

Qëllimi kryesor i ECA duhet të jetë inkurajimi i praktikave të kontabilitetit të cilat u krijuan për të parandaluar mashtrimin ose për ta bërë atë më lehtësisht të dallueshëm.

U arrit marrëveshja që parashikonte mënyrën se si ECA do të funksiononte: ajo do të ishte një trup i vetëm, me vendimmarrje të përbashkët. Në kapacitetin e saj, Gjykata ishte një Institucion i ri i Komunitetit dhe ishte e rëndësishme të theksohej ky fakt në marrëdhëniet me institucionet e tjera. Në vitin 1978, ECA ndërmori iniciativën për të krijuar një sistem “ndërlidhës”, së bashku me Institucionet Supreme të Auditimit Kombëtare.

Ishte e pranuar gjerësisht se gjatë kryerjes së punës, metoda më e kënaqshme për kryerjen e auditimit ishte krijimi i ekipeve. Secili nga këto ekipe do të drejtohej nga Anëtari i Gjykatës dhe do të ishte përgjegjësia e tij/e saj për të prezantuar raportin përpara Gjykatës mbi rezultatet e punës.

Gjithashtu, ekzistonte një marrëveshje anonime mbi auditimet e sistemeve të llogarive, si dhe ligjshmërinë e rregullshmërinë e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga ana tjetër, ekzistonin opinione të ndryshme lidhur me menaxhimin financiar të qëndrueshëm të auditimit, dhe veçanërisht kur autoritetet kombëtare ishin përgjegjëse për përdorimin e fondeve të Komunitetit. Ekzistonin ende paqartësi në vendet anëtare lidhur me rekomandimet që Gjykata kishte si qëllim t’i jepte audituesve në këto vende.

ECA vendosi t’i jepte të gjithë subjekteve të audituara të drejtën për t’u përgjigjur konstatimeve të bëra gjatë auditimit. Ajo vendosi se Institucionet Supreme të Auditimit duhet të njoftohen për ndonjë observacion të mundshëm gjatë kontrollit në subjekt dhe gjatë prezantimit të Raportit Vjetor. Bashkë me “procedurën kundërshtuese” dhe Komisionin, aplikimi i këtij vendimi kishte për qëllim garantimin e komunikimit të duhur në rastet kritike.

Gjatë kësaj periudhe lindi pyetja nëse Raporti Vjetor duhet të përfshinte observacionet mbi llogaritë e vitit respektiv, së bashku me opinionin mbi çështje specifike të theksuara në raporte të veçanta. Komisioni, Parlamenti dhe institucionet e tjera duhet të përfshijnë të gjitha çështjet e rëndësishme në Raportin Vjetor, sepse kjo është baza mbi të cilat Parlamenti mund të shkarkojë Komisionin, edhe pse autoritetit shkarkues nuk ju mohua mundësia për të kërkuar raporte të veçanta.

Në fillimet e saj, ECA kritikoi legjislacionin e Komunitetit mbi raportet specifike të tij. Observimet e saj lidheshin kryesisht me institucionet dhe strukturat e Komunitetit, dhe jo për publikun e gjerë. Shpesh herë, raportet specifike mbi ndjekjen e rregullave nuk përmbanin rekomandime, por vetëm një analizë dhe përshkrim të menaxhimit të programit drejtuar nga Komuniteti në përgjithësi. Megjithatë, në raste kur identifikoheshin pasaktësi, shtetet anëtare njoftoheshin specifikisht.

Tashmë nuk ishte një surprizë se Politikae Përbashkët Bujqësore (CAP) zinte pjesën më të madhe të raporteve specifike. Edhe pse CAP ishte tepër e suksesshme në arritjen e objektivave të saj për rikthimin e vetëbesimit në Komunitetin European. Deri në 1980 ajo duhet të përballej me tepricat e mëdha bujqësore, disa prej të cilave eksportoheshin ( me ndihmën e subvencioneve) ndërsa pjesa tjetër duhet të ruhej ose të shpërndahej brenda përbrenda Bashkimit European. Këto masa kishin një kosto tepër të lartë buxhetore, shtrembërimin e disa tregjeve botërore, jo gjithmonë i shërbenin interesit të fermerëve dhe nuk ishin shumë të përhapura si iniciativa nga konsumatorët dhe taksapaguesit.

Kjo ishte diçka që edhe Dr. Heinrich Aigner e kishte ndjerë. Si njëanëtar i Parlamentit European, ai takonte rregullisht zgjedhësit e tij për t'ushpëguar Europën atyre që nuk mund të kuptonin, kështu për shembull çuarjen dëm të prodhimit të tepërt. Ai kishte shumë shpresë tek ECA dhe në 1986 u shpreh “Më duhet ta them se ecuria e Gjykatës në këtë periudhë të shkurtër kohore ka qenë fantastike. Sigurisht që jam i vetëdijshëm se ajo nuk është ende ashtu siç ne e kishim imagjinuar të ishte, por as kontrollat e parlamentit nuk janë ashtu siç ne do të kishim dashur të ishin. Sigurisht që gjera të tilla kanë nevojë kohore për t'u zhvilluar, por më duhet të them një gjë: kontrolli i Parlamentit me bashkëpunim të ngushtë me Gjykatën e Audituesve –i cili duhet thënë se është një bashkëpunim tepër i ngushtë- u ka kursyer taksapaguesve qindra miliona, për të mos thënë mijëra. Kjo është një histori e vërtetë suksesi. Gjëja më e rëndësishme, e cila është dhe arsyeja përse jam përkrahës i kontrollove, lidhet me aplikimin e ligjit të Komuniteti në mënyrë të barabartë, kudo. Ky është aktualisht problemi kryesor”<sup>8</sup>.

### Një qasje bazuar në sisteme dhe menaxhim financiar të qëndrueshëm

Një Gjykatë e themeluar së fundimi, menjëherë i gjykoj të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet të pazbatueshme. Në mënyrë që të zgjidhte këtë problem, në një fazë fare të re (në fund të vitit 1978) ECA përkrahu qasjen sistematike si më e përshtatshme për nevojat e saj. Zgjidhja e propozuar nga Anëtar i Holandez i atëhershëm, Andre Midelhoek, i cili ishte përgjegjës për zhvillimin e metodave të punës, kishte të bënte me ekzaminimin e sistemeve dhe procedurave dhe se si ato mund të vendoseshin në praktikë nëpërmjet testeve të përputhshmërisë dhe pajtueshmërisë.

Në mbledhjen e saj të parë në Tetor 1977, ECA interpretoi menaxhimin financiar të qëndrueshëm, si opinionin e inkorporuar në një alternativë dhe nënjë mënyrë më ekonomike për implementimin e politikave nëpërmjet analizave të kostove dhe përfitimeve, dhe gjithashtu përcaktimin nëse fondet ishin përdorur në mënyrë efektive.

---

<sup>8</sup> Intervistë që i është dhënë editorit në 1986.

## Deklarata e Sigurisë

Joe Carey, anëtar i ECA hodhi idenë e një deklaratë sigurie (e njohur në frëngjisht si DAS), në termat e mëposhtëm: “Edhe pse mund të mendohet se referencat e Traktatit parashikojnë detyrimin e Gjykatës për të shprehur një farë opinionin ose deklaratë sigurie mbi llogaritë, Gjykata nuk e ka interpretuar në këtë formë. Leksuesi i Raportit Vjetor të Gjykatës nuk ka garanci se Gjykata ka ekzaminuar llogaritë e “të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve”, dhe llogaritë e Komisionit prezantohen pa ndonjë certifikim të pavarur lidhur me saktësinë dhe besueshmërinë e tyre”<sup>9</sup>.

Në 27 Shkurt 1991, delegacioni i Mbretërisë së Bashkuar dorëzoi në Konferencës Ndërdpartamentale, një propozim qëpërbante “Draftin e amendimeve të Traktatit lidhur me menaxhimin financiar dhe besueshmërinë”. Amendamenti 3 kishte titullin e mëposhtëm: “Deklarata e Sigurisë, ECA”. Artikulli i ri ishte korrigjuar me fjalitë e tanishme “Gjykata e Audituesve duhet t’i garantojë Këshillit dhe Parlamentit Europian një deklaratë pavarësie lidhur me besueshmërinë e llogarive dhe ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve rutinë”. Deklarata e Sigurisë u prezantua në Traktatin e Mastrihtit në 1992.

## Gjykata përcaktoi “doktrinën” e saj (1994-1999)<sup>10</sup>

Në vitin 1995, ECA publikoi deklaratën e saj të sigurisë lidhur me besueshmërinë e llogarive të vitit 1994. Gjatë viteve në vijim, Gjykata theksoi nevojën për të ndërmarrë reforma me hapë afatgjatë. Fillimisht, nevojitej të përcaktohej një kuadër bazë kontabiliteti, i cili duhet të ishte në përputhje me standardet e vendosura nga INTOSAI dhe i përshtatshëm për sektorin publik. Së dyti, duhet të përshtateshin parimet e kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare. Së fundmi, standardet e detajuara dhe metodat e kontabilitetit duhet të aplikoheshin për regjistrimin e transaksioneve në përputhje me kuadrin dhe parimet e kontabilitetit.

## Drejt një sistemi kontabiliteti me bazë rrjedhëse (accruals)(2000-2002)<sup>5</sup>

Insistimi i vazhdueshëm i ECA mbi nevojën për një sistem kontabiliteti, nisi të pasqyronte rezultatet në vitin 2000. Modernizimi i kuadrit të kontabilitetit filloi të merrte formë me Komisionin e vitit 2000, e cila përputhet si ngjarje edhe me publikimin e Dokumentit së Bardhë (COM (2000)200 final, 1.3.2000).

Gjykata monitoroi me kujdes të gjithë fazën e implementimit të planit të modernizimit, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë raporteve vjetore.

<sup>9</sup> Udhëzuesi i ECA: Origjina e Deklaratës së Sigurisë, nga Gilberto Moggia, ECA.

<sup>10</sup>“Roli i Gjykatës së Audituesve në Modernizimin e Sistemit të Kontabilitetit nga Institucionet Europiane” nga Eduardo Ruiz Garcia, Sekretar i Përgjithshëm i ECA. Titulli Original: El papel del Tribunal de Cuentas europeo en la modernización del sistema contable de las instituciones europeas, publikuar në in Revista Espanola de Control Externo, No. 44, Vol XV, Mayo 2013.

### Drejt një opinionit të pakualifikuar (2002-2011)<sup>5</sup>

2005 ishte viti i parë i dorëzimit të llogarive të përgatitura në përputhje me kuadrin dhe parimet e reja të kontabilitetit bazuar nëstandartet ndërkombëtare.

Opinionit i pakualifikuar dhe miratues lidhur me vërtetësinë e llogarive të vitit 2011, shënonte kulmin e suksesit të procesit të modernizimit të llogarive, prezantuar nga Komisioni Europian në vitin 2002. Këshilla dhe monitorimi i Gjykatës ndihmoi në përgatitjen dhe implementimin e planit.

### Auditimi i Performancës

Do të ishte Traktati i Mastroitit, jo më parë se viti 1992, i cili do të kërkonte implementimin e buxhetit të Bashkimit Europian “në përputhje me parimet e menaxhimit financiar të qëndrueshëm”, i cili më pas u përcaktua në Rregulloren Financiare të rishikuar si 3 E-të (ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti).

Menjëherë pas kësaj, në vitet 2003-2004, Gjykata vendosi si prioritet zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit financiar të qëndrueshëm. Një vendim i rëndësishëm gjatë procesit të zhvillimit, do të ishte riemërtimi i “auditit SFM” në “auditim performance”.

Fokusi i auditimeve u zhvendos gradualisht nga një qasje e orientuar në sisteme, në një qasje që shqyrtonte përcjelljen e rezultateve.

### Vlera e shtuar

Programi i reformimit të ECA, i cili i tregoi frytet e tij në vitin 2016, e ka transferuar këtë Gjykatën Europiane të Audituesve në një institucion i organizuar mbi detyra të veçanta dhe me një fokus të vazhdueshëm nga proceset tek produktet.

Nëpërmjet auditimit të performancës, ECA kishte si qëllim shtimin e vlerës nëpërmjet identifikimit të praktikave më të mira dhe rekomandimit të përmirësimeve në sistemet e menaxhimit.

### Kronologjia e ngjarjeve më të rëndësishme në këtë periudhë

1977 Krijimi i ECA.

1992 Traktati i Manstitit: ECA konsiderohet një institucion; ECA do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e deklaratave vjetore tësigurisë (SOA); Art.205 prezanton parimin e menaxhimit financiar të qëndrueshëm.

- 1999 Komisioni European dorëhiqet dhe Komisioni i ri prezanton programin e reformës i cili përfshin menaxhimin bazuar në aktivitetet dhe buxhetimin bazuar në aktivitetet.
- 2004 Zgjerimi i Bashkimit European me 25 Shtete Anëtare.
- 2006 Publikimi i Manualit të Auditimit të Performancës së Gjykatës.
- 2007 Traktati i Lisbonës (TFEU erdhi në pushtet në 2009) njohu përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për implementimin e buxhetit nën marrëveshjet e përbashkëta menaxheriale.
- 2008 Vlerësimi Peer review i ECA nga Institucionet Supreme të Austrisë, Kanadasë, Norvegjisë dhe Portugalisë.
- 2014 Vlerësimi Peer review i ECA nga Institucionet Supreme të Francës, Gjermanisë dhe Suedisë.
- 2016 Programi për Reformimin e Gjykatës. Tanimë ECA do të kishte 5 dhoma, nga të cilat emëroheshin anëtarët dhe stafi i auditimit. Anëtarët e secilës dhomë zgjedhin një Kryetar me mandat prej 2 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje. Secila dhomëka dy zona përgjegjësie: kryerjen e raporteve të veçanta, raporteve vjetore specifike me opinione; dhe përgatitjen e raporteve vjetore mbi buxhetin e BE dhe Fondeve Europiane për Zhvillim.



ANDRÉ J. MIDDELHOEK, KRIJUES DHE PRESIDENT I ECA

## DËSHMI

Unë isha njeriu që mbrojti me gjithë zemër auditimin bazuar në sisteme dhe menaxhimin financiar të qëndrueshëm

Intervistë me André J. Middelhoek, Anëtar dhe President i mëparshëm i ECA.

19 Janar 2017 në Bruksel

Intervistë e kryer nga Rosmarie Carotti



André J. Middelhoek, krijues i ECA dhe President

**Z. Middelhoek, ju jeni Anëtar i që ka qëndruar më gjatë në ECA**

**André Middelhoek:** 18 vite dhe 3 muaj. Tre muaj ishin më shumë si një dhuratë, sepse Këshilli nuk vendosi në kohë rinovimin e mandateve të mia në atë kohë.

**Ju u larguat nga ECA në vitin 1995. ECA do të festojë 40 vitet nga krijimi saj në Tetor të këtij vitit dhe do të dëshironim të mblidhnim kujtime nga ditët e hershme, kur ECA filloi, dhe si u zhvillua më tej.**

**André Middelhoek:** Fillimi i Gjykatës ishte tepër i vështirë sepse nuk kishte njëparaardhës të vërtetë i cili të bazoheshim. ECA filloi nga asgjëja. Ne nuk kishim staf, dhe ditën e parë pas inaugurimit, e filluam punën në një ndërtesë të vjetër në qendër të Luksenburgut, me asgjë përveçse një bllok, laps dhe gomë.

Procesi i zgjedhjes së Anëtarëve të Gjykatës ishte ndryshe nga ai i tanishmi. Në Shtator 1977, ne u ftuam nga Parlamenti Europian për një mbledhje në Bruksel me Anëtarët e Parlamentit Europian të Komitetit të Kontrollit të Buxhetit. Me aq sa mbaj mend ata ishin 9, dhe ne ishim 9, dhe secili nga ne u ul ngjitur me Anëtarët e Parlamentit. Kjo ishte në fakt mënyra se si ne konsideroheshim edhe atëherë. Kjo ngjarje ndodhi, nëse e mbaj mend mirë, në Pallatin Egmont, një ndërtesë më një histori të gjatë në Bruksel.

**A ishte mandati juaj i përcaktuar qartë që nga fillimi?**

**André Middelhoek:** Mandati ishte përcaktuar në Traktat: Auditimi i ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe menaxhimit financiar të qëndrueshëm. Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ishte i qartë, por diskutime të gjata u mbajtën për kuptimin e togfjalëshit “menaxhimi financiar i qëndrueshëm” sepse në atë kohë, as institucionet audituese kombëtare nuk e kishin të qartë këtë shprehje. Ne duhet të përcaktonim interpretimin e saj, dhe unë u zgjodha nga Gjykata për përgatitjen kësaj pune.

Unë përkraha interpretimin e menaxhimit financiar të qëndrueshëm si arritjen e një vlere të shtuar për paratë e qytetarëve në Europë, duke filluar nga objektivat e politikave të vendosur në rregullore, të cilat ishin të detyrueshme për ne. Edhe pse u pranuan nga Gjykata, ne nuk mund të fillonim punë menjëherë, pasi na mungonin auditues të specializuar.

### **Kur filloi në të vërtetë auditimi i menaxhimit financiar të qëndrueshëm në ECA?**

**André Middelhoek:** Z. Keemer erdhi nga zyra kombëtare e auditimit të UK (NAO), i zgjedhur si Drejtor i Gjykatës dhe krijoi Departamentin e Zhvillimit të Auditimeve dhe Raporteve të Auditimit (ADAR), i cili ndër detyrat e tjera, ishte përgjegjës për zhvillimin e auditimit financiar të qëndrueshëm. Ne shqyrtuam çfarë ishte bërë në Europë në këtë fushë. Menaxhimi financiar i qëndrueshëm ishte kryer nga pothuajse gjysma e Shteteve Anëtare. Në Itali dhe Greqi, puna e Gjykatës Kombëtare ishte auditimi i thjeshtë financiar mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, dhe kryejpas faktit (ex ante).

Mr. Keemer shkoi gjithashtu në institucionin suprem të auditimit amerikan (GAO) për të mësuar se si kryhej atje kjo procedurë dhe foli me një numër të madh profesorësh në universitet mbi menaxhimin financiar të qëndrueshëm. Përfundimi i kësaj punë ishte i pasqyruar në librin me titull “Auditimi Shtetëror në Europën Perëndimore; një studim krahasimor” nga Peter Keemer (Me numër 01.20 00089/2ex në ECA).

Unë isha tepër i interesuar në menaxhimin financiar të qëndrueshëm, sepse unë kisha qenë drejtor i përgjithshëm i buxhetit në Hollandë. Një pjesë e madhe e shqetësimit tim në atë post, ishte shpenzimi i parave në mënyrën e duhur.

Megjithatë, fillimi ynë ishte i ngadaltë. Fillimisht ne duhet të planifikonim takimet nëzyrat tona dhe të stafit të auditimit, por procedurat e Komunitetit për këtë gjë ishin tepër të vështira. Raporti i parë Vjetor u krye në vitin 1978.

Fillimisht, aspektet e menaxhimit financiar të qëndrueshëm ishin përfshirë në Raportin vjetor, dhe vetëm më vonë raportet e veçanta u përqëndruan mbi menaxhimin financiar të qëndrueshëm. Një ndarje e qartë ishte kryer në Traktatin e Mاستrihtit, për shkak të prezantimit të deklaratës së sigurisë në atë Traktat.

### **Në fillimet e ECA, të gjithë flisnin për “auditimin bazuar në sisteme”**

**André Middelhoek:** Ky ishte vendimi i parë i Gjykatës, kryerja e auditimeve me bazë sistemi, në vend të qasjes klasike të auditimit të të gjitha transaksioneve. Kjo u vendos me qëllim fuqizimin e kapacitetit të Gjykatës në fushën e menaxhimit financiar të qëndrueshëm.

Auditimet me bazë sistemi, fokusohen në ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, edhe pse duhet të shqyrtohet nëse organizata në vetvete është e qartë dhe përpos të gjithave, ndarja e funksioneve është kryer siç duhet.

### **Si ishte marrëdhënia e Gjykatës me Parlamentin dhe Komisionin European në fillimet e para?**

**André Middelhoek:** Marrëdhënia me Parlamentin European ishte e mirë në fillim, sepse Gjykata u krijua falë Kryetarit të Komitetit të Kontrollit të Buxhetit, Z.Aigner.

### **A ishte Gjykata një instrument i Parlamentit në kohën kur ajo nuk ishte ende një institucion?**

**André Middelhoek:** Jo, ne punonim për Parlamentin sepse raportet tona i dërgoheshin Parlamentit për ushtrimin e funksionit të tij si një autoritet shkarkues. Z. Aigner ndihej krenar që kishte kontribuar për krijimin e Gjykatës, por gjithashtu ai ishte i shqetësuar për garantimin e pavarësisë së institucionit. Sigurisht, gjatë kohës që Parlamenti hasi probleme gjatë punës së tij, neve mund të na kërkohej të investigonim, por nuk jam i vetëdijshëm për ndërhyrje të tjera të Parlamentit. Sapo Gjykata u bë një institucion i pavarur, Parlamenti European e fton Presidentin e Gjykatës për të prezantuar Raportin Vjetor çdo vit në seancat e tij plenare në Nëntor, në Strasburg.

### **Si u eci më tej marrëdhënia me Komisionin?**

**André Middelhoek:** Marrëdhënia me Komisionin ishte e arsyeshme. Unë nuk mund të them se ata ishin të lumtur që do të kishin një audit të jashtëm. Marrëdhëniet ishin formale dhe unë e pashë si një avantazh që ne ishim në Luksenburg dhe ata në Bruksel, edhe pse ne shpenzonim një kohë të gjatë duke udhëtuar. Ekzistonin rregulla strikte dhe formale për njoftimin dhe kryerjen e auditimit. Unë mendoj se njëfarë formaliteti është i nevojshëm në marrëdhënien mes audituesit dhe subjektit të audituar.

### **Po marrëdhënia mes Gjykatës dhe autoriteteve kombëtare si ishte?**

**André Middelhoek:** Fillimisht kishte disa problematika, sepse gjykatat kombëtare të auditimit janë institucione tërëndësishme në çdo Shtet Anëtar. Ata duhet të punojnë në një pavarësi absolute. Me krijimin e Gjykatës, puna e saj duhet të kryhej në Shtetet Anëtare, dhe me bashkëpunimin tyre.

Audituesit Kombëtarë druheshin nga frika se ata mund të vepronin nën “tutelën” e Gjykatës. Kjo sigurisht që nuk ishte e vërtetë dhe ne kishim rregulla të qarta për mënyrën si duhet të sillëshim më Shtetet Anëtare. Për mua, kjo ishte një arsye për të luftuar më vonë që Gjykata të arrinte një pavarësi me të lartë, duke u bërë një institucion i plotë.

Shumë shpesh e diskutoja këtë gjë me Gjykatën Kombëtare Hollandeze, pasi ata ishin shumë bashkëpunues, duke nënvizuar se kjo do të kontribuonte në bërjen e Gjykatës Europiane më efektive, sepse 90% e buxhetit të Komisionit shpenzohej në Shtetet Anëtare. Kjo çështje më në fund u zgjidh në Traktatin e Mastrohit.

Si një institucion, Gjykata mund të mbrojë interesat e veta në mënyrë të drejtpërdrejtë përpara Gjykatës Europiane të Drejtësisë dhe nuk varet më nga vullneti i Komisionit, i cili është dhe subjekti i kryesor i audituar për këtë çështje. Por, megjithatë ne shpresonim që të mos e ushtronim kurrë këtë fuqi. Sepse “Nëse nuk e ke fuqinë, mund të të nevojitet; por të kesh fuqi, jo domosdoshmërisht do të thotë se duhet ta përdorësh atë”.

**Në fillimet e hershme, shpenzimet orientoheshin më së shumti tek bujqësia. Më pas u krijuan Fondet e Strukturuar.**

**André Middelhoek:** Politika e bujqësisë së përbashkët financohej 100% nga Komisioni, por çdo vit kryej një procedurë pas faktit për “apurement des comptes agricoles”, i cili nënkuptonte një auditim të kryer nga vetë Komisioni për përcaktimin nëse paratë ishin shpenzuar vërtetë nga shtetet anëtare për bujqësinë dhe në përputhje me kuadrin rregullator. Në lidhje me menaxhimin financiar të qëndrueshëm, problemi për Fondet e Strukturuar, veçanërisht Fondi Rajonal, ishte nëse paratë ishin shpenzuar në projektet e duhur. Kjo ishte e vështirë për t'u audituar. Komisioni ofronte paratë, por Shtetet Anëtare duhet të përgatisnin programin dhe ta kryenin atë. Ekzistonin problematika shumë kritike. EAGGF dhe Fondet e Strukturuar ishin një shqetësim shumë i madh për Gjykatën.

**Që në fillimet e veta, ishte e qartë ECA edhe pse nuk ishte “Polic”, do të punonte edhe në parandalimin e anomalive dhe parregullsive.**

**André Middelhoek:** Kjo ishte një nga arsyet për prezantimin e auditimit me bazë sistemi: Vëmendje në dobësitë e sistemeve, e ndjekur nga përzgjedhja (sampling), veçanërisht kur ishin identifikuar këto parregullsi.

Në brendësi të Komisionit gjendej UCLAF (Unité de coordination de lutte anti-fraude). Në kohën time, UCLAF vepronte në mënyrë të pavarur nga Gjykata. Një këndvështrimin e Gjykatës, parandalimi i anomalive është përgjegjësi e Ekzekutivit.

**Le të kthehemi tek ju. Për çfarë ndiheni veçanërisht më krenarë?**

**André Middelhoek:** Unë isha njeriu që për kraha me gjithë zemër auditimin me bazë sistemi dhe menaxhimin financiar të qëndrueshëm.

Në Gjykatë, unë kisha një pozicion disi të veçantë sepse unë isha ai që më vonë do të konsiderohej një Anëtar ADAR, dhe unë qëndrova në atë pozicion për një kohë të gjatë.

**Kjo është e mrekullueshme; Që në atë kohë ju ishit përkrahës i Deklaratës së Pavarësisë (DAS), por gjithashtu i menaxhimit financiar të qëndrueshëm. Cili është ndryshimi me atë që tani e quajmë auditim performance?**

**André Middelhoek:** Unë nuk mendoj se ka një ndryshim. Emërtimet mund të ndryshojnë. Performanca lidhet me aktivitetin dhe rezultatin. Në Traktat ajo quhet menaxhimi financiar i qëndrueshëm ose nëfrëngjisht: “bonne gestion financiere”. Menaxhimi financiar shkon gjithashtu në një linjë me auditimin me bazë sistemi. Nevojiten sisteme menaxhimi shumë të mira për arritjen e rezultateve të kënaqshme.

**A ka ndonjë gjë tjetër që doni të shtoni për kohët e vjetra?**

**André Middelhoek:** Më duhet ta them se unë u përballa me një shpirt shumëbashkëpunues në Gjykatë, i cili ishte tepër i rëndësishëm për diskutimet e kryera. Gjithashtu, unë mendoj se krijimi i grupeve të auditimit ishte një hap shumë i rëndësishëm për Gjykatën. Gjatë kohës që unë isha President, unë u sigurova që Gjykata të punonte në një mënyrë të qetë por solide. Kur Finlanda, Austria dhe Suedia u bashkuan, shtimi i anëtarëve nga 12 në 15 do të ishte një ndryshim dhe komplikim i madh. Si President, më duhet të drejtoja diskutimet në Gjykatë në një mënyrë më strikte se më parë. Unë jam kurioz të mësoj nga ju se si ajo funksionon sot me 28 Anëtarë.

Një ndryshim shumë i madh në mjedisin tonë të punës ndodhi në gjysmën e dytë të viteve 80 kur ne lëvizëm në ndërtesën e re në zonën Kirchberg gjatë Presidencës së Marcel Mart. Anëtarët dhe stafi i detyrohen atij një mirënjohje tëmadhe për përpjekjet e bëra në ndryshimine madh të kushteve tona të punës.

**Mandati juaj në ECA skadoi në vitin 1995, por emri juaj lidhet gjithashtu me dorëheqjen e Komisionit Santer në 1999. Ju ishit nja në Njerëzit e Mençur, së bashku me Anëtarët e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur që u thirret për të investiguar parregullsitë e Komisionit. Ata publikuan një raport i cili çoi në dorëheqjen e Komisionit të drejtuar nga Kryeministri i mëparshëm i Luksenburgut.**

**André Middelhoek:** Anëtarët e Parlamentit European në mënyrë të vazhdueshme kishin ngritur diskutime dhe kishin demonstruar problematika lidhur me disa çështje mbi përgjegjësinë e disa anëtarëve specifikë të Komisionit, por nuk ishin të kënaqur me përgjigjet e marra.

Parlamenti European u irritua dhe e konsideroi mundësinë për refuzimin e dhënies së shkarkimit tëmadhnë vitin 1996. Në 17 Dhjetor 1998, Parlamenti refuzoi të shkarkonte Komisionin. Një lëvizje e censurësnëKomision u diskutua në 14 janar 1999 me kërkesën e Grupit të Specialistëve në Parlamentin European. Ajo u hodh poshtë nga një shumicë e vogël.

Pas këtij refuzimi, Parlamenti European vendosi të krijonte një komitet ekspertësh nga jashtë Parlamentit, në mënyrë që të ekzaminohejshin “Akuzat lidhur me Mashtrimin, Menaxhimin e keq dhe Nepotizmin në Komisionin European”. Kështu unë u bëra Kryetar i Njerëzve të Mençur. Raporti ynë u publikua në 15 Mars të vitit 1999 dhe Komisioni u dorëhoq në të njëjtën ditë.

## ECA SI NJË AUDITUES I JASHTËM

Në shoqëritë demokratike, informacioni i plotë, i saktë dhe i disponueshëm mbi implementimin e politikave buxhetore, është tepër i rëndësishëm për shqyrtimin efektiv dhe nëvendimmarrje. Një informacion i tillë, ndihmon në promovimin e menaxhimit financiar të qëndrueshëm dhe shërben si bazë për besueshmërinë. Njësoj si Shtetet Anëtare, BE ka nevojë për një auditues të jashtëm i cili mund të luajë rolin e një ruajtësi të pavarur të interesave financiare të qytetarëve të tij.

Detyra kryesore e ECA është kontrolli i të gjitha llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve në Bashkimin European. Në këtë mënyrë, ajo ndihmon Parlamentin European dhe Këshillin në vendosjen në praktikë të fuqive të tyre mbi kontrollin politik të implementimit buxhetor të BE, veçanërisht gjatë procedurave të shkarkimit.

Buxheti i përgjithshëm i BE vendoset çdo vit nga Këshilli dhe Parlamenti European. Raportet vjetore të ECA mbi buxhetin e BE dhe Fondeve Europiane për Zhvillim, së bashku me raportet vjetore speciale të agjensive të BE, ndërmarrjet epërbashkëta, institucione të tjera të decentralizuara dhe raportet e veçanta, shërbyen si bazë për procedurën e shkarkimit, në të cilën Parlamenti European vendos nëse Komisioni i ka kryer siç duhet përgjegjësitë e tij për ekzekutimin e buxhetit. ECA ja përcjell raportet e saj vjetore parlamenteve kombëtare në të njëjtën kohë që ja dërgon Parlamentit dhe Këshillit European.

Publikimet e ECA përfshijnë: raporte vjetore, raporte specifike vjetore dhe raporte specifike- bazuar në llojin e auditimit: auditimi financiar, i përputhshmërisë dhe performancës. Gjithashtu, ajo publikon opinione mbi propozime ligjore që kanë një impakt në menaxhimin financiar të BE, dhe gjithashtu deklarata pozicionimi dhe publikime ad hoc mbi çështje të financave publike të BE.

Si audituesi i jashtëm i pavarur i BE-së, ECA ofron garanci për mënyrën se si paratë janë regjistruar, shpenzuar dhe shpërndarë. Auditimi i përputhshmërisë dhe financiar fokusohet në garantimin se procedurat janë kryer në përputhje me legjislacionin, rregullat, politikat dhe procedurat. Auditimi i performancës është një ekzaminim i pavarur dhe objektiv në lidhje me tre aspektet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës, i cili ka për qëllim përmirësimet në këto fusha.

Këshilla e pavarur e krijuesve të politikave dhe vendimmarrësve të ECA është dhënia e ndihmës për përgatitjen dhe vëzhgimin e legjislacionit të ri dhe propozimet buxhetore, dhe gjithashtu kontributi në besueshmëri dhe transparencë. ECA e kryen këtë duke mundësuar rekomandime në raporte, publikimin e opinioneve mbi draft legjislacionet e BE-së, dhe kontributinnë debatin publik për përdorimin e fondeve të BE. Në këtë mënyrë, ECA ka ndihmuar në formimin e shumë iniciativave për përmirësimin e menaxhimit të fondeve të BE dhe procesit të reformimit të buxhetit.

Në një kohë kur Europa po përballet me sfida më të madha, dhe presioni në financat publike po rritet, roli i ECA është rritja e rëndësisë. Ajo parandalon risqet, garanton siguri dhe i ofron krijuesve të politikave të BE mënyra se si mund të përmirësohet menaxhimi i financave publike dhe garanton se qytetarët e Europës janë të vetëdijshëm se si paratë e tyre po shpenzohen. Kjo është thelbi i kontributit të ECA në forcimin e legjitimitetit demokratik dhe qëndrueshmërisë së Bashkimit European.

## ANDRÉ J. MIDDELHOEK, KRIJUES DHE PRESIDENT I ECA

## DËSHMI

## Procesi i Integritimit European

“Gjykata e Audituesve duhet të njihet si auditues i jashtëm”

Intervista me Luxemburger Wort, bisedë me Presidentin e Gjykatës Europiane të Audituesve, André J. Middelhoek, 9 Dhjetor 1995

Përgatitur nga Rosmarie Carotti



Andre J. Middelhoek, krijues i  
ECA dhe President

Për aq kohë sa pasardhësit janë emëruar, mandatet e disa prej anëtarëve të Gjykatës Europiane të Audituesve, duke përfshirë edhe Presidentin e saj do tërësojnë mandatet. Sapo mandatet e reja të vijë në fuqi në 1 Janar 1996, Presidenti aktual André J. Middelhoek, automatikisht do të rrijë në zyrën e tij deri në 31 Dhjetor . Ne folëm me Presidentin në ikje dhe punën e tij në Gjykatën e Audituesve. Raporti Vjetor i Gjykatës për vitin 1994 përmban një paraqitje grafikë të njëndarje gjeografike të shpenzimeve që i janë alokuar Luksenburgut, por nga të cilat nuk përfiton Luksenburgu, ose të paktën jo në masën e parashikuar. Kjo ka shkaktuar njëtrazirë shumë të madhe dhe pakënaqësi të konsiderueshme nga ana e Luksenburgut. A do të dëshironite ta komentonte Presidenti në ikje këtë?

“Të gjithë shtetet janë trajtuar në mënyrë të barabartë”

Z. Middelhoek është i vendosur për të qartësuar një pikë. Raporti i Gjykatës nuk ofron ndonjë informacion mbi kontribuesit në total ose përfituesit në total të Shteteve Anëtare.

Ai paraqet disa të dhëna të përpunuara nga Komisioni. Këto të dhëna lidhen me shpenzimet e kryera nga Komisioni ose Komuniteti në Shtetet anëtare.

Nuk ekzistojnë pagesa për qeveritë dhe të gjithë shtetet janë trajtuar në mënyrë të barabartë, thekson ai. Të dhënat janë rishikuar nga Gjykata Europiane e Audituesve dhe gabimi është korrigjuar. Përpos kësaj, informacioni i dhënë nga Komisioni rezulton të jetë i saktë.

Sipas Presidentit, është njëqështje komplet e ndryshme nëse kriteri i shpërndarjes ose pika kyçe e përdorur nga Komisioni për këtë alokimështë mjaftueshëm e kuptueshme, në sensin se Komisioni nuk mund të bëjë një ndarje gjeografike për institucione të ndryshme Europiane.



Në lidhje me ligjshmërinë e tij personale në Gjykatën Europiane të Audituesve, z. Middelhoek, me shumë krenari shpjegoi se, ai nëfillim kishte dhënë një kontribut vendimtar në vendimin e Gjykatës për auditimet me bazë sistemi si metodologji punë. Kjo do të thoshte se Gjykata nuk do të shqyrtonte të gjitha shpenzimet, përfshirë artikujt me vlerë të vogël. Çështja do të ishte më e rëndësishme. Ajo do të shqyrtonte sistemet dhe procedurat, dhe aplikimin e legjislacionit në sistemet praktike duke vlerësuar riskun.

Me identifikimin e dobësive, auditimi do të fokusohet në këto pika. Kjo nënkupton një aplikim eficient të burimeve, në ndryshim me një metodë selektive. Si rezultat, Gjykata e Audituesve nuk është asnjëherë në kushtet për të dhënë një paraqitje të plotë në Raportin e saj Vjetor. Për herë të parë në këtë vit, nëkushtet e sapokrijimit të Deklaratës së Sigurisë(DAS) mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të Komunitetit, kemi të bëjmë me një risi, pasi Gjykata nuk do të kryejë një gjykim të përgjithshëm.

### “Gjykata është bërë një institucion”

Sipas Z. Middelhoek, një tjetër sukses qëndron në faktin se Gjykata u bë një institucion nën Traktatin e Mastrihtit, duke përcjellë një bashkëpunim më të ngushtë mes audituesit dhe subjektit të audituar. Megjithatë, ekzistojnë disa çështje që ende nuk janë arritur: si për shembull kërkesa që nuk u diskutuan në konferencën ndërqeveritare, si e drejta e Gjykatës Europiane të Audituesve për të shkuar në Gjykatën Europiane të Drejtësisë për të mbrojtur të drejtat e saj dhe privilegjet kur nuk arrin bashkëpunimin e duhur nga institucionet apo autoritetet e Shteteve Anëtare. Ky aspekt nuk është plotësisht i rregulluar nga Traktati i Mastrihtit, nënvizon ai; ai dëshiron gjithashtu të shikojë arritje edhe në politikat e përbashkëta ndërkombëtare, politikat e brendshme dhe të drejtësisë, si për shembull rasti i Europolit.

Sipas Presidentit, Gjykata Europiane e Audituesve dëshiron të njihet si një auditues i jashtëm që nuk ka nevojë për një vendim të ri për secilin aktivitet të saj. Gjykata duhet parimisht të shqyrtojë të gjitha shpenzimet që kalojnë përmes Komunitetit. Momentalisht, nëse paratë vijnë nga buxheti i Bashkimit Europian, kjo auditohet automatikisht nga Gjykata, por kur vjen nga Shtetet Anëtare duhet të vendoset nga Këshilli. Këto përmendim rastin e Mostarit, në ish Jugosllavi, ku administratorit i ishte besuar rikonstruksioni duke përdorur fondet e EC dhe ndihmat nga Shtetet Anëtare. Kjo qasje do të çojë në vonesa dhe mungesë të vazhdueshmërisë, tha ai.

Z. Middelhoek do të donte ti jepte pasardhësit të tij disa këshilla. “Në Gjykatë, është e rëndësishme të respektohet bashkëpunimin dhe çdokush duhet të ketë të qartë se të gjitha vendimet merren nga një panel me 15 Anëtarë. Vetëm debati konstruktiv, mund të sjellë në arritjen e rezultateve të duhura”, tha ai.

### “Eksperiencia pozitive në Dukatën e Madhë”

Ende nuk është bërë i ditur pozicioni që z.Middelhoek do të ketë në sektorin ekonomik dhe financiar, pasi ai të largohet nga Gjykata. Megjithatë, ai dëshiron të theksojë eksperiencën e tij pozitive personale dhe njerëzore në Luksenburg.

## DËSHMI

Pavarësia, kolegjaliteti dhe vazhdueshmëria

Intervistë e Luxemburg Wort me Presidentin e ri të Gjykatës Europiane të Audituesve

Jan O.Karlsson

9 Janar 1999

Intervista e përgatitur nga Rosmarie Carotti



Jan O. Karlsson, krijues  
dhe President i ECA

**Z. Karlsson, jemi shumë të lumtur që i dhatë mundësi gazetës sonë intervistën tuaj të parë pas emërimit si President i Gjykatës Europiane të Audituesve.**

**“Unë kam një ëndërr”, tha Mbreti Martin Luther. A keni ju njëëndërr për Bashkimin Europian, Gjykatën Europiane të Audituesve dhe Suedinë?**

**Jan O. Karlsson:** Po, unë e kam njëëndërr për Europën. Para së gjithash, unë dua të jetoj në një Europë që u përket të gjitha vendeve Europiane. Sigurisht, që kjo do një punë të gjatë përpara por meqenëse unë vij nga një vend që hezitoi të bëhej pjesë e BE, kjo është tepër e rëndësishme për mua. Ëndërra ime e dytë është ruajtja e karakterit unik dhe të veçantë të Bashkimit Europian. BE përbëhet nga Shtete Anëtare që kanë karakteristikat e tyre. Në ëndërrën time, ashtu edhe në atdheun e përbashkët Europian. Ne të gjitha duhet të kemi një atdhe me gjuhën dhe historinë e vet e cila duhet ruajtur.

Le të vazhdojmë me Gjykatën e Audituesve. Pavarësia e saj është tepër e rëndësishme. Sigurisht që unë e kam ndjekur me shumë interes debatin mbi forcimin e rolit të institucionit. Nënvizimet e fundit nga Kancelari Gjerman kanë qenë tejet interesante, edhe nëse ne nuk do të jemi pjesëmarrës shumë aktiv, unë jam pro diskutimeve në këtë pikë. Le të kthehemi në urimet e mia për Gjykatën Europiane të Audituesve: Unë dua që ajo të jetë e pavarur në marrëdhëniet e jashtme me Bashkimin Europian. Unë dua që ne të jemi aq objektiv dhe eficient sa është e mundur, unë dua që njerëzit të mendojnë “Kështu tha ECA, dhe kështu është”. Ne kemi qenë një institucion i pavarur që me ratifikimin e Traktatit të Mastroitit.

Brenda institucionit, unë i kushtoj tepër rëndësi besimit reciprok dhe ndarjes së përgjegjësive. Si President, unë jam thjesht i pari ndër të barabartët. Në një sistem kolegjal, zgjedhja e presidentit nuk është një ngjarje dramatike. Ne ende qëndrojmë në të njëjtën tavolinë, secili ka përgjegjësitë e veta dhe ndajmë detyrat me njëri tjetrin. Unë jam një Suedez, dhe Suedia gjithnjë ka përdorur sistemet kolegiale.

Pavarësisht kësaj, fundi i presidencës së Bernhard Fiedmann është fundi i një epoke, ashtu siç ishte fundi i epokës së Andre Middelhoek. Nën udhëheqjen e Middelhoek, Gjykata Evropiane e Audituesve ishte një institucion i pavarur, ndërsa në udhëheqjen e Fiedmann ajo u bë e famshme. Kolegjialiteti dhe pavarësia atëherë, me fjalën pasardhëse Vazhdeshmëri.

**Si President i ri, a do të merrni dosjet e paraardhësit tuaj dhe të vazhdoni të punoni mbi to? E kam fjalën veçanërisht për dosjet e van Buitenen, gjë që çoi në një votim mosbesimi kundër Komisionit në Parlamentin Evropian. Cilat janë mendimet tuaja për krijimin e një komisioni të pavarur hetimor parlamentar?**

**Jan O. Karlsson:** Sigurisht që ne do ta përfundojmë punën tonë mbi dosjet e van Buitenen dhe do të vazhdojmë punën tonë si zakonisht. Këtë e kemi vendosur me të gjithë anëtarët. Duket se ka pasur keqkuptime në lidhje me rolin e Gjykatës së Audituesve në procedurën e shkarkimit të Komisionit. Ky është një proces politik dhe ne nuk kemi të bëjmë me të. Qytetarët evropianë shpesh do të donin të na shihnin si një autoritet policor, një prokuror dhe një gjykatë penale, por nuk jemi asnjë nga këto. Detyra jonë është të gjejmë zgjidhje për problemet në interes të qytetarëve, jo vetëm të tatimpaguesve. Qytetarët evropianë e dinë se Traktatet na kërkojnë të shqyrtojmë të gjithë buxhetin e BE.

Në rastin e van Buitenen, natyrisht, i kemi kaluar informacionet tona Këshillit të Ministrave dhe Parlamentit Evropian dhe po punojmë së bashku me ta. Sa i përket komisionit hetimor parlamentar, është vetëm në interes të qytetarit që të ruajmë pavarësinë tonë institucionale dhe të distancohemi nga konfliktet mes institucioneve të tjera.

**A do të sjellë ndryshime emërimi juaj si President, për sa i përket marrëdhënieve me vendet që dëshirojnë të bashkohen me BE?**

**Jan O. Karlsson:** Vazhdimësia është e rëndësishme edhe në këtë drejtim. Megjithatë, do të jemi të detyruar të përfshijmë më nga afër autoritetet kombëtare të auditimit, sepse marrëdhëniet e tyre me shtetet e reja anëtare gjithashtu do të ndryshojnë. Ne kemi detyrën e rëndësishme përpara nesh për auditimin e fondeve të BE-së në këto vende. Përpjekjet e nisura nga z. Fiedmann për të koordinuar metodat e punës së autoriteteve kombëtare të auditimit dhe metodat e Gjykatës Evropiane të Audituesve duhet të zhvillohen më tej, duke përfshirë përdorimin e standardeve të përbashkëta evropiane të auditimit. Ne vendosim një vlerë të madhe në bashkëpunimin teknik dhe shkëmbimet mes stafeve.

**Çfarë nënkupton Bashkimi Evropian për Suedin? Një kulturë? Një marrëveshje politike? Fundi i rivalitetit franko-gjerman? Hegjemonia gjermane me anë të euros?**

**Jan O. Karlsson:** Për Suedin, BE do të thotë një ndryshim shumë më i madh nga sa supozohet apo bihet dakord. Për këtë arsye, jam i lumtur që do të kemi Luksemburgun si shembull për ta ndarë me bashkatdhetarët e mi. Në Suedi, ne nuk e kemi njohur luftën që prej 180 vjet dhe ndonjëherë mendojmë se ne e kemi fituar këtë privilegj duke qenë më mirë se të gjithë të tjerët. Njëherë, në shtëpi, për të zbavitur miqtë e mi finlandezë, thashë se kishte tre fuqi të mëdha botërore: SHBA, Bashkimi Sovjetik dhe Suedia. Dhe tani që komunizmi ka rënë, mbeten vetëm SHBA dhe Suedia. Ajo që dua të them është se ne i shohim gjërat ndryshe nga sa i shohin Luksemburgezët. Ne kurrë nuk kemi qenë pezull mes dy fuqive, kemi qëndruar gjithmonë jashtë këtyre gjërave. Ndryshe nga Luksemburgu, që i përket diçkaje më të madhe, në Suedi kjo nuk është një çështje në vetvete. Tani është koha ta mësojmë këtë dhe ashtusiq themi ne suedezët, "ne do të bëhemi anëtarë".

Nuk e di nëse Suedia do të jetë gati të bashkohet me bashkimin e monedhës deri në vitin 2002, por kam vërejtur një ndryshim pozitiv në opinionin publik. Unë jam i sigurt. Në Suedi, euro do të vijë nga Lindja, kur finlandezët vizitor nga Helsinki do të zbresin nga tragetit dhe do të pyesin: "A duhet me të vërtetë të shkëmbejm paratë tona? A nuk mund të paguajmë në euro?"

### **Cili është roli i Gjykatës Evropiane të Audituesve në lidhje me Bankën Qendrore Evropiane?**

**Jan O. Karlsson:** Ashtu si institucionet e tjera evropiane, shpenzimet administrative të Bankës Qendrore Evropiane i nënshtrohen kontroleve nga Gjykata Evropiane e Audituesve. Aktivitetet bankare makroekonomike të tilla si stabiliteti i çmimeve, janë qëllime politike të cilat nuk janë në detyrat tona audituese. Mandati ynë është përcaktuar nga Traktatet e BE-së. Unë jam i bindur se ekziston një kontroll i mjaftueshëm makroekonomik. Banka gjithashtu kontrollon kapitalin e vet. Ne besojmë se do të duhet të auditojmë gjithashtu aktivitetet financiare që rrjedhin nga pakti i stabilitetit në të ardhmen. Ndërkohë po vazhdojnë diskutimet rreth angazhimeve më të përshtatshme për këtë qëllim.

### **Një pyetje e fundit rreth formës dhe përmbajtjes së raporteve të ardhshme të Gjykatës Evropiane të Audituesve. Në të ardhmen, a do të publikohen emrat e personave dhe kompanive që kanë kryer veprime korruptive?**

**Jan O. Karlsson:** Raportet tona duhet të bëhen më të mira, më të shkurtra dhe më të qarta, pasi nuk mund të presim deri në publikimin e raportit vjetor për t'i dhënë informacione Këshillit dhe Parlamentit. Interesi mbi auditimet financiare në BE po rritet, por kjo nuk do të thotë se ne duhet të bombardojmë autoritetin buxhetor me raporte.

Ne presim me interes një gjykim nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë për publikimin e emrave të personave dhe kompanive që kanë kryer veprime korruptive, megjithatë mendoj se kjo duhet të mbetet një përjashtim.

BERNHARD FRIEDMANN, ISH-ANËTAR I ECA DHE PRESIDENT

## DËSHMI

**Organet e auditimit gjithashtu duhet të japin këshilla të mira.**

Një intervistë e Luxemburger Wort me Bernhard Friedmann në fund të mandatit të tij si President i Gjykatës Evropiane të Audituesve.

3 shkurt 1999

Intervistë nga Rosmarie Carotti



Bernhard Friedmann,  
krijues dhe President i ECA

**Z. Friedmann, cili është vlerësimi juaj i mandatit si President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, i cili tani është në përfundim? Ju jeni akoma anëtari gjerman i Gjykatës dhe jeni përgjegjës për "Bashkëpunimin me vendet në zhvillim dhe ato jashtë BE-së (buxheti i përgjithshëm i BE-së)".**

**Bernhard Friedmann:** Tre vitet e fundit ishin mandati i parë presidencial gjatë së cilës Gjykata ishte një institucion plotësisht i BE-së në të gjitha termet: siçë dini, ky ndryshim erdhi falë Traktatit të Mastroiitit. Unë kam kujtime të mira për tre vitet e mia si President. Natyrisht kisha parashikuar një sërë objektivash që unë doja të arrija, por më parëdua të theksoj se gjithçka që kemi arritur është arritje e të gjithë Anëtarëve.

Një nga qëllimet e mia ka qenë krijimi i një atmosfere të mirë pune dhe krijimi i marrëdhënieve të mira me zyrat kombëtare të auditimit. Për këtë arsye, vendosa të vizitoj të gjitha zyrat kombëtare të auditimit të vendeve anëtare të BE, i shoqëruar nga Anëtarët përfaqësues pranë Gjykatës nga secili vend, duke takuar përfaqësues të qeverive, kryesisht ministra të financësapo thesarit. Kam folur gjithashtu edhe para komiteteve të ndryshme të parlamenteve kombëtare.

Qëllimi im i dytë ishte krijimi dhe vazhdimi i një marrëdhënie të mirë pune me autoritetin buxhetor të Bashkimit Evropian. Më konkretisht, unë synova të arrija marrëdhënie të qarta me Komitetin e Kontrollit të Buxhetit të Parlamentit Evropian dhe Këshillin e Evropës për Çështjet Ekonomike dhe Financiare.

Arritja e një marrëdhënie pune konstruktive me Komisionin, ishte objektivi im i tretë. Natyrisht, nuk është puna jonë të japim lavdërime: jemi këtu për të kontrolluar se si Komisioni ka zbatuar buxhetin. Që në fillim, për mua ishte shumë e rëndësishme të kisha një atmosferë pune të mirë dhe konstruktive brenda vetë Gjykatës. I kam arritur të gjitha këto.

**Komisioni ka qenë nën një breshëri kritikash dhe Parlamenti e refuzoi shkarkimin për vitin financiar 1996. Çfarë mendoni për marrëdhënien e Gjykatës së Audituesve me Komisionin?**

**Jo gjithshka në politikat e BE-së është plotësisht me gabime.**

**Bernhard Friedmann:** Unë mund t'ju siguroj se ne e kryejmë punën tonë krejtësisht të pavarur. Ju e dini, sigurisht, që puna e Gjykatës së Auditimit është të kontrollojë punën e Komisionit, nëse është në përputhje për buxhetin e BE-së. Ne e zbatojmë këtë detyrë në ambientet e Komisionit dhe gjithashtu në vendin anëtar ku aktualisht përdoren paratë e BE-së. Tani, ekziston gjithmonë një tension i caktuar në marrëdhëniet ndërmjet audituesit dhe subjektit të audituar - kjo është e natyrshme. Megjithatë, në përgjithësi, marrëdhënia jonë e punës është konstruktive. Sa i përket çështjes së shkarkimit që përmendet, nëse Komisionit nuk i jepet shkarkimi, kjo sigurisht lidhet me raportet që ne kemi lëshuar. Ndonjëherë, njerëzit kanë pyetur pse vetë Gjykata nuk ka sugjeruar që Komisionit ti refuzohet shkarkimi. Kjo nuk është puna jonë. Ne i paraqesim rezultatet e auditimeve tona dhe i takon Këshillit dhe Parlamentit që t'i përdorë ato në marrjen e vendimit politik nëse do të japë shkarkimin apo jo.

Duke thënë këtë, dua të kundërshtoj përshtypjen se çdo gjë në politikën e BE-së është plot me gabime. Kur duhet të bëhen kritika, ne e bëjmë këtë, por dua të jem shumë i qartë se BE-ja ka të bëjë me shumë më tepër sesa thjesht disa parregullsi të çuditshme këtu apo atje. Kur raportet tona përmenden gjatë diskutimeve mes Parlamentit dhe Komisionit, kurrë nuk kemi për qëllim ta kritikojmë Komisionin në terma të përgjithshëm. Ne po bëjmë vetëm punën tonë, që është të theksojmë dobësitë.

**Gjykata ka publikuar një raport të posaçëm për dobësitë e UCLAF, Njësisë Koordinuese të Komisionit kundër Mashtrimit. Cili është mendimi i Gjykatës për ngritjen e një zyre hetimi evropiane kundër mashtrimit?**

**Bernhard Friedmann:** Siç e dini, Komisioni tashmë ka një njësi kundër mashtrimit. Ne punojmë së bashku me këtë njësi, por gjithashtu edhe e kontrollojmë atë.

**Rritja e pavarësisë së UCLAF**

Në bazë të atij auditimi, ne kemi publikuar një raport në të cilin kemi pasqyruar një sërë dobësish. Unë dhashë hollësi mbi këtë auditim në fjalimin e mbajtur në Parlamentin Europian më 17 nëntor. Dobësia e UCLAF është se ai ka juridiksion vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me Komisionin dhe jo institucionet e tjera evropiane. Është gjithashtu problematike që stafi i saj ka tendencë të qëndrojë atje vetëm për një periudhë të shkurtër, para se të kthehen në vendet e tyre. Përveç kësaj, nuk është e qartë se kush ka akses në pajisjet e saj kompjuterike. Parlamenti ngriti një diskutim, i cili më herët ishte ngritur nga Komisioni, nëse duhet të krijohet një institucion i ri për të luftuar mashtrimin i quajtur OLAF dhe çfarë kompetencash duhet të ketë ndaj institucioneve. Gjykata e Audituesve

është pyetur për mendimin e saj lidhur me këtë dhe unë nuk dua të bëj komente të parakohshme. Ajo që mund të them është se ne e kemi diskutuar këtë shpesh në mbledhjet e Gjykatës. Në këtë linjë dhe me miratimin e Gjykatës, unë deklarova në fjalën time në Parlament dhe në një seminar mbi zbulimin e mashtrimeve që u mbajt atje, se ne besojmë se UCLAF ka nevojë për më shumë kompetenca dhe aftësi për të audituar të gjitha institucionet e BE. Pavarësia e saj gjithashtu duhet të përfordhet dhe pozicioni i saj duhet të jetë i ngjashëm me atë të Kontrolluesit Financiar të Komisionit.

**Dosjet e van Buitenen, të cilat kanë inkriminuar Komisionin, janë shpërndarë midis anëtarëve dhe sektorëve të Gjykatës së Audituesve. A mund të jemi të sigurt se informacioni do të trajtohet në vazhdim?**

**Bernhard Friedmann:** Z. van Buitenen na vuri në dispozicion dosjet që ai besonte se përmbanin dëshmi të parregullsive në Komision. Ne pranojmë informacion nga çdo burim, qoftë ai zyrtar i një institucioni tjetër ose i një individ privat. Ne hetojmë edhe në drejtime anonime dhe kemi procedura specifike për ta bërë këtë. Ne shqyrtoam dosjet, i listuam ato, lëshuam një vërtetim pranimit dhe, në përputhje me një vendim të gjykatës, i shpërndamë mes sektorëve sipas përmbajtjes së tyre. Kemi metoda të përbashkëta pune të qëndrueshme: këto nuk ndryshojnë ndërmjet sektorëve.

Ne gjithashtu kishim mbështetjen e dy kolegëve nga UCLAF. Ata kanë punuar dy ditë duke shqyrtuar dosjet, dhe u kemi dhënë atyre fotokopje të dokumenteve të caktuara të cilat ata i kërkuan. Shumë transaksione ishin të njohura për ne dhe për Komisionin tashmë; të tjerat dukeshin të reja.

**Cili është roli i Gjykatës Evropiane të Audituesve në raport me forcat e ndryshme të policisë së BE-së?**

**Bernhard Friedmann:** Gjykata Evropiane e Audituesve nuk është një shërbim prokurorial dhe as nuk është një shërbim policor në vetvete. Puna e saj është të kontrollojë nëse buxheti i BE-së është zbatuar në mënyrë të ligjshme, korrekte dhe ekonomike. Por kur gjejmë raste substanciale të korrupsionit dhe mashtrimit, ne punojmë së bashku me agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit.

Traktati i Europol, i cili përmban dispozita për krijimin e një autoriteti evropian të policisë, thotë se llogaritë e autoritetit do të auditohen nga një komision prej tre audituesish të emëruar nga Gjykata Evropiane e Audituesve.

**A nuk do të ishte e dobishme t'i jepni Gjykatës Evropiane të Audituesve fuqinë për të vendosur sanksione?**

**Bernhard Friedmann:** Në prag të Traktatit të Amsterdimit u pyetëm disa herë nëse Gjykata e Audituesve donte të kishte pushtetin për të vendosur sanksione. Institucionet e auditimit në BE ndryshojnë në përgjegjësitë e tyre dhe në metodat e tyre të punës. Ekzistojnë organet e auditimit të cilat funksionojnë në një farë mase si një gjykatë dhe



kanë aftësinë për të vendosur sanksione ndëshkuese. Ka të tjerë, siç është zyra kombëtare e auditimit të Suedisë, të cilët vetëm mund t'i dorëzojnë raportet e tyre qeverisë kombëtare, apo si Danimarka, e cila është pak a shumë pjesë e administratës parlamentare. Ndërkohë që ka edhe organe të auditimit si Gjykata Evropiane e Audituesve. Për një kohë të gjatë, unë kam drejtuar komitetin e buxhetit në parlamentin gjerman. Përvoja ime atje më tregoi se është më mirë nëse organet e auditimit nuk kanë fuqinë të vendosin sanksione, sepse gjithmonë ekziston rreziku që ne do të dalim kundër derve të mbyllura. Organet e auditimit gjithashtu duhet të jenë në gjendje të japin këshilla. Duhet të ketë një dialog të ndjeshëm mes audituesit dhe subjektit dhe kjo është shumë më e lehtë dhe shumë më efektive nëse nuk ekziston kërcënimi për sanksione në sfond.

## GJYKATA E AUDITUESVE DHE RENDI JURIDIK I BASHKIMIT EVROPIAN

Detyrimet ligjore e BE-së (p.sh. në formën e traktateve, rregulloreve dhe direktivave) kanë përparësi mbi të drejtën kombëtare dhe mund të thirren kundër saj (në bazë të Aktgjykimeve të Gjykatës së Drejtësisë Nr. 26/62 Van Gend en Loos dhe Nr. 11/70 Internationale Handelsgesellschaft).

Rendi ligjor i BE-së është hartuar në dy lloje legjislacionesh:

### I. Legjislacioni primar

**Legjislacioni primar** është niveli më i lartë i legjislacionit dhe ka përparësi mbi të gjitha llojet e tjera të së drejtës së BE-së. Kjo kategori përfshin Traktatin për Bashkimin Evropian (TEU), Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe anekset dhe protokollet e tyre, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare, Kartën e të Drejtave Themelore dhe parimet e përgjithshme të ligjit.

Neni 287 i TFEU përcakton fushëveprimin e përgjithshëm të aktivitetit të auditimit të Gjykatës së Audituesve. Ai parashihet një përgjegjësi të gjerë për Gjykatën në lidhje me shqyrtimin e llogarive të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të Unionit dhe të të gjitha organeve, zyrave apo agjencive të krijuara nga ai, përderisa akti themelues nuk e përjashton një ekzaminim të tillë. Për më tepër, sipas Nenit 287 (3) TFEU, Gjykata ka akses në çdo dokument ose informacion të nevojshëm për të kryer detyrën e saj.

Legjislacioni primar gjithashtu përfshin të drejtat themelore, të cilat janë pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së siç përcaktohet në nenin 6 (3) të TFEU. Këto përfshijnë të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e vendosura nga Gjykata e Drejtësisë si rrjedhojë e rendit juridik të BE-së, duke u bazuar njëkohësisht në legjislacionin kombëtar, jurisprudencën dhe traditën ligjore. Për më tepër, të drejtat themelore janë të përfshira në Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore, e cila, sipas nenit 6 TEU, ka të njëjtin status të ligjit primar si Traktatet.

Në bazë të parimeve të përgjithshme ligjore, Gjykata e Drejtësisë, në *Ismeri Evropa vs Gjykatës së Auditorëve, C-315/99 P*, konfirmoi se në përputhje me parimin e së drejtës për seancë dëgjimore, subjektet e audituara duhet të kenë të drejtën "të bëjnë vërejtje në ato pika që u referohen atyre me emër, përpara se ato të jenë përfundimtare" (paragrafi 29). Në këtë mënyrë, Gjykata e Drejtësisë pranoi se parimi kundërshtues zbatohet në Gjykatën e Audituesve dhe se subjektet e audituara kanë të drejtë të dëgjojnë pikëpamjet e tyre.

## II. Legjislacioni sekondar ose derivat

**Legjislacioni sekondar** është niveli nën Traktatet dhe përfshin rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet dhe opinionet. Legjislacioni sekondar nuk mund të kufizojë kompetencat e Gjykatës sipas Traktatit. Disa legjislacione sekondare, siç janë rregulloret, direktivat dhe vendimet e parashikuara nga Neni 288 TFEU, janë ligjërisht të detyrueshme. Pjesa tjetër, siç janë rekomandimet dhe opinionet, nuk janë të tilla edhe pse mund të kenë efekte të tjera (shih më poshtë).

a) **Rregulloret** janë të përgjithshme dhe detyruese në tërësinë e tyre dhe nuk kërkojnë masa të posaçme zbatuese. Në raste të caktuara, ato mund të aplikohen gjithashtu drejtpërdrejtë tek individët.

Një shembull është Rregullorja Financiare nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012 mbi rregullat financiare që zbatohen në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit. Nenet 161 et seq. forcojnë fushëveprimin e kompetencave të Gjykatës së Audituesve, veçanërisht në lidhje me të drejtën e aksesit në informacione dhe dokumente, duke i ofruar Gjykatës të gjitha lehtësitë që i nevojiten për të kryer detyrën e saj.

b) **Direktivat** janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare individualisht, në lidhje me një rezultat të caktuar që duhet arritur. Në parim, ato kërkojnë që autoritetet kombëtare t'i përfshijnë ato në sistemet e tyre kombëtare për të prodhuar efektin e dëshiruar ligjor (dmth. një ligj kombëtar, dekret ligjor etj.). Nuk ka rend të përparësisë ndërmjet rregulloreve dhe direktivave, pasi secili ka të njëjtën vlerë.

c) **Vendimet** janë të detyrueshme në tërësinë e tyre, për ata të cilëve u drejtohen (p.sh. një shtet ose një shoqëri), p.sh. në aspektin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP), rimëkëmbjen e ndihmës shtetërore të paligjshme, ligjshmëria e proceseve të shkrirjeve në biznese të caktuara me tregun e përbashkët etj.

d) Burimet dytësore gjithashtu përfshijnë akte të tilla si **rekomandime, opinione apo udhëzime** që nuk imponojnë ndonjë të drejtë ose detyrim për ata të cilëve u drejtohen. Duke qenë se nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe nuk janë të detyrueshme, ato nuk mund të përdoren ligjërisht kundër një rregulloreje ose një direktive. Pavarësisht se nuk janë ligjërisht të detyrueshme, akte të tilla janë një formë e "ligjit të butë" dhe mund të kenë pasoja të rëndësishme politike. Ato gjithashtu mund të përdoren për të interpretuar dispozitat e së drejtës evropiane ose kombëtare (rasti C-322/88 Grimaldi kundër fondeve të punës), siç janë udhëzimet e Komisionit për ndihmën shtetërore. Nuk ekziston një listë e plotë e akteve të tilla "të buta". Kjo kategori përfshin programe, konkluzione, rezoluta, mendime dhe çdo akt të përgjithshëm që përcakton drejtime ose objektiva (Rastet e bashkuara C-189/02 P, C-202/02 P, C-205/02 P deri C-208/02 P dhe C -213 / 02 P, aktgjykimi i Gjykatës së Drejtësisë në Dansk Rorindustri dhe të tjerët kundër Komisionit).

Si pjesë e misionit të saj për të shqyrtuar dhe përmirësuar menaxhimin e buxhetit të BE-së, Gjykata e Audituesve publikon raporte me një fuqi ligjore të barabartë me atë të rekomandimeve. Subjektet e audituara nuk janë të detyruar ligjërisht të respektojnë rekomandimet e Gjykatës: p.sh. Komisioni mund të vendosë në mënyrë të pavarur nëse do të zhdëmtojë shumat të cilat Gjykata i konsideron se janë disbursuar në mënyrë të parregullt. Edhe pse raportet e Gjykatës nuk kanë forcë ligjore formale, vlera e tyre politike dhe autoriteti i Gjykatës sigurojnë që ata të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi aktet e audituara (shih në lidhje me këtë, vendimin e Gjykatës së Drejtësisë në rastin C-539/09, vs Republika Federale e Gjermanisë).

Për më tepër, Gjykata e Audituesve duhet të konsultohet për çështje legislative, p.sh. shqyrtimin e rregullave financiare (neni 322 TFEU), luftën kundër mashtrimeve që ndikojnë në interesat financiare të BE-së (neni 325 (4) TFEU) ose Rregullorja e Stafit (neni 336 TFEU). Megjithëse Gjykata e Audituesve duhet të konsultohet në këto fusha, opinionet e saj nuk janë të detyrueshme për legjislativin, pra për Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

## ZGJERIMI I VITIT 2004 I BASHKIMIT EVROPIAN DHE NDRYSHIMET E TJERA PËR ECA

Më 7 qershor 2004 nëntë anëtarë të Gjykatës së Audituesve u betuan për një mandat gjashtë vjeçar duke filluar nga 7 maji 2004. Anëtarët përfaqësonin nëntë nga dhjetë vendet që u bashkuan me BE më 1 maj 2004. Emërimi i anëtarit të dhjetë nga Qipro u prit në vjeshtë të vitit 2004.

Betimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit, Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Audituesve tradicionalisht zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë. Gjithashtu duhet të theksohet se anëtarët e Komisionit dhe të Gjykatës së Audituesve mund të shkarkohen vetëm me vendim të Gjykatës së Drejtësisë, në rast se ata nuk i përmbushin më kushtet ose detyrimet që lindin nga postet e tyre. Për këtë arsye, është logjike që edhe marrja e kësaj detyre duhet të zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë.

Zgjerimi i vitit 2004 në 25 shtete anëtare paraqiti shumë sfida për ECA. Një ndjenjë më e madhe e përgjegjësisë zëvendësoi frymën e mëparshme të "pronësisë" së ECA (një anëtar përgjegjës për një sektor) pasi ECA u riorganizua në një sistem me dhoma.

Në vitin 2004, ECA u bë anëtare e INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit). Anëtarësimi i plotë nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në qëndrimin e miratuar nga Gjykata Evropiane e Audituesve. Rëndësia e saj lidhet më tepër me sigurinë e pjesëmarrjes së barabartë me anëtarët e tjerë. Si anëtare, Gjykata ka gjithashtu një kontribut në vendimmarrjen brenda INTOSAI-t.

Më 1 janar 2005, Komisioni hapi rrugë të reja me reformën e tij. Buxhetimi i bazuar në aktivitete (ABB) dhe Menaxhimi i bazuar në Aktivitete (ABM), si dhe një sistem i ri kontabël, sollën ndryshime në punën e ECA.

Që nga viti 2006 e në vazhdim, auditimi i performancës gjithnjë e më shumë po vihej në qendër të vëmendjes në ECA.

U prezantua një qasje "e rishikuar" e DAS, e cila parashikonte formulimin e një "modeli sigurimi", dhe përdorimin e "pemëve vendimarrëse" për të ilustruar procesin dhe rivlerësimin e burimeve kryesore për DAS. "Modeli i sigurisë" synonte të ndihmonte audituesit në përcaktimin e nivelit të besimit që rrjedh nga dy burimet kryesore të DAS-it, përkatësisht vlerësimin e sistemeve të mbikëqyrjes dhe kontrollit dhe testimin substancial.

JACEK UCZKIEWICZ, DHOMA E LARTË E KONTROLLIT, POLONI

## DËSHMI

## Polonia, tigr i ri i Evropës

Autoritetet Supreme të Auditimit Evropian dhe Polak po përgatiten për bashkimin e Poloninë me BE.

Intervistë me Zv.Presidentin Jacek Uczkiewicz nga Dhoma e Lartë e Kontrollit të Polonisë

Luxemburger Wort, 20 Tetor 1998

Intervistë nga Rosmarie Carotti

Pavarësisht situatës së përçarë politike në parlamentin polak, kanë konsensus pothuajse të plotë mbi pranimin në BE, edhe pse natyrisht ekziston frika lidhur me lirinë e lëvizjes së personave, mallrave dhe shërbimeve. Megjithatë, kjo përbën një vendim historik përkatësie. Polonia e ka ndjerë gjithmonë veten pjesë të Evropës në aspektin e kulturës dhe mentalitetit të saj, ndërsa politikisht që nga Lufta e Dytë Botërore.



Jacek Uczkiewicz, Dhoma e Lartë e Kontrollit Poloni dhe krijues i ECA

Që nga Këshilli Evropian i Kopenhagen në qershor 1993, marrëdhëniet midis Bashkimit Evropian dhe vendeve të PHARE, përfshirë Poloninë, janë bërë pjesë e kontekstut të përgjithshëm të pranimit në të ardhmen. Kushtet ekonomike dhe politike duhet të plotësohen. Këto të fundit nuk paraqesin ndonjë vështirësi, edhe pse negociatat e gjata do të jenë të nevojshme. Megjithatë ka probleme ekonomike, kryesisht në lidhje me sektorët e bujqësisë, qymyrgurit dhe çelikut, si dhe standardin e përgjithshëm të jetesës. Polonia ka institucione demokratike, ka një rritje të vazhdueshme prej 7-8% në vit, inflacioni ka rënë nga 30% në vitet e fundit në

rreth 9.5% këtë vit dhe papunësia mesatarisht rreth 10%, me diferenca të mëdha lokale. Papunësia është veçanërisht e lartë në veri të vendit, ndërsa lindja ka problemet më të mëdha të infrastrukturës industriale. Polonia ka nevojë për ristrukturim në bujqësi dhe veçanërisht në sektorët e qymyrit dhe çelikut. Dhe kjo vjen në një kohë kur vende si Gjermania e kanë të vështirë ti shpjegojnë publikut se industritë ekzistuese të qymyrit dhe çelikut duhet të çmontohen. Për Poloninë, megjithatë, është çështje e ndërtimit të një ekonomie dhe jo e zgjerimit të një sektori industrial.

Mbështetja për transformimin ekonomik në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ka qënë, që nga fillimi, një objektivi i deklaruar i programeve PHARE të BE-së. Kjo ndihmë mbulon fusha të ndryshme, dhezhvillimi i sektorit privat është një nga më të rëndësishmet. Këshillat Evropiane të Essen (dhjetor 1994) dhe Madrid (dhjetor 1995)

theksuan rolin kryesor të PHARE si një instrument financiar nën strategjinë e para-aderimit. Marrëveshje Evropiane janë nënshkruar midis Bashkimit Evropian dhe shumicës së vendeve në Evropën Qendrore dhe Lindore. Një dialog i strukturuar ka nisur si në nivel të qeverisë ashtu edhe në nivel ministror, dhe në maj 1995, Komisioni paraqiti një Dokument të Bardhë për "përgatitjen e vendeve të asociuara të Evropës Qendrore dhe Lindore për integrimin në tregun e brendshëm të Bashkimit". Sipas Agenda 2000 (15 korrik 1997), programi PHARE do të mbetet instrumenti kryesor për përgatitjen për aderim, por masat mbështetëse u ndanë në dy fusha kryesore: mbështetja institucionale (30% e financimit) dhe financimi i investimeve (70% e shumës).

Deri në çfarë mase është publiku polak i vetëdijshëm për këtë ndihmë financiare dhe këto programe? Sigurisht, publiku di pak rreth tyre dhe nuk është në kontakt direkt me ta. Kjo mund të ndryshojë për sa i përket disa programeve ndërkufitare që përfshijnë autoritetet lokale ose programe që mbulojnë vetëm rajone të caktuara, por, në përgjithësi, qytetarët polakë nuk janë në dijeni të tyre. Nuk duhet të harrojmë se ndihma e BE-së është vetëm 10% e programeve dhe se në shumicën e rasteve paratë derdhen direkt në buxhetin e shtetit.

Sa e arrijnë konsumatorin final këto ndihma? Si organi më i lartë i auditimit të vendit, Zyra e Kontrollit Suprem të Polonisë nuk ka kompetenca për të kontrolluar të gjitha fondet nga programi PHARE. Sigurisht, fondet që rrjedhin në arkën kombëtare janë subjekt i auditimit, por përjashtohen institucionet e tjera dhe fondacionet private. Kjo deri më sot, sepse dy muaj më parë Parlamenti ndryshoi statutin e Zyrës Supreme të Kontrollit në mënyrë që në të ardhmen, të gjitha fondet e BE-së që dërgohen në Poloni do të jenë nën përgjegjësinë e saj, pasi ato do të barazohen me fondet e tjera buxhetore.

Sa efçente janë fondet e BE në Poloni? Mund të supozojmë se rreth 60% e këtyre fondeve arrijnë në të vërtetë tek përfituesit; 10 - 30% shpenzohen për zbatimin e programeve PHARE. Megjithatë, këto janë vetëm vlerësime - rezultate nga mostrat, pasi analizat përkatëse sapa kanë filluar. Parregullsitë arrijnë rreth 10 - 12%, megjithëse duhet theksuar edhe një herë se disiplina financiare është e lartë për shkak se janë të përfshira edhe fondet shtetërore.

Si mund të ndihmojë Gjykata Evropiane e Audituesve që organi polak i auditimit të përmbushë detyrat e tij në mënyrën më të mirë të mundshme? Kryetarët e Institucioneve Supreme të Auditimit të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe BE po ndërmarrin rrugën e bashkëpunimit me qëllim pranimit të vendeve të reja nga lindja. Është e domosdoshme të ndërtohet një sistem solid i auditimit, për të mbrojtur "acquis communautaire", domethënë ato detyrime dhe rregulla që duhet të mbrojnë BE-në dhe ta lejojnë atë të përparojë.

Këtu përfshihen grupet e punës për auditimin e TVSH-së në tregtinë brenda Komunitetit, mbi zbatimin e neneve të Traktatit të KE-së, mbi standardet e përgjithshme të auditimit dhe për transpozimin në ligjin kombëtar. Ka standarde ndërkombëtare të auditimit të

cilat, përshtatur me situatën evropiane, duhet të sjellin transparencë dhe harmonizim. Ata janë aktualisht në zhvillim dhe duhet të jenë baza për bashkëpunimin e ardhshëm të BE. Standardet e reja të auditimit të mbështetura nga Gjykata Evropiane e Audituesve nuk përputhen plotësisht me nevojat e vendeve që kërkojnë pranimin.

Në Poloni, për shembull, problemi më i madh nuk është tek kontrolli i sistemeve aktuale kompjuterike dhe informative, sesa tek zhvillimi i një metodologjie për auditimin e përgatitjes dhe ofrimit të investimeve në këtë fushë dhe rezultateve të tyre.

Cili është parashikimi për Poloninë për pesë vitet e ardhshme? Gjithçka do të varet nga Rusia. Nëse vazhdon të zhvillohet në mënyrë demokratike, Polonia do të ketë një të ardhme të madhe si një Shtet Anëtar Evropian. Është një vend dinamik në zhvillim, por po ndjek me shqetësim problemet ekonomike të fqinjit të saj, Ruisë. Nëse deri para 3 muajsh në kufirin polak kalonin rreth 70 dërgesa në orë, sot shifra është 70 në ditë.

Tigri është i ri dhe do të duhet të qëndrojë ende shumë.



## MENAXHIMI I RI PUBLIK 2011<sup>11</sup>

Një aspekt i rëndësishëm i punës së ECA-s në lidhje me auditimin e veprimtarisë së Komisionit, është Deklarata e tij e Sigurisë për zbatimin e buxhetit të BE-së, DAS ose SoA. Reforma e sistemit të kontabilitetit të Komisionit u iniciua në vitin 2005, dhe që nga ajo periudhë Komisioni ka rishikuar tërësisht mënyrën se si mban llogaritë e tij. Në terma konkretë, ndryshimi ka ndodhur nga kontabiliteti i parasë cash në kontabilitetin akrual. Sipas sistemit të ri, të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen kur ato janë realizuar ose kanë ndodhur dhe jo, si më parë, kur bëhet pagesa. Kjo jep një pamje shumë më të saktë të situatës financiare të BE-së.

Një tjetër reformë e rëndësishme e Komisionit ishte krijimi i një kuadri të integruar të kontrollit të brendshëm. Komisioni i vuri vetes qëllimin ambicioz të marrjes së një Deklarate pozitive të Sigurisë nga ECA. Megjithatë, ky synim ende nuk është arritur. Reforma mbi kornizën së kontrollit ka të bëjë me katër fusha kryesore: thjeshtimi dhe parimet e kontrollit të përbashkët, deklaratat e menaxhimit dhe siguria e auditimit, qasja "auditim i vetëm"<sup>12</sup>, si dhe nevoja për përmirësime në sektorë të caktuar të financimit të BE.

Deklaratat e menaxhimit dhe sigurimi i auditimit kanë vënë në dukje nevojën për përdorimin më të madh të çertifikatave të auditimit të lëshuara nga auditues të jashtëm ose zyrtarë publikë. Ideja u shtri në "deklaratat kombëtare"<sup>13</sup>, të cilat u morën në konsideratë më me kujdes nga ECA në një opinion të vitit 2007. Ndryshe nga "përmbledhjet vjetore", deklaratat kombëtare rrjedhin nga një iniciativë vullnetare nga disa shtete anëtare. Megjithatë, në një nga opinionet e saj, ECA deklaroi se i konsideron këto deklaratat vetëm një nga elementët mbi të cilin bazohet puna e saj.

Qëllimi kryesor i konceptit "auditimi vetëm", ishte nevoja për të zvogëluar rrezikun e mbivendosjes së auditimeve. Audituesit duhet të jenë në gjendje të mbështeten në auditimet e mëparshme në të gjitha nivelet. Nëse aplikohet në mënyrë sistematike, kjo qasje gjithashtu bën të mundur reduktimin e numrit të kontrolleve për rrezikune gabimit, duke kufizuar kështu shpenzimet e përgjithshme për auditimet. Në fund të fundit, "pronari" i auditimeve duhet të jetë Bashkimi Evropian, jo organet përkatëse të auditimit.

Një nevojë tjetër për përmirësim u ngrit nga fakti se disa programe të BE-së ishin subjekt i rreziqeve. Fondet Strukturore në veçanti u karakterizuan me norma shumë të larta gabimi. Ky sektor u menaxhua bashkërisht nga Komisioni dhe Shtetet Anëtare dhe nuk ishte i qartë si pasojë e niveleve të shumtatë tilla si një sërë agjencish pagueuse apo organeve zbatuese. Për këtë arsye, Vendeve Anëtare i'u kërkua të demonstrojnë

---

<sup>11</sup>"Menaxhimi i Ri Publik siç shihet nga ECA" nga Dr Harald Noack, Anëtar i ECA, Gazeta Shtator 2011.

<sup>12</sup>Opinion i ECA 2/2004.

<sup>13</sup>Opinion i ECA 6/2007.

përdorimin e këtyre fondeve si për audituesit kombëtar, ashtu dhe ata të BE-së. Ishte koha e ndryshimeve të mëdha dhe debateve, veçanërisht në lidhje me vlerësimet e përdorimit të buxhetit të BE-së, të cilat ishin më pak të fokusuara në të dhëna dhe më shumë në rezultate. Pas një rishikimi të kolegëve disa vjet më parë, ECA kishte bërë vetë ndryshime thelbësore organizative.

## LLOGARIDHËNIA

Institucioneve dhe organeve kombëtare dhe të BE-së u kërkohet të justifikojnë veprimet e tyre dhe në rastin e institucioneve dhe agjencive të BE-së, u jepet aprovimi për menaxhimin e buxheteve të tyre vjetore.

Kontrolli demokratik dhe auditimi efikas publik shkojnë dorë për dorë. Ato ndihmojnë autoritetet qeverisëse të përmirësojnë përdorimin e fondeve publike dhe sigurojnë legjitimitet duke u shpjeguar qytetarëve se çfarë progresi po bëhet drejt objektivave të rëndësishme të BE. Ato sigurojnë legjitimitet në përdorimin e fondeve të BE-së dhe krijojnë besim në strukturën politike dhe institucionale dhe instrumentet e saj. Ekziston gjithashtu edhe një element të mësuar dhe përmirësimi nga rezultatet e auditimeve dhe rekomandimeve të tyre.

Koncepti i llogaridhënies nuk është statik. Aktualisht vërehet një lëvizje drejt përgjegjësisë për rezultat dhe impakt në nivelin të BE. Art. 318 TFEU kërkon që Komisioni të raportojë mbi evoluimin e financave të BE-së bazuar në rezultatet e arritura. Megjithatë, aspektet e performancës shkojnë përtej llogaridhënies dhe gjithashtu ndikojnë në procesin buxhetor. Komisioni, në fakt, synon të zhvillojë një qasje të bazuar në performancë buxhetore, e cila është ende në një fazë shumë embrionale.

Misioni i ECA është të kontribuojë në përmirësimin e përgjegjshmërisë demokratike duke vendosur rregullimet e duhura. Kjo varet gjithnjë e më shumë në një shkallë të lartë të koordinimit midis shtresave të shumta të qeverisjes dhe shqyrtimit.

Strukturat komplekse të qeverisjes së BE-së, janë burimi i debatit të rëndësishëm në aspektin e konfigurimit të institucioneve demokratike, të nevojshme për të siguruar mbikëqyrjen dhe legjitimitetin e nevojshëm.

Kjo përkeqësohet edhe në peizazhin e auditimit. Sfida e ECA del nga marrëveshjet jokonsistente për shqyrtimin parlamentar dhe për auditimin publik. E gjithë kjo kërkon një transformim të vëzhgimit demokratik dhe të peizazhit të auditimit dhe ECA kërkon ndihmën e institucioneve të tjera evropiane dhe të institucioneve kombëtare të auditimit për ta arritur këtë.

Më 14 tetor 2014, ECA mbajti një "Konferencë të Përgjegjësisë të BE 2014" me folës kryesorë nga Parlamenti Europian, Komisioni Europian dhe ECA. Kjo ishte konferenca e parë e këtij lloji, në të cilën ECA ftoi një diskutim të hapur rreth marrëveshjeve të auditimit dhe llogaridhënies në BE dhe si të kapërcehen boshllëqet dhe mbivendosjet

duke u frymëzuar nga rishikimi i saj i peizazhit mbillogaridhënien e BE dhe angazhimet e auditimit publik<sup>14</sup>.

Në kontekstin e shtresave të shumëfishta të qeverisjes, shtresa të shumëfishta të shqyrtimit demokratik dhe shtresa të shumta të auditimit, kompleksiteti në mënyrë të pashmangshme çon në boshllëqe dhe mbivendosje në llogaridhënien dhe angazhimet e auditimit. Rishikimi identifikoi gjashtë fusha ku paraqiten sfida: aktivitetet e koordinuara, natyra multispeed e BE-së, partneritetet, aranzhimet për institucionet dhe organet e BE-së, menaxhimi i buxhetit të BE-së dhe llogaridhënia për rezultatet e instrumenteve jofinanciare.

---

<sup>14</sup> Rishikimi i peizazhit - "Mangësitë, mbivendosjet dhe sfidat: një rishikim i peizazhit të përgjegjshmërisë së BE-së dhe marrëveshjeve të auditimit publik", ECA 2014

---

### 3. TË AUDITOSH EVROPËN

---



#### VLERA E SHTUAR E PUNËS SË ECA-s

Roli i ECA-së është që të sigurojë raporte të pavarura të auditimit me cilësi të lartë dhe në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e saj sipas Traktatit, si dhe mendime dhe produkte të tjera të bazuara në përvojën e auditimit.

ECA nuk mund të përmirësojë drejtpërdrejt menaxhimin financiar. Roli i saj është të sigurojë material autoritar, përmes raporteve të auditimit dhe produkteve të tjera, të cilët i ofrojnë Komisionit, Parlamentit dhe Këshillit mundësinë për të përmirësuar menaxhimin financiar.

Roli i ECA nuk është të sigurojë një set alternativash të preferencave politike ndaj të zgjedhurve nga institucionet politike të Unionit. Këshillat e pavaruratë ECA për të ndihmuar politikëbërësit dhe vendimmarrësit nëformimin dhe shqyrtimine propozimeve të reja ligjislative dhe buxhetore kontribuojnë në llogaridhënien dhe transparencën.

Ndërsa Evropa ballafaqohet me sfida gjithnjë e më të mëdha dhe presionin në rritje mbi financat e saj publike, roli i ECA është gjithnjë e më i rëndësishëm. ECA, megjithatë, duhet të vërë në pikëpyetje realizueshmërinë, koherencën dhe vlerën e shtuar të politikave dhe masave të BE-së, bazuar në punën e saj audituese. ECA paralajmëron për rreziqet, jep siguri dhe ofron udhëzime për politikëbërësit e BE-së se si të përmirësojnë menaxhimin e financave publike, si dhe siguron që qytetarët e Evropës të jenë të informuar se si shpenzohen paratë e tyre. Ky është thelbi i kontributit të ECA-s në drejtim të forcimit të legjitimitetit demokratik dhe qëndrueshmërisë së Bashkimit Evropian.

### Të rikuperosh besimin mbi financat publike<sup>15</sup>

Qeveritë dhe institucionet e BE kanë humbur besimin e qytetarëve në prag të krizës financiare dhe ekonomike. Një numër çështjesh të llogaridhënies dhe transparencës po reflektohen nga institucionet kompetente brenda Bashkimit Evropian, në veçanti Parlamentit Evropian dhe Këshilli. Institucionet Supreme të Auditimit të Shteteve Anëtare dhe ECA mund të ndihmojnë politikëbërësit me informacione dhe këshilla të rëndësishme bazuar në përvojën e tyre të auditimit, për të siguruar se aty ku janë në rrezik fondet publike, ekzistojnë angazhimet e duhura për të ofruar transparencën, llogaridhënien publike dhe auditimin publik.

Përgjigjeve të menjëhershme të BE-së, në disa raste të dhëna në nivel ndërqeveritar dhe jashtë Traktatit dhe Buxhetit të BE-së, shpesh nuk kanë patur auditimin e duhur publik të jashtëm dhe për këtë arsye kërkohen përpjekje të reja drejt korigjimit të këtij shtrembërimi nga ECA. Traktati ESM (Mekanizmi European i Stabilitetit), për shembull, ofron një mandat të plotë auditim publik me një Bord Auditimi prej pesë personash, i cili përfshin një përfaqësues nga ECA. ESM është një nga ato institucione që nuk janë plotësisht institucione të BE-së, shpesh të përcaktuara rast pas rasti nëpërmjet marrëveshjeve midis vendeve të Eurozonës dhe për këtë arsye, ato nuk mbulojnë nga mandati i auditimit që Traktati i jep ECA-s. Për më tepër, disa prej këtyre mekanizmave të reja financiare janë themeluar si kompani nën ligjin privat, gjë që e bën auditimin e tyre nga një institucion i sektorit publik më të komplikuar. Kjo krijon një problem të deficitit të llogaridhënies publike që nuk mund të zgjidhet lehtësisht.

Politikat e përfshira në Strategjinë për BE (EVROPA 2020) do të kenë një sërë ndikimesh. Ekziston nevoja për të kuptuar ndryshimet në fusha të ndryshme të auditimit dhe kompleksiteti i përfshirjes së këtyre politikave kërkon auditime ndërsektoriale. Zhvendosja e theksit të palëve, nga ligjshmëria drejt ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të politikave, si dhe kalimi nga ndërhyrjet buxhetore në rregullimin,

<sup>15</sup>Nxitja e besimit përmes auditimit të pavarur - Strategjia e Gjykatës Evropiane të Audituesve 2018-2020, ECA 2017.

koordinimin e politikave dhe ndërhyrjet e levave, rrit nevojën dhe rëndësinë për auditimet e performancës.

Një boshllëk i madh që ECA identifikoi, ishte mungesa e infomacionit të mjaftueshëm për rezultatet e arritura nga politikat dhe programet e shpenzimeve të BE. Qëllimi i ECA është të bëjë më shumë me më pak dhe këtë ta bëjë nëpërmjet përdorimit më efikas të burimeve të saj. Gjithashtu ajo dëshiron të jetë më e vetëdijshme për nevojat e partnerëve dhe palëve të interesuara. Gjatë periudhës 2013-2017, ECA ka siguruar që misionet e saj të auditimit dhe raportet speciale të pasqyrojnë rreziqet e menaxhimit financiar, interesin publik dhe kapacitetin e ECA për të shtuar vlerën përmes auditimit. ECA gjithashtu është fokusuar në çështjet e performancës, duke përfshirë ato që lidhen me tema specifike të interesit aktual publik, objektiva të nivelit të lartë të BE-së dhe politikat ndërsektoriale.

Shumë iniciativa të ndërmarra nga ECA aktualisht po konvergojnë. ECA-s i është dhënë përgjegjësi shtesë auditimi, duke përfshirë për shembull, rolin e Bankës Qendrore Evropiane në fushën e mbikëqyrjes së kujdesshme të Bankave dhe Fondit Evropian për Investime Strategjike (EFISI).

Gjatë viteve të fundit, ECA ka arritur të ndihmojë Komitetin e Kontaktit për të rritur prezencën e tij. Kriza financiare ka qenë në qendër të disa iniciativave të ndërmarra nga Komiteti i Kontaktit. Së bashku me SAI të tjera të BE-së, ECA është përpjekur të identifikojë implikimet për transparencën, llogaridhënien dhe auditimin e masave të ndryshme të marra në përgjigje të krizës.

Sidoqoftë, sfida për përmirësimin e përgjegjshmërisë së BE nuk kufizohet vetëm në fushën e çështjeve ekonomike dhe financiare. Ekzistojnë gjithashtu çështje të llogaridhënies publike dhe të auditimit në fushat e tjera të politikave të BE-së, të cilat duhet të adresohen. Cili është roli që SAI-të mund të luajnë brenda auditimit të fondeve të BE-së? Kjo është një fushë ku duhet të identifikohen mënyra të reja për të punuar së bashku dhe pastaj rezultatet duhet të vihen në dispozicion të parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Evropian.

Nëpërmjet Paketave me Gjashtë pika, me Dy pika, etj, Komisionit i janë akorduar një sërë kompetencash të reja. Megjithatë, këto nuk janë kompetenca shpenzimi, por kompetenca monitoruese në lidhje me Shtetet Anëtare. ECA po monitoron se si mund ta auditojë këtë fushë të re të kompetencave. Roli i saj mund të jetë, së pari, të zhvillojë metoda të reja, gjithmonë me idenë se nuk është thjesht një auditues i jashtëm, por edhe institucioni që kërkon që administratorët të jenë përgjegjës për mënyrën se si ushtrojnë pushtetin e tyre administrativ.

Nën konceptin "Auditimi i vetëm", rruga është e hapur për një rol më aktiv për institucionet e auditimit. Për ta kthyer këtë ide në praktikë, po ndërmerren hapa për të rritur ndarjen dhe koordinimin e masave të auditimit mes të gjitha palëve. Gjithashtu

është thelbësore që të bëhet një shqyrtim i hollësishëm i kostove të auditimit në të gjitha nivelet.

Sistemet e feedback janë thelbi i demokracisë dhe zhvillimi i shëndoshë i administratës publike. ECA është një sistem i tillë dhe mbështet proceset demokratike, kështu që lidhja me parlamentet dhe Këshillin është jashtëzakonisht e rëndësishme.

### Më shumë sfida

Në vitet e fundit BE ka trajtuar sfidat globale duke përfshirë ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, ndërkohë që është hasur me efektet e vazhdueshme të krizës ekonomike dhe financiare që ka kërcënuar disa nga arritjet e saj më të rëndësishme, si euro.

Në kuadër të mandatit të saj, ECA do të kryejë auditime në lidhje me autoritetet e reja mbikëqyrëse, mekanizmat e asistencës me garanci të buxhetit të BE, si dhe –aq sa është e mundur – aktivitetet e Komisionit në Semestrin Evropian.

Sa i përket menaxhimit të shëndoshë financiar, llogaridhënia efektive për rezultatet e arritura me buxhetin e BE-së ende duket shumë larg. Një prioritet kyç për ECA do të jetë të përdorë punën e saj për të ndihmuar Komisionin, Parlamentin dhe Këshillin, në mënyrë që të prezantojë një mjet efektiv për të shqyrtuar shpenzimet e BE gjatë rrjedhës së kuadrit të ardhshëm financiar. Prandaj, ECA do të vazhdojë të kryejë auditimet e përputhshmërisë dhe të performancës me këtë objektiv. Në veçanti, ajo do të vazhdojë të përdorë rezultatet e saj për të sjellë rekomandime që ndihmojnë në përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të politikave.

Presioni mbi financat publike dhe administratat publike në nivel BE dhe në nivel kombëtar është rritur, ndërsa besimi tek këto organe ka rënë. Është e rëndësishme të shqyrtohen zhvillimet në lidhje me buxhetin e BE-së në këtë kontekst. Në veçanti, është e rëndësishme të kuptohet se buxheti i BE-së përfaqëson vetëm rreth 1/5 e shpenzimeve publike të BE-së. Marrëveshjet e reja të BE-së për koordinimin fiskal dhe ekonomik, mbulojnë të gjitha shpenzimet publike në BE dhe ato përfshijnë objektivat e Evropës 2020 për të gjithë BE-në, të cilat duhet të përmbushen kryesisht nga veprimet kolektive të qeverive të Shteteve Anëtare.

### Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit të BE-së

Është thelbësore që ligji i BE-së të vihet në praktikë, nëse BE do që të japë rezultate për qytetarët e saj dhe do të mbajë besimin e tyre. Në vazhden e përditësimeve të legjislationit për shumë politika të BE-së pas vitit 2020, është gjithashtu thelbësore që të merren mësimet rreth zbatimit të tyre.



Shtetet Anëtare kanë detyrimin të zbatojnë ligjin e BE-së në juridiksionin e tyre dhe Komisioni Evropian është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përputhje me Nenin 17 (1) të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU). Ai gjithashtu duhet të ndër marrë veprimet e duhura për të promovuar dhe siguruar pajtueshmërinë me të.

Parlamenti Evropian kërkoi një raport të Gjykatës mbi këtë temë, gjatë certifikimit mbi buxhetin e përgjithshëm 2014. Duke pasur parasysh natyrën e temës, në programin e punës të Gjykatës për vitin 2017, kjo detyrë u konsideruar si një rishikim peizazhi.

Ky rishikim do të trajtojë mbikëqyrjen që KE ka ushtruar mbi zbatimin e ligjit të BE nga shtetet anëtare dhe mënyrën se si aktivitetet e saj të mbikëqyrjes kontribuojnë në promovimin dhe pajtueshmërinë me këtë ligj.

Një numër raportesh të veçanta (rreth 30% në tre vitet e fundit) kanë theksuar çështjet që lidhen me zbatimin e ligjit të BE nga shtetet anëtare në fushat e politikave të veçanta. Megjithatë, Gjykata ende nuk e ka shqyrtuar në mënyrë specifike funksionin e mbikëqyrjes së Komisionit.

## Mashtrimi

Ku ka para, ka mashtrim. Një nga detyrat e Gjykatës Evropiane të Audituesve është parandalimi i ndikimit të mashtrimit në fondet e BE-së.

Puna e audituese kryhet në vetë Komisionin, por edhe në Shtetet Anëtare: kudo ku shpenzohen fondet e BE-së. Megjithatë, Gjykata e Audituesve publikon vetëm rezultatet e auditimeve të saj në raportet e saj.

Në vitin 1996, kur Komisioni pati kritika të ashpra dhe Parlamenti e refuzoi certifikimin e tij, raportet e Gjykatës Evropiane të Audituesve tërhoqën vëmendjen mbi të metat e UCLAF, pasi njësia e anti-mashtrimeve brenda Komisionit atëherë ishte e njohur.

Megjithatë, UCLAF ishte vetëm një departament i Komisionit i cili ishte audituar nga Gjykata. Dobësia e UCLAF qendronte në faktin se ajo kishte kompetenca për të hetuar vetëm brenda Komisionit dhe jo brenda institucioneve të tjera të Komunitetit.

Në vitin 1999 u krijua një organ i ri, OLAF. OLAF është një njësi kundër mashtrimit me fuqinë për të hetuar në të gjitha institucionet. Dallimi kryesor është se ky organ, një zyrë Evropiane për hetime të jashtme dhe të brendshme, ka një shkallë më të lartë pavarësie dhe nuk është i detyruar nga asnjë udhëzim nga Komisioni. Sidoqoftë, mandati i tij nuk ka të bëjë me mashtrimet dhe aktivitetet e tjera të paligjshme në përgjithësi, por vetëm mashtrimet ndaj buxhetit të BE-së në veçanti. Zyra është gjithashtu përgjegjëse për hetimet e brendshme brenda institucioneve dhe organeve të BE-së.

Gjykata ka kryer disa auditime dhe ka lëshuar disa opinione për funksionin hetimor të OLAF, por gjithashtu informon OLAF-in, sipas procedurave të saj të brendshme për bashkëpunim, mbi rastet e zbuluara ose të dyshuara të mashtrimit apo paligjshmërisë.

Gjithashtu është thelbësore të identifikohen rreziqet kryesore të korrupsionit dhe mashtrimit në secilën fazë të procesit: kur miratohen ligjet, kur zbatohen politikat dhe kur shpenzohen fondet publike. Nëse nuk përqendroheni në marrjen e masave për të minimizuar ose çrrënjësuar rrezikun e korrupsionit dhe mashtrimit, atëherë jeni gjithmonë duke bërë hapa prapa. SAI-t mund të ndajnë përvojën e tyre dhe të zhvillojnë mjete për hartimin e rreziqeve kryesore, të cilat do të bënin të mundur trajtimin e këtyre rreziqeve.

## DËSHMI

### Bashkëpunimi në auditime mes Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të Vendeve Anëtare



*Jacek Mazur, Ph.D.*

*Këshilltar i Presidentit të Polonisë  
Zyra Supreme e Auditimit  
Auditues i jashtëm i Institutit të  
Universitetit Evropian (2016-  
2020)*

Kompetenca audituese e Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) mbivendoset pjesërisht me atë të Institucionit Suprem të Auditimit (SAI<sup>16</sup>) të një Shteti Anëtar të BE-së, kur bëhet fjalë për auditimin e menaxhimit dhe shfrytëzimit të fondeve të BE-së.

Të dy institucionet ndajnë pjesërisht palët e interesit: qytetarët e Bashkimit Evropian. Pavarësisht pozicioneve të ndryshme në organizimin e një shteti të caktuar ose vetë Bashkimin Evropian, si dhe dallimet e shumta në fuqi, organizim, procedura dhe metodologjinë e auditimit, ECA dhe SAI pjesërisht kryejnë të njëjtën veprimtari, domethënë ekzaminimin sistematik dhe të pavarur të menaxhimit dhe shfrytëzimit të fondeve të BE-së. Kjo ngjashmëri përbën një parakusht natyror për bashkëpunimin e tyre.

Ky artikull diskuton fushat kryesore në të cilat ECA dhe SAI bashkëpunojnë: 1) pjesëmarrjen e SAI-ve në auditimet e ECA-s në Shtetet Anëtare; 2) aktivitetet për të zbutur rrezikun e auditimeve të dyfishta; 3) auditime të përbashkëta.

## I. Hyrje

### Kompetencat që mbivendosen

Secili organ auditues ka sferën e vet të kompetencës. Megjithatë, mandati i ECA-s dhe mandati i dhënë SAI-ve nga autoritetet (administrata) e një Shteti Anëtar për të audituar menaxhimin dhe shfrytëzimin e fondeve të BE-së pjesërisht mbivendosen.

SAI-t auditojnë zbatimin e buxhetit kombëtar dhe aktivitetet e administratës në vendin e tyre, duke përfshirë menaxhimin dhe shfrytëzimin e fondeve të BE-së në kontekstin e buxhetit kombëtar.

<sup>16</sup> Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve anëtare të BE do ti gjeni me shkurtimin SAI.

Ndërkohë ECA auditon kryesisht Komisionin. Sipas nenit 317 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, "Komisioni e zbaton buxhetin [...] në përgjegjësinë e tij [...]".

Megjithëse rreth 80% e shpenzimeve janë shkaktuar nga organet qendrore dhe vendore të Shteteve Anëtare, ato ekzekutohen në bazë të menaxhimit të përbashkët, prandaj Komisioni mban përgjegjësi për zbatimin e të gjithë buxhetit. Auditimi i Komisionit rregullohet gjithashtu me nenin 287 (1), i cili përcakton kompetencat e ECA-s.

Në përputhje me këto dispozita, ECA auditon të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të BE-së dhe veprimtarinë e institucioneve dhe organeve të tjera të tij. Në të njëjtën kohë (sipas Nenit 287 (3)), auditimi do të "kryhet në vend nëse është e nevojshme, [...] në Shtetet Anëtare, duke përfshirë mjediset e çdo personi fizik ose juridik që merr financim nga buxheti". Kjo do të thotë se kur ECA auditon zbatimin e buxhetit të BE-së, ndonjëherë kontrollon jo vetëm Komisionin por, ndër të tjera, edhe administratat e shteteve anëtare, si dhe personajuridikë dhe fizikëqëmenaxhojnë ose përdorin fondet e BE-së në ato shtete. Në këtë kontekst, shpeshherë është sugjeruar që ECA gjithashtu të auditojë veprimtarinë e vetë Shteteve Anëtare (për shembull kur kontrollon veprimtarinë e Ministrisë të Financave, i cili kryen detyra lidhur me menaxhimin e fondeve të BE-së, në një shtet të caktuar).

### Shumëllojshmëria e SAI-ve

Bashkëpunimi midis ECA-s dhe SAI-ve është i ndikuar nga modus operandi dhe kompetencat e ndryshme të SAI-ve. Statusi ligjor i këtyre organeve ndryshon, ndër të tjera, sipas organizimit të tyre (gjykatat e auditimit dhe zyrat e auditimit), procedurave operative dhe mandatit (për shembull, vendosja e dënimeve dhe / ose prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve tek subjekti i audituar dhe parlamenti)<sup>17</sup>

### Rolet e ndryshme

Palët kryesore të interesit të ECA-s janë institucionet dhe qytetarët e BE-së, ndërsa të SAI-ve janë ata kombëtarë. Kur raporton mbi auditimet në subjektet kombëtare që menaxhojnë ose shfrytëzojnë fondet e BE-së, ECA raporton tek institucionet e tij, d.m.th. tek Këshilli Evropës dhe Parlamenti Evropian dhe jo tek organet Shteteve Anëtare, ndërsa një SAI që ka audituar subjektet kombëtare që menaxhojnë ose shfrytëzojnë fonde të BE-së, raporton tek parlamenti kombëtar (dhe organet e tjera kombëtare), dhe jo tek

<sup>17</sup>Auditimi Shtetëror në Bashkimin Evropian, Zyra Kombëtare e Auditimit, botimi i dytë, Londër 2002.

institucionete tij<sup>18</sup>. Kjo ndikon në qasjen e auditimit: gjatë shqyrtimit të çështjeve të lidhura me BE-në, një SAI kryesisht merr në konsideratë çështje me rëndësi për buxhetin kombëtar dhe në përgjithësi interesin kombëtar, duke marrë parasysh, mbi të gjitha, nevojat e parlamentit të Shtetit Anëtar.

Kjo do të thotë që gjatë auditimit të çështjeve të lidhura me BE-në, një SAI konsideron pyetje të tilla si:

- A vepron qeveria për të parandaluar dyfishimin e panevojshëm të subvencioneve kombëtare dhe të BE-së me objektiva të ngjashëm (grante, etj.)?
- A kërkon qeveria të sigurojë që rregullat për menaxhimin e fondeve të BE-së janë në përputhje me rregulloret kombëtare, ndërsa vepron brenda Këshillit?
- A merret vetë qeveria me shpërndarjen e duhur të buxhetit të BE-së?
- Ndërsa vepron brenda Këshillit, a kërkon mjaftueshëm qeveria të përmirësojë mekanizmat e menaxhimit financiar të BE-së?
- A i përmbush qeveria siç duhet detyrimet ndaj BE-së dhe a i zbaton direktivat në mënyrë të plotë dhe në kohë, në mënyrë që shteti të mos i nënshtrohet ndëshkimeve apo kompensimit për shkak të dështimit për ta bërë këtë?
- A është qeveria e shqetësuar me racionalizimin e shpenzimeve të bëra nga administrata kombëtare (qendrore dhe vendore) në lidhje me menaxhimin e fondeve të BE-së?<sup>19</sup>

### Parimi i bashkëpunimit të përgjithshëm

Neni 4 (3) i Traktatit për Bashkimin Evropian përcakton parimin e bashkëpunimit të sigurtë: "[...] Unioni dhe Shtetet Anëtare, në respekt të plotë të ndërsjellë, duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet. Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme, të përgjithshme ose të veçanta, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Traktatet ose që rezultojnë nga aktet e institucioneve të Unionit. Shtetet Anëtare duhet të lehtësojnë arritjen e detyrave të BE-së dhe të shmangin çdo masë që mund të rrezikojë arritjen e objektivave të tij". Ky është një parim themelor që duhet të merret parasysh nga të gjitha organet e BE-së dhe ato kombëtare.

Për më tepër, neni 317 i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian përcakton detyrën e bashkëpunimit "për të siguruar që ndarjet janë përdorur në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar", ndërsa sipas Nenit 325 (1) të Traktatit,

---

<sup>18</sup>Megjithatë, ECA i paraqet rregullisht rezultatet e saj të auditimit në parlamentet dhe organet e tjera kombëtare dhe SAI-t ndonjëherë i paraqesin rezultatet e tyre të auditimit në institucionet e BE-së.

<sup>19</sup>H. von Wedel: "The Audit of European Community Funds", Revista EUROSAI Nr 4, 1997.

Shtetet Anëtare janë të detyruara të "luftojnë mashtrimin dhe çdo veprimtari tjetër ilegale që prek interesat financiare të Unionit".

### Parimet e hollësishme të bashkëpunimit ndërmjet ECA dhe SAI

Dispozita kryesore e legjislacionit të BE-së që rregullon bashkëpunimin ndërmjet ECA dhe SAI është neni 287 (3) i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian: "Në Shtetet Anëtare, auditimi kryhet në bashkëpunim me organet kombëtare të auditimit ose, nëse ato nuk kanë kompetencat e nevojshme, me departamentet kombëtare kompetente. Gjykata e Audituesvedhe organet kombëtare të auditimit të Shteteve Anëtare do të bashkëpunojnë nën një frymë besimi duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e tyre. Këto organe ose departamente informojnë Gjykatën e Audituesvenëse kanë ndër mend të marrin pjesë në auditim". Dhe më tej: "organet kombëtare të auditimit [...] do t'i përcjellin Gjykatës së Audituesve, sipas kërkesës së tyre, çdo dokument ose informacion të nevojshëm për të kryer detyrën e saj".

Tre çështje kërkojnë koment: a) termi "organ kombëtar auditimi"; b) rasti në të cilin "organi kombëtar i auditimit nuk ka kompetencat e nevojshme"; c) nocionii një auditimi të kryer nga Gjykata "në bashkëpunim me organet kombëtare të auditimit".

Një "organ kombëtar auditimi", referuar në nenin 287 (3), është organi publik i një shteti i cili, pavarësisht përcaktimit, konstituimit apo organizimit, ushtron në bazë të ligjit funksionin më të lartë të auditimit publik të atij shteti. "Organi kombëtar i auditimit" përcaktohet nga legjislacioni kombëtar dhe në praktikë nuk ka dyshim se cili organ funksionon si Institucion Suprem Auditimi në çdo Shtet Anëtar të BE.

SAI është partneri i ECA-s ndërsa kryen auditime në shtetin përkatës, përveç rastit kur institucioni nuk është i autorizuar në mënyrë të mjaftueshme. Në raste të tilla ECA është partnere me "departamentet kompetente kombëtare", p.sh. institucionet rajonale të auditimit në një shtet federal<sup>20</sup>, ministrinë ose organet e tjera administrative.

Shprehja se auditimi në Shtetet Anëtare duhet të bëhet "në bashkëpunim me organet kombëtare të auditimit" duhet të interpretohet në kontekstin e nenit 287 (3) në tërësi. Në terma ligjore do të thotë kryesisht ajo që vijon nga rregullorja: ECA është e detyruar të informojë SAI-n se ka ndërmend të kryejë një auditim në Shtetin Anëtar, ndërsa SAI duhet të deklarojë nëse do të marrë pjesë në auditim. Në vitin 1975 autorët e nenit 206a të Traktatit (më vonë neni 188c dhe neni 248, aktualisht neni 287) e përdornin formulimin "në bashkëpunim me", duke qenë se donin të shmangnin përdorimin e një termi ligjor më specifik. Ky është një përkufizim më pak juridik që ndoshta është përdorur për të

<sup>20</sup>Për shembull, në Gjermani shumica e fondeve të fituara nga buxheti i BE menaxhohen nga shtetet federale (Länder), të cilat nuk i nënshtrohen auditimit nga Bundesrechnungshof, por nga organet audituese të këtyre shteteve

shmangur varësinë e njërës palë nga tjetra dhe, në të kundërt, për të hartuar bashkëpunimin në një mënyrë të tillë që tëvarej nga vullneti i tyre i përbashkët dhe i lirë<sup>21</sup>.

Bashkëpunimi midis ECA dhe SAI gjithashtu përmendet në Deklaratën nr. 18 bashkëngjitur Traktatit të Nicës të datës 26 shkurt 2001: "Konferenca fton Gjykatën e Audituesve dhe institucionet kombëtare të auditimit të përmirësojnë kuadrin dhe kushtet për bashkëpunim midis tyre, duke ruajtur autonominë e secilit. Për këtë qëllim, Presidenti i Gjykatës së Audituesve mund të krijojë një komitet kontakti me kryetarët e institucioneve kombëtare të auditimit". "Deklarata" krijoi një bazë për Komitetin e Kontaktit të Institucioneve Kombëtare të Auditimit dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve (Komiteti i Kontaktit), në funksionim që nga viti 1960, me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit tyre<sup>22</sup>.

Vlejnë të përmenden deklaratat e fundit, të cilat theksojnë nevojën për të zhvilluar bashkëpunimin në auditim midis ECA-s dhe SAI-ve:

- Ndërmjet objektivave të saj, ECA liston "zgjerimin e aktiviteteve të saj të bashkëpunimit në lidhje me auditimin e fondeve publike të BE-së dhe të shteteve anëtare për të përmbushur objektivat e Unionit" dhe "shkëmbimine njohurive dhe ekspertizës lidhur me auditimin e fondeve të BE"<sup>23</sup>;
- Parlamenti Evropian bëri thirrje për "bashkëpunim më të ngushtë mes institucioneve kombëtare të auditimit dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve në lidhje me auditimin e marrëveshjeve të menaxhimit të përbashkët, në përputhje me nenin 287 (3) të TFEU"<sup>24</sup>.

## II. Pjesëmarrja e SAI-ve në auditimet e ECA-s në Shtetet Anëtare

Le të shqyrtojmë së pari numrin e auditimeve të ECA-s të kryera në disa nga Shtetet Anëtare gjatë 2015-2016. Tabela e mëposhtme përfshin informacionin për pjesëmarrjen e

---

<sup>21</sup>Rapport d'information déposé par la Délégation de l'Assemblée Nationale pour l'Union Européenne (1), sur les relations entre la Cour des comptes européenne et les institutions financières nationales, et présenté par M. Pierre Brana, Député; Assemblée Nationale, Nr 3505, 20 Dhjetor 2001, fq. 17-18; J. Inghelram: The European Court of Auditors: Current Legal Issues, Common Market Law Review Nr 37, 2000, fq. 138-139.

<sup>22</sup>Komiteti i Kontaktit shqyrtoi disa herë mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet SAI-ve dhe ECA-s dhe ndër të tjera miratoi rezolutat për përmirësimin e koordinimit midis tyre (CC-R-1998-06), përmirësimin e procedurës së konsultimit në ECA (CC-R-1998-05), dhe Parimet Udhëzuese (CC-R-2003-02); shih <http://www.eca.europa.eu/sites/cc/en/Pages/ccdefault.aspx>.

<sup>23</sup>Strategjia e ECA 2013-2017;

[http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/STRATEGY2013-2017/STRATEGY2013-2017\\_EN.PDF](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/STRATEGY2013-2017/STRATEGY2013-2017_EN.PDF).

<sup>24</sup>Rezoluta e Parlamentit Evropian e datës 4 shkurt 2014 për rolin Gjykatës së Audituesve në të ardhmen. Procedura për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Audituesve: Konsultimi i Parlamentit Evropian (2012/2064 (INI)); OJ C 93, 24.03.2017, f. 6-13; para. 17-21.

audituesve të SAI-ve. Edhe këto të dhëna të pjesshme tregojnë se praktikat ndryshojnë shumë.

	2015		2016	
	Auditimet ECA	Shoqëruar nga audituesit e SAI	Auditimet ECA	Shoqëruar nga audituesit e SAI
Austri <sup>25</sup>	12	1	10	2
Bullgari	6	2	7	6
Qipro	1	1	1	1
Rep. Çeke	7	7	14	13
Danimarkë	1	1	4	4
Francë <sup>26</sup>	38	0	37	0
Gjermani	31	14 <sup>27</sup>	41	11 <sup>28</sup>
Greqi	8	1	11	6
Letoni	1	0	2	2
Lituani	5	3	7	4
Malta	2	2	4	4
Poloni	25	10	17	13
Slovaki	13	2	5	2
Spanjë	30	9	45	8

*Burimi: Institucionet Supreme të Auditimit<sup>29</sup>*

### Modele bashkëpunimi

Pjesëmarrja e SAI-ve në auditimet ECA-s është fakultative. Sipas Nenit 287 (3) të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian, SAI-t i kërkohet të bashkëpunojë me

<sup>25</sup>Për më tepër, SAI austriak monitoron të gjitha auditimet e ECA që po zhvillohen në Austri.

<sup>26</sup>Auditimet e ECA-s në Francë koordinohen nga Sekretariati i Përgjithshëm i Punëve të Evropës, i cili është një organ administrativ nën Kryeministrin, i ngarkuar për koordinimin e punës ndërqeveritare për çështjet që lidhen me BE-në

<sup>27</sup>Përfshirë 10 vizita auditimi të shoqëruar nga gjykatat përkatëse të auditimit të shteteve federale (Länder).

<sup>28</sup>Përfshirë 9 vizita auditimi të shoqëruar nga gjykatat përkatëse të auditimit të shteteve federale (Länder).

<sup>29</sup>Shih gjithashtu raportet e veprimtarisë së ECA për vitet 2009 deri 2011 (që përfshijnë numrin e auditimeve) dhe Raportin e Aktivitetit të ECA 2016 (i cili përfshin numrin e ditëve të auditimit të shpenzuara në Shtetet Anëtare)



ECA-n kur kryhen auditime në një shtet të caktuar, por dispozita nuk specifikon mënyrën e bashkëpunimit dhe një gjë të tillë nuk e bën asndonjë rregullore tjetër e BE-së. Prandaj, bashkëpunimi i SAI-t me ECA-n kryhet kryesisht në bazë të marrëveshjeve të pashkruara dhe traditës. Disa nga elementet e mënyrës së bashkëpunimit janë përcaktuar në rezolutat e Komitetit të Kontaktit, por ato janë mjaft të përgjithshme dhe jo të detyrueshme.

Duke qenë se nuk ka kërkesa ligjore të përcaktuara, mënyra e bashkëpunimit ndryshon. Për të përgjithësuar praktikën në shtete të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme, mund të përcaktohen katër modele kryesore të pjesëmarrjes së SAI-t në auditimet e ECA-s:

- nuk ka model bashkëpunimi - SAI nuk është i përfshirë në asnjë kontakt midis ECA dhe subjekteve të audituara (rast i rrallë);
- modeli pasiv - "kuti postare" për kontaktin midis ECA dhe subjekteve të audituara;
- modeli i përfshirjes - shoqëron audituesite ECA-s dhe vë në dispozicion çdo informacion të kërkuar (lloji më i zakonshëm);
- modeli aktiv - shoqëron audituesit e ECA, duke iu ofruar atyre informacion, dhe kryen një auditim të vetin mbi të njëjtën temë<sup>30</sup>; ndonjëherë kjo lidhet me bashkëpunimin në planifikimin e temave të auditimit (shumë rrallë).

Për më tepër, në vitet e fundit ECA ka bërë gjithnjë e më shpesh auditime në Shtetet Anëtare të bazuara ekskluzivisht në pyetësorë, pa vizituar vetë shtetin. Në rastet e përzgjedhura, SAI-t ndihmojnë ECA-n duke marrë dokumentacion për studime që janë hartuar nëpërmjet pyetësorit ose duke verifikuar informacionin.

### Njoftimi i auditimeve të ECA-s

Çdo muaj ECA njofton SAI-t për auditimet që planifikon të kryejë në një shtet të caktuar në katër muajt vijues. Ky është informacioni paraprak (për shembull, emri i shkurtuar i njësisë organizative të ECA, fusha e auditimit, emri i anëtarit të ECA që mbikëqyr auditimin, emrat e audituesve dhe numri i auditimit). Pa kontakt të mëtejshëm nuk mund të identifikohet objektii i auditimit, në mënyrë që të përcaktohet se cila njësi organizative e SAI-t do të jetë e rëndësishme për një auditim të caktuar dhe cili auditues duhet të caktohet për të marrë pjesë. Për këtë arsye është propozuar që ECA të specifikojë objektin e auditimit, subjektet që do të auditohen dhe rajonin në të cilin do të zhvillohet auditimi<sup>31</sup>. Ky informacion përfshihet vetëm në letrën e njoftimit të nënshkruar nga

---

<sup>30</sup>Në lidhje me praktikën e mëparshme, shih W. Wiklicky: *Austria* in OECD (1997) "Effects of European Union Accession: Part II External Audit", *SIGMA Papers*, Nr 20, OECD Publishing, Paris, fq. 21-22.

<sup>31</sup>Raport i përgatitur nga Grupi i Punës " *The Relationship between the European Court of Auditors and the Supreme Audit Institutions of the Member States – Co-operation, Working Relations and Procedures* " për

anëtari përgjegjës i ECA-s për një auditim të caktuar, e cila zakonisht paraqitet disa javë përpara se të vijë audituesit, ndonjëherë edhe më herët.

### Veprimet pasi është dorëzuar njoftimi i ECA

Pas marrjes së letrës së njoftimit, SAI përgjigjet në përputhje me nenin 287 (3) të Traktatit, nëse synon apo jo të marrë pjesë në auditim.

Deri pak kohë më parë, pasi SAI kishte marrë letrën e njoftimit, kontaktonte me subjektet kombëtare të audituara (zakonisht jo individët, si fermerët përfitues të ndihmave, por autoritetet që menaxhojnë fondet e BE-së), duke i informuar ata për auditimin dhe duke i kërkuar që të përgatisin dokumente dhe informacione specifike. Parimi sipas të cilit ECA kontakton entet kombëtare nëpërmjet SAI-t rezulton në mënyrë indirekte në nenin 287 (3) të Traktatit.

Në vitet 2016-2017, me iniciativën e ECA-s, u ndryshua procedura e korrespondencës midis ECA-s dhe administratave kombëtare:

- shumë SAI kanë vendosur të mos luajnë një rol koordinues në auditimet e ECA-s, prandaj kjo e fundit i dorëzon dokumentet drejtpërdrejt tek autoritetet kombëtare, ndërkohë që SAI mbahet i informuar gjatë gjithë procesit;
- disa SAI kanë vendosur të vazhdojnë koordinimin e auditimeve të ECA-s në shtetin e tyre, megjithatë kopjet e dokumenteve relevante të ECA-s dërgohen në të njëjtën kohë tek autoritetet kombëtare përkatëse, në mënyrë që këta të fundit të fillojnë menjëherë shqyrtimin e çështjeve të ngritura.

### Arsyet për pjesëmarrjen e SAI në auditimet e ECA-s

Disa SAI marrin pjesë në shumicën e auditimeve të ECA-s të kryera në shtetet e tyre, veçanërisht në auditimet e performancës, por më pak në auditimet që synojnë kontrollin e besueshmërisë së llogarive të BE-së, si dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të lidhura me to (të ashtuquajturit auditimet DAS). Kjo përfshirje mund të prekë të gjitha ose disa nga aktivitetet audituese: ndonjëherë audituesit e SAI-t marrin pjesë në të gjithë auditimin dhe në raste të tjera vetëm në takimet që janë më të rëndësishme për institucionin e tyre.

SAI-t supozojnë se janë partnerë me ECA-n dhe për këtë arsye i shpjegojnë audituesve të saj se si funksionojnë sistemet ligjore dhe administrative kombëtare. Për më tepër,

---

bashkëpunimin praktik në dispozitën neni 188c nr. 3 i Traktatit të KE-së lidhur me misionin e ECA-s që do të kryhet "në bashkëpunim me" institucionet kombëtare të auditimit; Bundesrechnungshof, 28 shtator 1998

audituesit e SAI-t u shpjegojnë autoriteteve kombëtare se si punon ECA. Parimi i bashkëpunimit të sinqertë (neni 4(3) i Traktatit për Bashkimin Evropian) përcakton që SAI duhet të lehtësojë kryerjen e auditimeve të ECA në një mënyrë që i shërben më së miri të gjitha palëve të përfshira.

SAI-t gjithashtu vendosin të marrin pjesë në auditimet e ECA-s në mënyrë që të përfitojnë qasje të hershme në gjetjet e tyre dhe të ndihmojnë audituesit e saj të kuptojnë më mirë këto gjetje në kontekstin kombëtar. Disa SAI deklarojnë se është detyrë e tyre për të ndihmuar administratën kombëtare në mënyrë që të mos bëjë gabime apo të veprojë në një mënyrë që do të rezultonte në uljen e fondeve nga Komisioni për shtetin ose tërheqjen e fondeve të dhëna më parë.

### Audituesit e SAI për auditimet e ECA-s

Për të përshkruar shkurtimisht praktikat shumë të ndryshme, mund të thuhet që audituesit e SAI-t marrin pjesë në auditimet e ECA-s, në disa ose në të gjitha mënyrat e mëposhtme: 1) përpara vizitës - kontakte paraprake me audituesit e ECA-s dhe përfaqësuesit e subjekteve të audituara; 2) ndonjëherë - monitorimi i përgatitjes së dokumenteve dhe informacionit që ECA kërkon nga të audituarit; 3) pjesëmarrja në takimin e hapjes; 4) ndihma si vëzhgues gjatë procedurave të auditimit të ECA-s; 5) ndonjëherë - konsultime me audituesit e ECA-s për çështjet që kanë të bëjnë me objektin e auditimit ose legjislacionin kombëtar; 6) pjesëmarrja në mbledhjen përmbyllëse dhe përmbledhja e rezultateve paraprake të auditimit.

Efektiviteti i pjesëmarrjes së audituesve të SAI-t në auditime varet nga shumë faktorë, përfshirë faktin nëse ata kanë njohuri mbi dokumentet e brendshme të ECA-s lidhur me auditimin në fjalë. Vizita në shtetin e caktuar është vetëm një pjesë e procedurave të auditimit të ECA, e cila paraprihet nga përgatitja e auditimit në bazë të dokumenteve të përpiluara (përfshirë ato të siguruar nga administrata kombëtare dhe subjektet e audituara), pasuar nga analiza e dokumenteve të marragjatë kësaj vizite dhe gjithashtu, kontaktet me subjektin e auditimit e Komisionin. Të gjitha këto janë me rëndësi të madhe. Një vizitë e shkurtër në një shtet të caktuar, e cila zakonisht zgjat vetëm disa ditë, ka për qëllim t'u mundësojë audituesve të ECA të kuptojnë funksionimin e objektit të shqyrtuar, të kontrollojnë nëse dokumentet e marra paraprakisht janë të sakta, të shqyrtojnë regjistrat e kontabilitetit mbi bazën e mostrave statistikore, dhe të verifikojnë hipotezat e supozuara. Një person që posedon vetëm njohuri të fituara në takime, mund ta ketë të vështirë ta kuptojë çështjen. Prandaj, nëse një auditues i SAI-t nuk njihet me dokumentet përpara vizitës, pjesëmarrja e tij është mjaft pasive kur audituesit e ECA-s auditojnë një subjekt.

## Përfitime reciproke

Për të përshkruar shkurtimisht përfshirjen e audituesve të SAI në auditimet e ECA-s, mund të thuhet se atmosfera e bashkëpunimit është zakonisht pozitive, bazuar në respektin dhe besimin e ndërsjellë. Ky është një bashkëpunim ndërmjet profesionistëve që kuptojnë nevojat e njëri-tjetrit. Gjithkush përpiqet të japë informacion dhe të shpjegojë fakte. Pas mbarimit të vizitës, audituesit e ECA-s, si rregull, diskutojnë problemet me audituesit e SAI-t. Ky informacion është paraprak dhe jo i detyrueshëm; megjithatë është me rëndësi për SAI-n, pasi lejon që ai të informohet për gabimet e administratës kombëtare siç perceptohet nga audituesit e ECA-s. Ky bashkëpunim është i dobishëm për të dyja palët, sepse ECA mund të përdorë njohuritë e SAI-t për administratën publike në shtetin përkatës. Është gjithashtu më e lehtë për të kapërcyer barrierën gjuhësore dhe për të identifikuar çështjet kyçe. SAI-t gjithashtu mund të përfitojnë një kuptim më të mirë të programeve të BE-së dhe projekteve specifike që duhet të auditohen.

Në të njëjtën kohë, përmbushja e detyrave që rrjedhin nga Traktati, veçanërisht ato që pajisin ECA-n me dokumente dhe informacione sipas kërkesës, ndonjëherë mund të imponojnë një barrë të konsiderueshme tek SAI dhe kërkojnë punë shtesë në fushat të cilat ky i fundit nuk ka ndërmend t'i auditojë. Kjo mund të rezultojë në zvogëlim të kapacitetit për të kryer auditimet e veta.

## III. Aktivitete që synojnë zbutjen e rrezikut të auditimeve të dyfishta

### Informacion mbi auditimet

Raportet e auditimit të ECA-s dhe SAI-t janë në dispozicion të publikut, megjithatë sot ne kemi akses në qaq shumë të dhëna sa ia vlen t'iu sigurojmë palëvetëinteresit informacione të orientuara drejt tyre.

Një nga synimet strategjike të Komitetit të Kontaktit, i cili u përmend fillimisht në "Deklaratën e Misionit" të tij, është nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit në auditim apo aktivitetet e lidhura me të. Objektivi zbatohet kryesisht nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe përvojës relevante në BE, duke përfshirë informacionin e auditimeve mbimbi menaxhimin dhe shfrytëzimin e fondeve të tij (auditimet e BE-së), dhe në veçanti qasjen dhe rezultatet e tyre. Kjo kontribuon në një mirëkuptim të përbashkët dhe mund të krijojë ide të reja për punën audituese të BE-së, veçanërisht në fazat e planifikimit dhe përgatitjes së auditimit (për shembull në fazën e analizës së riskut).

Aktualisht informacionet lidhur me auditimet e BE-së janë përcjellë sipas marrëveshjeve të mëposhtme:

- në vitin 2009 u krijua një mekanizëm i dedikuar për publikimin e auditimeve të BE-së të kryera nga SAI të ndryshëm në portalin Intranet të Komitetit të Kontaktit (CIRCABC –faqe internetie brendshme, e mbrojtur me fjalëkalim); Kjo u zëvendësua

në vitin 2015 me bazën e sapokrijuar të të dhënave të auditimeve EUROSAT, e cila është në dispozicion të publikut dhe e lehtë për t'u përdorur, me një opsion kërkimi në të. Megjithatë informacioni mbi auditimet e BE-së të kryera para vitit 2016 mund të gjendet vetëm në CIRCABC;

- në çdo mbledhje të KK-së paraqiten zakonisht dy deri në tre auditime të BE-së të kryera nga SAI-t; këto prezantime fokusojnë tema dhe qasje të reja të auditimit;
- ECA dërgon me e-mail informacione mbi Raportin Vjetor të saj dhe raporte speciale drejtpërdrejtë në shumë adresa;
- disa SAI publikojnë informacion në lidhje me auditimet e BE-së në faqet e tyre të internetit duke ngarkuar përkthimet e përmbledhjeve ose ndonjëherë, versionin e plotë në gjuhën angleze të raporteve të tyre të auditimit;
- deri pak kohë më parë, SAI i Holandës përgatiti një "Listë të auditimeve të BE-së që duhen plotësuar nga SAI-t e BE-së" në një vit të caktuar (lista e titujve të auditimit).

### Informacioni mbi programet e auditimit

Sipas rezolutës së Komitetit të Kontaktit të vitit 1998 "ECA dhe çdo organ kombëtar auditimi do të përpiqen, nëse lejohet nga dispozitat ligjore në fuqi, të shkëmbejnë çdo vit programet e tyre disavjeçare të auditimit (që mbulojnë 2-3 vitet në vijim) si dhe programet e tyre vjetore të auditimit për sa u përket fondeve të BE-së, programe që japin një përshkrim të qartë të temës dhe vendit të auditimit"<sup>32</sup>. Kjo dispozitë është zbatuar pjesërisht: disa SAI dorëzojnë listat e auditimeve të tyre në lidhje me menaxhimin dhe shfrytëzimin e fondeve të BE-së (deri para pak kohësh ato janë ngarkuar në portalin intranet të Komitetit të Kontaktit); ECA i siguron atyre një përshkrim të përgjithshëm të programit të saj vjetor (pa dhënë informacion në lidhje me cilat auditime do të kryhen dhe në cilin Shtet Anëtar).

Çështja është e komplikuar. Shumë SAI publikojnë programet vjetore të auditimit (disa gjithashtu në anglisht), ndërsa disa të tjerë nuk e bëjnë këtë. SAI-t deklarojnë se është e vështirë të identifikohen në mënyrë specifike auditimet e BE-së. Disa të tjerë kanë lëvizur nga një program pune vjetor në një sistem, në të cilin janë programuar auditime të reja çdo tre apo katër muaj me qëllim që të reagohet ndaj zhvillimeve të rëndësishme aktuale. Pavarësisht këtyre pengesave, duket i mundur zhvillimi i një praktike për njoftimin e programeve vjetore dhe shumëvjeçare të auditimit, ku nuk ekzistojnë kufizime ligjore.

### Koordinimi i programeve të auditimit

Parlamenti Evropian formoi idenë se ECA dhe SAI-t duhet të përpiqen të "koordinojnë burimet e tyre për të vlerësuar shpenzimet dhe performancën e buxhetit të BE-së, duke

---

<sup>32</sup>Rezoluta për përmirësimin e koordinimit midis ECA-s dhe SAI-ve kombëtare (CC-R-1998-06).

shmangur dyfishimin e punës, duke shkëmbyer informacion auditimi dhe duke identifikuar fushat me rrezik<sup>33</sup>. Ky është një postulat shumë i vështirë për t'u zbatuar. Zakonisht ECA dhe SAI fillojnë punën për draftin e programit vjetor të auditimit një vit e gjysmë deri në dy vjet përpara; të gjitha njësitë organizative të një trupi të caktuar auditimi janë të përfshira dhe është punë e vështirë që kërkon shumë kohë. Shtimi i pjesëmarrësve të jashtëm do ta bënte këtë procedurë edhe më të komplikuar. Për më tepër, duke pasur parasysh pozitat e tyre në organizimin e Bashkimit Evropian ose të një shteti të caktuar, do të dukej ligjërisht e pamundur për të futur një mekanizëm formal për dakordësimin e programeve të auditimit të SAI-t dhe ECA-s.

Sidoqoftë, mund të merret në konsideratë futja e mekanizmave më pak formalë në bazë të bashkëpunimit vullnetar ndërmjet ECA dhe SAI, si:

- a) duke sugjeruar temat e auditimit që do të përfshihen në programin e auditimit;
- b) duke shkëmbyer draft-programete auditimit për konsultim.

Duke qenë se sugjerimet për tema auditimi dhe komentet mbi draft programet e auditimit nuk janë të detyrueshme, futja e mekanizmave të tilla nuk do të ndikojë në statusin ligjor të ECA-s dhe SAI-t.

Praktika të tilla ekzistojnë, veçanërisht kur anëtarët e ECA-s mbajnë kontakte të ngushta me institucionet kombëtare të auditimit. Kjo zbaton gradualisht idenë e koordinimit të programeve, duke zvogëluar kështu rrezikun e kontrolleve të dyfishta.

#### Paraqitja e temave ad-hoc të auditimit dhe/ose bashkëpunimi në baza ad-hoc

Për shkak të procedurës së ndërlikuar të përgatitjes së auditimit, nuk ka gjasa që një temë auditimi e sugjeruar nga një organ auditimi të përfshihet në programin vjetor të një tjetri. Duket më e mundshme që një organ i caktuar auditimi të miratojë një propozim për të kryer një auditim të veçantë jashtë programit vjetor si një auditim ad-hoc. Një sugjerim mund të nxitet nga fakti se një organ i caktuar nuk ka të drejtë të kryejë një auditim të tillë (por i adresuari mundet) ose sepse do të lehtësonte ndjekjen e auditimeve të mëparshme. Sigurisht, vendimi në lidhje me përfshirjen apo jo të sugjerimit mund të mos jetë pozitiv, sepse varet nga shumë faktorë, si substancialëashtu edhe organizativë, dhe mbi të gjitha nga burimet në dispozicion.

Për shembull, në tetor 2014 ECA u kërkoi SAI-ve të merrnin pjesë në një auditim të saj dhe të përgatisnin: 1) një analizë dhe vlerësim të koherencës midis Strategjisë së Evropës 2020, marrëveshjeve të partneritetit dhe programeve operationale për vitet 2014-2020; 2) një analizë dhe vlerësim nëse i është vënë theksi i duhur rezultateve në marrëveshjet e

<sup>33</sup>Rezoluta e Parlamentit Evropian e 4 shkurtit 2014 mbi rolin e Gjykatës së Audituesve në të ardhmen, para. 18

partneritetit dhe programeve operacionale për vitet 2014-2020. Në atë kohë vetëm dy SAI (portugez dhe polak) ishin në gjendje për të përmbushur këtë kërkesë dhe informacioni i tyre është përdorur në Raportin Vjetor të ECA-s për vitin 2014<sup>34</sup>.

#### IV. Auditimet në bashkëpunim

##### Llojet e auditimit në bashkëpunim

Auditimet në bashkëpunim ndërmjet dy ose më shumë SAI mund të ndahen në paralele, të koordinuara dhe të përbashkëta:

- auditimet paralele: merret një vendim për të kryer auditime të ngjashme. Metodologjia dhe qasja e auditimit mund të shkëmbehen. Auditimi kryhet pak a shumë në të njëjtën kohë nga dy ose më shumë organe të pavarura auditimi, por me një ekip të veçantë nga secili prej tyre, zakonisht duke raportuar vetëm tek organi i tij drejtues dhe vetëm për çështjet brenda mandatit të vet;
- auditimet e koordinuara: auditimi i koordinuar është një auditim i përbashkët me raporte të veçanta auditimi tek organet drejtuese të SAI-t ose një auditim paralel me një raport të vetëm auditimi, përveç raporteve të veçanta kombëtare;
- auditime të përbashkëta: në këtë rast, vendimet kyçe janë të përbashkëta. Auditimi është kryer nga një ekip i përbërë nga audituesite dy ose më shumë organeve të pavarura, të cilët zakonisht përgatisin një raport të vetëm të përbashkët auditimi në secilin organ drejtues përkatës<sup>35</sup>.

##### Përpyekjet deri më sot

ECA dhe SAI-t kanë tentuar të kryejnë auditime bashkëpunuese që nga fillimi i bashkëpunimit ndërmjet tyre. Rrallë herëka ndonjë informacion në këtë drejtim, gjë që e bën të vështirë të raportohet mbi ndërmarrje të tilla, për të cilat mund të jepen vetëm shembuj:

- nga viti 1996 deri në 1998, Gjykata Portugeze Audituesve dhe ECA kryen auditime të përbashkëta në fushën e bujqësisë dhe Fondeve Strukturore<sup>36</sup>;
- në vitin 2009 ECA dhe Gjykata Italiane e Audituesve kryen një auditim të përbashkët paralel për menaxhimin e shëndoshë financiar të Fondeve Strukturore (mbylljen e programit 2000-2006)<sup>37</sup>;

---

<sup>34</sup>Raport Vjetor i ECA-s për zbatimin e buxhetit në vitin 2014, OJ C 371, 10.11.2015, f. 101, para. 3.38

<sup>35</sup>ISSAI 5800. Guidë mbi Auditimin e përbashkët, 2016; [http://www.issai.org/en\\_us/site-issai/issai-framework/4-auditing-guidelines.htm](http://www.issai.org/en_us/site-issai/issai-framework/4-auditing-guidelines.htm).

<sup>36</sup>H. Lopes: Portugal in OECD (1997) "Effects", etj., fq. 90-91

- ndërmjet vitit 2010 dhe 2011, ECA dhe SAI i Republikës Çeke dhe Holandës kryen auditime paralele të koordinuara të shpenzimeve për Politikat e Përbashkëta Bujqësore;
- në vitin 2014 ECA dhe NIK-u polak zbatuan një projekt auditimi në bashkëpunim gjatë misionit të auditimit të ECA-s në Poloni (auditimi me titull "Çrënjësja, kontrollimi dhe monitorimi i sëmundjeve të kafshëve")<sup>38</sup>;
- në vitin 2016 ECA, SAI i Kroacisë dhe NIK-u polak realizuan një projekt të koordinuar në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi performance mbi efektivitetin e Inicativës së Asistencës së Përbashkët për Përkrahjen e Projekteve në Rajonin Evropian (JASPERS)<sup>39</sup>;
- për më tepër, nga viti 1994 deri në vitin 2017 mbi 20 auditime të koordinuara janë kryer si pjesë e veprimtarisë së Komitetit të Kontaktit<sup>40</sup>, megjithatë ECA ishte zakonisht në rolin e vëzhguesit dhe nuk kreu auditim të vetin.

Ajo që kishte të përbashkët pjesa më e madhe e këtyre projekteve ishte fushëveprimi i kufizuar i bashkëpunimit, pasi ato ishin zakonisht auditime paralele, ku u përcaktua vetëm objekti i përgjithshëm dhe afati kohor i auditimit. SAI-t kishin ndikim të kufizuar në hartimin e auditimeve të kryera në bashkëpunim me ECA, veçanërisht tek metodat e auditimit<sup>41</sup>.<sup>1</sup>Auditimet CAP dhe JASPERS ishin ndoshta të parët ku SAI-t u ftuan të bashkëpunojnë në fazën e programimit.

#### Kostot dhe përfitimet

Auditimet në bashkëpunim kërkojnë gjithmonë përpjekje shtesë nga të gjitha palët:

- ndarja e burimeve, planifikimi i detajuar dhe programimi duhet të ndodhin shumë më herët;

<sup>37</sup>La coopération entre la Cour des comptes européenne et la Cour des comptes italienne. Examen comparé de la méthodologie des procédés de contrôle, Romë, 27 Qershor 2008

<sup>38</sup>Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet ECA dhe NIK të nënshkruar më 27 tetor 2014. Shih gjithashtu raportin special të ECA Nr. 06/2016: Programet e çrënjësjes, kontrollimit dhe monitorimit të sëmundjeve të kafshëve, faqja 17, shënimi 9

<sup>39</sup>Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet ECA-s, SAI-t të Kroacisë dhe NIK, nënshkruar më 7 mars 2016. Shih gjithashtu: Auditimi me vlerën më të lartë në vitin 2016; <https://www.nik.gov.pl/en/news/the-highest-value-audit-in-2016.html>

<sup>40</sup>P.sh. auditimi i TVSH-së për tregtinë brenda Komunitetit (1994), shtatë auditime paralele të fondeve strukturore (2000-2017) të kryera nga WG, auditimi pilot i qasjes së SAI-ve tek mbikëqyrësit kryesorë financiarë në Shtetet Anëtare të BE-së (2012) auditimi i koordinuar i zbatimit të legjislationit të BE-së për dërgesat e mbeturinave (2013)

<sup>41</sup>Arsyet e detajuara pse SAI i Danimarkës e konsideronte si të pamundur të merrte pjesë së bashku me ECA-n në auditim u paraqitën në Memorandumin e Komitetit Danez të Llogarive Publike për Raportin Vjetor të Gjykatës Evropiane të Auditimit për vitin 2008, Rigsrevisionen, dhjetor 2009, fq. 5, paragrafët 15-17. [http://uk.rigsrevisionen.dk/media/1892706/sekr03\\_09.pdf](http://uk.rigsrevisionen.dk/media/1892706/sekr03_09.pdf)



- identifikimi i temave presupozon një interes të përbashkët, si dhe zbulimin e zonave ku takohen BE dhe financimi kombëtar dhe ku duhet të gjendet një lidhje ndërmjet BE-së dhe legjislacionit kombëtar;
- përgatitja e auditimit duhet të përfshijë, për shembull: shkëmbimin e informacionit mbi rregulloret kombëtare dhe të BE-së; diskutime Memorandumit të Planifikimit të Auditimit; vendosjen e kriterëve për përzgjedhjen e projekteve që do të auditohen; përcaktimin e qartë dhe të përbashkët të metodave të auditimit që do të zbatohen;
- kontaktet / takimet e punës gjatë auditimit;
- përpunimi i një raporti të përbashkët është veçanërisht i vështirë, duke pasur parasysh motivet e ndryshme, të adresuarit dhe rezultatet e mundshme të auditimit<sup>42,13</sup>

Auditimet në bashkëpunim bëjnë të mundur shqyrtimin e çështjeve të audituara më në tërësi. Për shembull, në rrjedhën e auditimit të shpenzimeve për Politikën e Përbashkëta Bujqësore të kryera nga 2010 deri në 2011 nga ECA dhe SAI i Holandës, janë shqyrtuar të dyja sistemet dhe operacionet individuale (qasja holandeze "bazuar në sistemin" e kombinuar me metodologjinë DAS). Palët kanë kryer auditimin së bashku në bazë të një kombinimi të të dy qasjeve. Secili ka përdorur rezultatet e aktiviteteve të koordinuara të auditimit për të përgatitur raportin e vet. Ata kanë shkëmbyer dokumentacionin e auditimit, kanë planifikuar dhe kryer aktivitetet së bashku dhe kanë diskutuar gjetjet së bashku, të cilat secili partner mund t'i përdorte për të nxjerrë përfundimet e veta dhe njëkohësisht të shqyrtonte metodat e auditimit. Pjesëmarrja në këtë auditim kërkonte kohë për të dy institucionet dhe ECA duhet të shqyrtontemëshumë operacione (teste kontrolli) sesa me metodologjinë e "zakonshme" DAS (me kampione). Sidoqoftë, bashkëpunimi me partnerin holandez bëri që ECA të kuptojë më mirë objektin e auditimit dhe të formulojë konkluzione e rekomandime shtesë që nuk do të ishin të mundshme nëse ajo do ta kishte kryer vetëm auditimin.

Gjatë kryerjes së auditimit mbi ndikimin e Iniciativës JASPERS, audituesit nga ECA dhe SAI-t e Kroacisë dhe Polonisë vunë në dukje një sërë efektesh pozitive dhe vlera të shtuara, të tilla si:

- sfidë profesionale;
- qasje inovative dhe shumë-dimensionale me objektin e auditimit (nga perspektiva e BE-së dhe ajo kombëtare, d.m.th perspektiva e përfituesit);
- shkëmbimi i njohurive dhe përvojës;
- pasurim i metodologjisë dhe qasjes audituese;

---

<sup>42</sup> H. Lopes, si më lart

- qasje krahasuese në metodate punës, si dhe krahasimin e verifikimin e rezultateve të marra nga dy SAI-t dhe midis këtyre të fundit dhe ECA-s.

### Të ndërtosh besimin

Për shumë vite ECA dhe SAI-t kanë bërë propozime të kujdesshme vis-à-vis për auditime bashkëpunuese, veçanërisht për shkak të:

- shqetësimit në lidhje me metodologjinë e duhur të auditimit që aplikohet në përputhje me parimin se rezultatet e punës së audituesve të tjerë janë përdorur vetëm kur qasja e auditimit është e njëjtë. Në praktikë, edhe pse ECA dhe SAI-t respektojnë standarde të njëjta ndërkombëtare, metodologjitë e tyre tëauditimit mund ta ndryshojnë;
- dallimeve në organizim, funksionim dhe në procedurat e auditimit midis ECA-s dhe SAI-ve;
- besimi i pamjaftueshëm midis ECA-s dhe SAI-ve: një kompromis në lidhje me metodologjinë e auditimit ndonjëherë shihet si një përpjekje për të minuar pavarësinë. Megjithatë, pavarësia nuk mund të kërcënohet në rastin e një vendimi sovran mbi bazat e bashkëpunimit vullnetar me një organ tjetër auditimi dhe harmonizimit të ndërsjellë të metodologjisë së auditimit.

## V. Konkluzione dhe sugjerime

Që nga themelimi i ECA-s në vitin 1977, kjo e fundit dhe SAI-t kanë ndërmarrë veprime të rëndësishme, të ndryshme, të vështira dhe që shpesh kërkojnë kohë, të cilat synojnë krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit në auditimin e menaxhimit dhe shfrytëzimit të fondeve të BE-së. Kjo gjë ka pasuruar praktikën dhe ka krijuar shumë kontakte të ngushta profesionale. Ato ndryshojnë nga shteti në shtet dhe ky artikull paraqet vetëm informacion të kufizuar për këtë çështje.

Megjithatë, ndoshta ka hapësirë për forcimin e bashkëpunimit dhe për këtë arsye mund t'i jepet vëmendje e veçantë çështjeve si më poshtë:

- 1) Neni 287 (3) i Traktatit, i cili ka të bëjë me kryerjen e auditimeve të ECA-s në Shtetet Anëtare "në bashkëpunim me organet kombëtare të auditimit", është aplikuar në një kuptim mjaft të ngushtë. Lind pyetja nëse është i mundur një interpretim tjetër që do të nxiste bashkëpunimin më intensiv ndërmjet ECA-s dhe SAI-t?
- 2) Çfarë veprimi duhet të ndërmerret për të eliminuar (ose të paktën të zbutur) rrezikun e auditimeve të mbivendosura nga ECA dhe SAI? Zgjidhjet organizative tëaplikuara deri më tani nuk e kanë penguar një situatë në të cilën dy ekipet e auditimit, auditojnë

të njëjtin objekt në të njëjtën kohë, ndoshta në të njëjtat subjekte, duke kërkuar të njëjtat dokumente etj, edhe pse sipas procedurave të ndryshme të auditimit.

Mundësia për të konsultuar programin e auditimit dhe rezultatet e auditimeve të kryera nga organetë tjera auditimi mund të kontribuojë në një mirëkuptim të ndërsjellë dhe mund t'i japënjitje ideve të reja për auditime, veçanërisht në planifikimin e auditimit dhe fazën përgatitore.

- 3) Për shkak se mandatet e ECA-s dhe SAI-t për të audituar menaxhimin dhe shfrytëzimin e fondeve të BE-së pjesërisht mbivendosen, është i dobishëm bashkëpunimi vullnetar, duke përfshirë auditimet bashkëpunuese. Natyrisht një bashkëpunim i tillë rezulton në kosto shtesë dhe fillimisht përfitimet mund të jenë të ulëta në raport me burimet e përdorura bashkërisht.

Megjithatë, mundësia e paraqitjes së konkluzioneve të auditimit në një shkallë më të gjerë është një vlerë e shtuar, gjë që nuk është e lehtë për t'u bërë veç e veç nga SAI-t dhe ECA. Këta të fundit kanë mandate të ndryshme, por plotësuese; në qoftë se ata punojnë së bashku, rezultatet e auditimit paraqesin informacion më të plotë. Gjithashtu, ndërtimi i besimit reciprok është një vlerë e shtuar e veprimeve të përbashkëta.

- 4) A i ndihmon ECA-n dhe SAI-t mënyra ekzistuese e bashkëpunimit ndërmjet tyre? A janë ata në gjendje të sigurojnë qytetarët e BE-së se përpjekja për bashkëpunim është fokusuar si duhet, është organizuar në mënyrë të përshtatshme dhe arrin rezultatet e pritura?

## DËSHMI

### Gjykata Evropiane e Audituesve dhe marrëdhëniet e saj me Gjykatën Italiane të Llogarive në kontekstin evropian

Pietro Russo, Anëtar i ECA

President seksioni në Gjykatën Italiane të Llogarive dhe anëtar i Gjykatës Evropiane të Audituesve.

Opinionet e shprehura janë të vetë autorit.



*Pietro Russo, Anëtar i ECA  
President seksioni në Gjykatën  
Italiane të Llogarive dhe anëtar i  
Gjykatës Evropiane të  
Audituesve.*

Roli i institucioneve përgjegjëse për auditimin e financave publike është shumë më i rëndësishëm sesa thjesht auditimi i llogarive. Në të vërtetë, në zhvillimin e sistemeve ligjore të botës perëndimore, ky rol është e lidhur historikisht me forcimin e rolit të parlamenteve, si përfaqësues të popullit dhe shprehës të demokracisë.

Kur regjimet absolute mbarojnë dhe pushteti legjislativ forcohet, duke fituar supremaci mbi ekzekutivin, është logjike që ai duhet të kontrollojë dhe miratojë edhe planifikimin menaxhimit të fondeve publike dhe performancën e tij aktuale. Kjo e fundit, e cila përfshin pajisjen e ekzekutivit me një "shkarkim", ka një domethënie të fortë politike për shkak se një rezultat negativ do të thotë se nuk ka më besim tek qeveria. Kjo do të thotë se Parlamenti duhet të jetë në gjendje të mbështetet në një organ të pavarur 'teknik' për të audituar ekzekutivin - pra një autoritet të auditimit të jashtëm.

Në këtë mënyrë erdhën në jetë Institucionet Supreme të Auditimit në Evropë, në një proces sistematik që ka ndodhur edhe një herë në vitin 1977, në rastin e Gjykatës Evropiane të Audituesve.

Në të vërtetë, nuk është rastësi që Traktati i 1975 në Bruksel, i cili forcoi në mënyrë të konsiderueshme rolin e Parlamentit Evropian në lidhje me Këshillin në fushën financiare, duke i dhënë (së bashku me Këshillin) fuqinë për të "shkarkuar" mbi menaxhimin e buxhetit nga ana e Komisionit, gjithashtu krijoi Gjykatën Evropiane të Audituesve.

Prandaj, në momentin kur Gjykata e Audituesve hyri në sistemin evropian, me pavarësi të garantuar, ajo u bë një instrument i privilegjuar në vlerësimin e Parlamentit mbi menaxhimin financiar të bërë nga Komisioni.

Kur u krijua, Gjykata e Audituesve nuk ishte një nga institucionet e Komunitetit. Ishte Traktati i Mastrohit që i dha asaj statusin, duke e përfshirë atë në titullin kushtuar Institucioneve.

Aktualisht, Gjykata e Audituesve qeveriset nga nenet 285, 286 dhe 287 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Detyra e saj është të auditojë financat e BE-së, një auditim i jashtëm në krahasim me kontrollin e brendshëm të kryer nga çdo institucion individual, dhe gjithashtu teknik, në krahasim me kontrollin politik të ushtruar nga ana e Parlamentit Evropian (së bashku me Këshillin), gjë që siç kemi parë, çon në dhënien e “shkarkimit” në favor të Komisionit. Gjykata nuk është një gjykatë ligji, as nuk zotëron kompetenca zbatimi ose sanksioni. Në vend të kësaj, ajo ushtron funksionin e mbikëqyrësit, duke lëshuar raporte dhe opinione.

Numri i anëtarëve të saj u vendos të ishte i njëjtë me numrin e Shteteve Anëtare dhe Traktati i Nicës specifikoi se ajo duhet të përbëhet nga një qytetari secilit Shtet Anëtar - një kriter që ka qenë gjithmonë i aplikuar në praktikë.

TFEU përmban një deklaratë solemne në lidhje me pavarësinë e anëtarëve të ngjashme me atë për gjyqtarët dhe avokatët-gjeneralë të Gjykatës së Drejtësisë.

Anëtarët emërohen nga Këshilli për një mandat prej gjashtë vjetësh, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, në bazë të propozimeve të shteteve anëtare.

Gjykata është një organ kolegial dhe vepron si i tillë. Presidenti zgjidhet nga anëtarët, si *Primus inter pares*, për një mandat prej tre vjetësh, me detyrat e thirrjes dhe kryesimit të mbledhjeve, mbikëqyrjen e drejtimit të shëndoshë të administratës dhe përfaqëson Gjykatën në aktivitetet e jashtme<sup>43</sup>.

Anëtarët ndihmohen nga zyrtarët që ushtrojnë funksione audituese ose administrative. Ata kryesohen nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 287 TFEU përshkruan kompetencat audituese të Gjykatës në detaje. Ato mbulojnë siligjshmërinë, ashtu edhe rregullsinë e shpenzimeve buxhetore Evropiane dhe menaxhimin të shëndoshë financiar; ata gjithashtu mbulojnë llogaritë e të gjitha organeve, zyrave ose agjencive të financuara ose të krijuara nga BE përveç rasteve kur kjo përjashtohet nga instrumentet e tyre konstitutive.

---

<sup>43</sup>Traktati i Nicës prezantoi mundësinë e Gjykatës për të krijuar Dhoma që do të ishin përgjegjëse për miratimin e llojeve të caktuara të akteve. Pesë Dhoma të tilla u paraqitën me vendim të Gjykatës në datën 11/3/2010. Ata kanë fuqinë të miratojnë raporte dhe mendime, por jo Raportin Vjetor, i cili mund të miratohet vetëm nga Gjykata e plotë.

E para nga këto, natyrisht, lidhet me faktin nëse aktet e nivelit drejtues përputhen me dispozitat ligjore, ndërsa e dytame efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e vetë nivelit drejtues.

Auditimet, të kryera si nëpërmjet dokumenteve ashtu edhe në terren, të çojnë tek raporti vjetor në lidhje me secilin vit financiar. Ky raport i paraqitet Parlamentit dhe Këshillit në vitin financiar "n + 1", dhe në veçanti, përmban një Deklaratë Sigurie - praktikisht, një certifikim - në të cilën Gjykata vërteton besueshmërinë e llogarive, si dhe ligjshmërinë e rregullsinë e transaksioneve, së bashku me vlerësimete veçanta për sektorët kryesorë të aktivitetit të BE-së.

Përveç Raportit Vjetor, Gjykata mund të paraqesë raporte të veçanta për një temë të caktuar në çdo kohë. Ajo gjithashtu ka funksion këshillues nëpërmjet opinioneve të saj, të cilat mund të jenë ose diskrecionale (me kërkesë të një ose më shumë institucioneve të BE-së) ose të detyrueshme (të parashikuara në mënyrë specifike, për fusha të caktuara, nga nenet 322 dhe 325 të TFEU).

Në pothuajse të gjitha rastet, kontrollet në terren të bëra nga Gjykata lidhen me shpenzimet e kryera brenda Shteteve Anëtare nga autoritetet kombëtare.

Kjo është arsyeja pse Neni 287 parashikon që këto kontrolle të kryhen në bashkëpunim me Institucionet Kombëtare të Auditimit, përveç rastit kur këto institucione nuk kanë kompetencat e nevojshme.

Traktati i Amsterdimit gjithashtu shtoi dispozitën që lejonte Gjykatën dhe SAI-t për të bashkëpunuar në frymën e besimit reciprok, ndërsa mbanin pavarësinë e tyre. Megjithatë, kur SAI-t dëshirojnë të marrin pjesë direkt në një kontroll në terren, ata duhet ta informojnë atë paraprakisht.

Bashkëpunimi i SAI-t në veprimtarinë audituese të ECA-s, siç është përcaktuar në nenin 287 TFEU, presupozon kompetenca specifike të SAI-t, të parashikuara drejtpërdrejt nga Traktatet, në lidhje me aktivitetet e Gjykatës Evropiane.

Ky sistem u prezantua me krijimin e ECA-s dhe i ka rrënjët në lidhjen shumë të ngushtë mes menaxhimit të fondeve strukturore, nga të cilatvaren politika e kohezionit, shpenzimeve të zhvillimit rural dhe e fondeve kombëtare. Kjo është për shkak të sistemit të bashkë-financimit, i cili është aplikuar gjerësisht në këtë fushë (por roli i autoriteteve kombëtare është gjithashtu themelor në fushën e ndihmës direkte për bujqësinë që së bashku me sektorët e tjerë të përmendur, është sektori më i madh i shpenzimeve në buxhetin e BE-së).

Në bazë të këtij mekanizmi, autoritetet kombëtare menaxhojnë resurset nga buxhetet kombëtare, të paguara për të njëjtat objektiva.

Në rastin e Italisë, kompetencat e Institucionit Suprem të Auditimit janë veçanërisht të gjera, dhe përfshijnë si menaxhimin e fondeve evropiane, ashtu edhe pjesën e fondeve kombëtare.

Ky organizim i ri është implementuar për një vit e gjysmë. Si drejtues në një proces të “rishikimit panoramik” - një produkt inovativ i ECA-së - kisha mundësinë të dalloja përparësitë dhe sfidat e kësaj strukture të re organizative. Përfitimi kryesor ishte qasja në një ekip me burime të mëdha: me pëlqimin e drejtorëve përkatës, kisha mundësinë të rekrutoja anëtarë ekipi me përvojën, njohuritë dhe aftësinë gjuhësore të duhur nga një grup prej 550 audituesve, në vend që përzgjidhja nga një grup prej 12 personash. Isha gjithashtu në gjendje të forcoja efektivitetin e ekipi tim edhe kur ngarkesa e punës arrinte pikun e tij. Përfundimisht, kisha mundësinë t'u siguroja anëtarëve të ekipit tim *feedback*, të cilat do të merren parasysh në vlerësimet e tyre zyrtare. Megjithatë, koordinimi i burimeve që menaxhohen nga katër drejtorë të ndryshëm kërkon goxha punë. Dhe në praktikë, kjo u pa të ishte më pak fleksibël sesa do të kishte qenë brenda një njësie të vogël për të bërë rregullime të personelit kur anëtarët e ekipit mungonin papritur për periudha të gjata ose kur kërkohej punë shtesë. Por në përgjithësi, unë e konsideroj këtë strukturë të re organizative si një përmirësim të madh: kjo bën të mundur që burimet e duhura të përshtaten me kërkesat e detyrës, pavarësisht nëse kërkon më shumë koordinim. Kjo duhet të na lejojë të rrisim cilësinë e produkteve tona.

Vetëm për të vënë gjërat në perspektivë, vlen për t'u theksuar se Reforma 2016 e Gjykatës përbën vetëm një nga disa ndryshime organizative që Gjykata ka pësuar që nga krijimi i saj në vitin 1977. Kur u themelua, Gjykata ishte në fakt një organizatë-matricë, ku secili nga nëntë anëtarët ishte përgjegjës për një nga nëntë fushat e politikave dhe një nga nëntë kompetencat horizontale (programi i punës, metodat, marrëdhëniet me Komisionin, etj). Me përfshirjen e anëtarëve të rinj në vitet 80' e 90', u krijuan sektorë të rinj. Kur numri i anëtarëve u rrit nga 15 në 25 në vitin 2004, u bë e nevojshme një strukturë e re: grupet e auditimit u krijuan dhe anëtarët u bënë kolektivisht përgjegjës për aktivitetin e përgjithshëm të grupeve të tyre të auditimit. Së fundi, në vitin 2010, pas “*peer-review*”-s në vitin 2008 dhe përgatitjes së Strategjisë 2009-2012, Gjykata krijoi sallat e auditimit, të cilët ishin përgjegjës për miratimin e raporteve të posaçme në emër të Gjykatës, duke reduktuar kohën e nevojshme për publikim.

### Sfidat e së ardhmes

Është shumë më e vështirë të parashikohet e ardhmja sesa të sjellësh disa kujtime të mira nga ditët e hershme të Gjykatës, por unë kam përmendur gjashtë sfida, me disa prej të cilave po përballemi qysh tani:

- Forcimi i besimit të qytetarëve të BE-së;
- Rritja e transparencës së Gjykatës;
- Përmirësimi i afateve kohore të raporteve tona;
- Përshtatja e raportit tonë vjetor;

- Ruajtje e cilësisë së stafit tonë; dhe
- Përdorimin e teknologjive të reja.

Në nëntor të vitit 2015 u zhvillua një studim i brendshëm i perceptimeve të stafit për të ardhmen e Gjykatës në vitin 2040. Rezultati më i çuditshëm dhe disi shqetësues i anketës ishte se 25% e stafit besonin tek e ardhmja e ECA-s, 85% mendonin se ka gjasa që Gjykata të mos ekzistojë më në vitin 2040. Klima aktuale e euroskepticizmit na bën, si auditues, të pakëndshëm: ndonëse shumica prej nesh janë mbështetës të fuqishëm të BE-së, ne shpesh duhet të nxjerrim në pah aspektet negative në menaxhimin e fondeve të BE. Edhe nëse qëllimi ynë përfundimtar është promovimi i llogaridhënies, transparencës dhe përmirësimit të menaxhimit financiar të BE-së, dërgimi i mesazheve negative e ushqen këtë euroskepticizëm.

Kjo, sipas mendimit tim, çon në sfidën e parë, dhe ndoshta më të rëndësishme, me të cilën përballet Gjykata: Si mund të ndihmojmë për të rikthyer besimin e publikut në BE duke rritur transparencën, duke treguar si anën pozitive ashtu edhe atë negative?? Qytetarët e BE-së duhet të binden se BE zbaton rendin e ligjit, shpenzon paratë e taksapaguesve me mençuri dhe mbi të gjitha korr më shumë sukses në një nivel ndërkombëtar, sesa Shtetet Anëtare mund të arrijnë individualisht.

Për raportet tona për të ndihmuar në rivendosjen e besimit të publikut, ne gjithashtu duhet të vendosim kontakte më solide me qytetarët. Sfida e dytë me të cilën përballet Gjykata është se shumë shtetas të BE-së janë të panjohur me veprimtarinë e Gjykatës. Ne duhet të përshtatim llojin e produkteve që publikojmë, krijojmë produkte të përshtatshme dhe përmirësojmë bashkëpunimin me lloje të ndryshme të mediave dhe qasjen tonë ndaj grupeve kyçe të palëve të interesuara. Ne gjithashtu duhet të përqendrojmë komunikimin tonë, jo vetëm në institucionet e BE, por edhe në qeveritë kombëtare apo rajonale. Në anketën e sipërpërmendur, më shumë se 60% e stafit të ECA besojnë se Gjykata duhet të ketë marrëdhënie më të ngushta me qytetarët e BE.

Një sfidë e tretë, dhe ajo me të cilën tashmë jemi përballur për një kohë, është afati i raporteve tona. Afati kohor është elementi kyç në mënyrë që publikimet tona të kenë impakt për qytetarët. Megjithatë, auditimet mund të ndodhin vetëm pasi projektet të përfundojnë. Pastaj, zakonisht merr më shumë se një vit për të kryer auditimin në shumë shtete anëtare, për t'u ballafaquar me subjektet e për të mos përmendur përkthimin e raportit në 23 gjuhë. Por rezultatet e auditimit janë relevante vetëm nëse ato ndikojnë tek debatet para se të miratohen ligje të reja. Si rezultat, dritarja për kryerjen e një auditimi mund të jetë shumë e ngushtë. Gjykata ka punuar tashmë në disa aspekte për të zvogëluar kohën audituese, të tilla si riorganizimi i procedurave tona të auditimit, zgjerimi i ekipeve të auditimit dhe duke përdorur mjetet kompjuterike të përkthimit si dhe zhvillimin e produkteve specifike. A nevojiten ndryshime drastike?

Sfida e katërt me të cilën do të përballemi është përshtatja e produktit tonë kryesor, raporti vjetor, i cili ende është shumë i përqendruar në ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të BE. Megjithëse ka kontribuar në përmirësime të konsiderueshme në menaxhimin financiar të BE-së në 20 vitet e fundit, qytetarët e BE-së kërkojnë jo vetëm që taksat e tyre të

shpenzohen në përputhje me rregullat, por edhe që politikat e BE-së të arrijnë objektivat e tyre. Raporti vjetor ende konsumon rreth gjysmën e burimeve të auditimit të Gjykatës. Në anketën e vitit 2015, më shumë se gjysma e kolegëve të mi parashikuan një reduktim masiv në punën financiare të auditimit dhe pajtueshmërisë. Burimet e çliruara nga ky reduktim mund të ndihmojnë në rritjen e punës audituese të Gjykatës në aspektet e performancës së veprimeve të BE.

Sfida e pestë mund të jetë menaxhimi i stafit. Stafi i Gjykatës është një nga asetet kryesore të saj. Megjithatë, shkurtimi i stafit, karrierat e gjata dhe të avashta, ngrirja e pagave dhe oraret e gjata të punës, si pasojë e ndryshimeve të fundit të rregullore të stafit në vitin 2014, kanë ndikuar në motivimin e stafit. Afatet e shkurta dhe ngarkesa e lartë e punës e mbajnë presionin e lartë. Këto, të kombinuara me euroskepticismin në disa shtete anëtare, kritikën e vazhdueshme ndaj shërbimit civil të BE-së dhe Brexit, kanë shkaktuar një dekurajim. Disa nga kolegët e mi të rinj që ndjekin sesionet e trajnimit kanë pranuar se po përgatiten për një karrierë tjetër në rast se u duhet të largohen nga Gjykata nëse shteti i tyre do të largohet nga BE-ja apo nëse kushtet e punës nuk bëhen edhe më tërheqëse. Ajo që është e qartë është se kurrë nuk do të gëzojmë të njëjtat kushte pune si gjenerata e mëparshme e zyrtarëve. Tashmë sot, institucionet e BE po dështojnë të tërheqin aplikantët nga shtetet më të pasura anëtare. Kjo mund të duket, në shikim të parë, një çështje e brendshme për institucionet e BE-së. Sidoqoftë, në një kohë kur BE nuk përfaqëson një vizion tërheqës për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së saj, nëse Gjykata fillon të mos tërheqë ose mbajë personel shumëgjuhësh të talentuar të cilët janë të gatshëm të zhvendosen me familjen e tyre nga e gjithë BE-ja dhe jo vetëm nga vendet më pak të pasura - cilësia e punës së institucionit tonë mund ta pësojë.

Sfida e gjashtë ndoshta është më shumë se një mundësi: teknologjia. Çdo vit në Gjykatë shfaqen ide inovative: Wi-Fi kudo, dhoma të shumta për video konferenca, pajisje të lëvizshme dhe softuer të ri. E ardhmja ndoshta do të sjellë edhe më shumë mundësi të reja. Për shembull, platformat *open data* ofrojnë një mekanizëm eficient për analiza. *Dron*-ët mund të na kursejnë kohën e vizitave në secilin shtet, madje mund të na lejojnë t'i bëjmë ato në distancë. Përkthimi i automatizuar mund të modernizojë më tej procesin e publikimit. Teknologjia mund të jetë e volitshme; por duke punuar në reformën e Gjykatës së 2016-ës, jam i ndërgjegjshëm gjithashtu se sa e vështirë është të ndryshohen proceset e ngulitura në një organizatë profesionale.

Reforma në Gjykatën e vitit 2016 ishte ndoshta më e madhja në dekadën e kaluar. Kjo na lejoji që pjesërisht të adresojmë disa prej sfidave të listuara më sipër. Por për t'u përballur me sfidat e tjera të ardhshme, ritmi i ndryshimeve ndoshta do të përshpejtohet. Në 2016 dhe 2017, Gjykata ka përjetuar tashmë dy ndryshime të tjera të rëndësishme: një Dhome e Pestë u krijua në mes të 2016-ës, dhe raporti vjetor është duke u modifikuar në mënyrë rrënjësore. Disa nga sfidat e listuara më sipër janë trajtuar edhe në strategjinë e Gjykatës Europiane të Audituesve për 2018-2020. Nuk ka dyshim se Gjykata do të duhet të përshtatet përsëri në të ardhmen e afërt, "duke shkuar përpara" për të përballuar sfidat dhe mundësitë e reja.

## DËSHMI

### ECA, si nënkryetare e Komitetit të Standardeve Profesionale INTOSAI



Neil Usher, Këshilltar i Parë; Lena Lambert, trajnuese; Harriet Lommer, trajnuese; Alan Findlay, Kryeauditues

Gjykata Europiane e Audituesve (ECA) është përfshirë në bashkëpunime ndërkombëtare, qysh prej krijimit të saj në vitin 1977. Bashkëpunimet ndërkombëtare të Gjykatës fokusohen kryesisht në punën bashkëpunuese me Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) në nivelin e Bashkimit Europian. Sidoqoftë ECA bashkëpunon me organizata ndërkombëtare auditimi jashtë Europës, në kuadër të grupeve rajonale të INTOSAI-t.

INTOSAI vepron si një organizatë mbrojtëse për komunitetin e auditimit të jashtëm publik, duke siguruar një strukturë të institucionalizuar për Institucionet Supreme Të Auditimit (SAI) për forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit dhe për të promovuar zhvillimin dhe transferimin e njohurive që lidhen me auditimin e sektorit publik. Si një organizatë mbarëbotërore për SAI-t, roli i INTOSAI-t është i sanksionuar nga dy rezoluta të ndërmarra në vitin 2011 dhe 2014<sup>49</sup> nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

ECA ka qenë një pjesëmarrëse aktive në aktivitetet e INTOSAI-t, si në Kongreset e çdo 4-mujori. Gjithashtu ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e standardeve, si anëtare e tre nënkomiteteve kryesore të vendosjes së standardeve dhe si kryetare e grupit të punës për hartimin e udhëzuesve për auditimin e fondeve që alokohen në rastet e fatkeqësisë.

Në linjë me strategjinë ndërkombëtare të bashkëpunimit në vitin 2014, nën mbikëqyrjen e Presidentit Vitor Caldeira, ECA vendosi në vitin 2015 të aplikojë për kryesinë e Komitetit të Standardeve Profesionale të INTOSAI-t (PSC), dhe iu caktua detyra e nënkryetarit për të punuar në partneritet me kryesuesin e këtij komiteti, Gjykatën Federale të Llogarive (TCU, SAI i Brazilit). Pas një pune përgatitore njëvjeçare, ECA ndërmori këtë sfidë në muajin dhjetor 2016 në Kongresin e XXII në Abu-Dhabi, kur kryesuesi në ikje i PSC, SAI i Danimarkës, formalisht u dorëzoi detyrën TCU-s dhe ECA-s.

Meqenëse PSC fokusohet në Objektivin Strategjik nr. 1 të Planit Strategjik të INTOSAI-t 2017-2022, TCU dhe ECA i caktuan vetes përmbushjen e ambicies së Objektivit nr. 1 për *“promovimin e kapaciteteve dhe pavarësisë së SAI-ve dhe inkurajimin e qeverisjes së mirë duke lërruar*

<sup>49</sup> Përkatësisht rezolutat A/66/209 dhe A/69/228

*dhe zbatuar standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI) si dhe kontribuar në zhvillimin dhe përdorimin e standardeve profesionale efektive”.*

Një nga detyrat kryesore të ECA si nënkryetar është sigurimi i cilësisë më të lartë të mundshme të Standardeve Ndërkombëtare Profesionale të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) dhe të proceseve që ndiqen për t'i zhvilluar dhe mbajtur ato, për një përfitim sa më të madh të anëtarëve të INTOSAI. Mandati i PSC përqendrohet në:

Sigurimin e një strukture organizative të fortë për të mbështetur vendosjen e standardeve, duke;

- Ofruar një udhëzues strategjik dhe një koordinim të përgjithshëm të vendosjes së standardeve;
- Konsoliduar Strukturën e Standardeve;
- Mbështetur iniciativat për forcimin e kapaciteteve për implementimin e Standardeve të INTOSAI-t; dhe
- Monitoruar implementimit dhe adoptimin e Standardeve të INTOSAI.

Përveç këtyre pikave kyçe, grupi i kryesisë së PSC mban kontakte të ngushta me nënkomitetet për Auditimin e Performancës (PAS), Auditimin Financiar (FAAS), Auditimin e Përputhshmërisë (CAS) dhe Standardeve të kontrollit të Brendshëm (ICSS), që janë pjesëmarrësit kryesorë të aktiviteteve të vendosjes së standardeve INTOSAI.

Në bilancin e vitit të parë si drejtues të PSC, ECA dhe kolegët e tyre brazilianë kanë shënuar disa suksese dhe kërkojnë projekte të reja, detyra dhe arritje të reja për vitin 2018 dhe më tej, që do të ndikojnë në INTOSAI dhe mbarë botën e auditimit të sektorit publik.

## DËSHMI

## Drejtoria e Përkthimit dhe Shërbimeve Gjuhësore: 40 vjet në shërbim të Gjykatës Europiane të Audituesve



Gailë Dagliënë, Drejtori i  
Drejtorisë së Përkthimeve dhe  
Shërbimeve Gjuhësore në ECA

*“Përkthimi nuk është vetëm një çështje fjalësh; është një çështje për të bërë të kuptueshëm një kulturë të tërë” (Anthony Burgess)*

Këtë vit, institucioni ynë kremton 40 vjetorin e krijimit. Gjatë kësaj periudhë, ECA ka krijuar një kulturë të mirëfilltë të auditimit europian, që shtrihet përgjatë BE-së, drejtuar nga një grup ambiciozë profesionistësh nga e gjithë Europa: auditues, avokatë, kontabilistë, specialistë IT dhe përkthyes. Ata të gjithë kanë kontributin e tyre në formimin e këtij institucioni modern dinamik të auditimit që ne kemi sot.

Gjykata prodhon një mori raportesh dhe publikimesh të cilat janë fryt i proceseve komplekse me shumë faza dhe grupe interesi.

Përkthyesit përbëjnë lidhëzën e fundit në zinxhirin e prodhimit.

Përkthyesit- *heronjtë në hije të fjalëve*- kanë qenë pjesë e Gjykatës, që prej krijimit të saj. Ata janë lexuesit e saj më të afërt, që tregojnë kujdes për çdo trajtë të fjalëve. Të zellshëm, të përpiktë dhe me një interes të theksuar në cilësi, përkthyesit kanë qenë gjithmonë të pranishëm, duke vepruar si një urë lidhëse midis Gjykatës dhe lexuesve të saj.

Dobishmëria e një teksti, sado i jashtëzakonshëm të jetë, matet nga kuptueshmëria e lexuesit. Përkthimi përçon mesazhe, duke e shpërndarë atë në çdo cep të Europës, një kanal komunikimi që lidh institucionet publike me qytetarët. Nëpërmjet punës së tyre, përkthyesit kalojnë kufij dhe kontribuojnë në përhapjen e njohurive institucionale.

Në këtë kohë feste dhe kujtese, kur shohim mbrapa dhe projektojmë veten tonë në të ardhmen, ka tre elemente të rëndësishme që na përcaktojnë ne si përkthyes: ne jemi një pikë reference për terminologjinë e auditimit të BE-së, përdorues intensivë të mjeteve moderne të IT-së dhe një drejtori dinamike që ofron një mori shërbimesh sipas nevojave të institucionit.

## Krijimi i terminologjisë

Fillimisht ishte vetëm një grup i vogël njerëzish që përkthenin në gjashtë gjuhët zyrtare të Komunitetit Europian. Me kalimin e kohës ky grup u rrit deri në përmasat e Drejtorisë së sotme.

Konsolidimi i Shërbimit të Përkthimit gjithashtu nënkuptonte krijimin e një terminologjie të auditimit Europian i cili faktikisht u bë një korpus multigjuhësor termash. Ky ishte një proces shumë sfidues që përfshiu gjetjen e ekuivalentëve të koncepteve që ndonjëherë madje nuk ekzistonin në disa Vende Anëtare. Ashtu si sistemet gjyqësore, që janë specifike të vendeve, edhe sistemet e auditimit mund të ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Për shembull, termi “auditim” ngriti probleme në disa gjuhë dhe u prezantua si një neologjizëm, që zëvendësoi termin “kontroll”.

Termet e auditimit të krijuara, zhvilluara dhe mbajtura nga përkthyesit tanë përbëjnë një thesar multigjuhësor. Ato janë një burim krenarie, ashtu si dhe përgjegjësie të vazhdueshme. Përkthyesit tanë kanë ndarë thesarin e tyre me Institucionet Kombëtare Supreme të Auditimit, të cilave u ka shërbyer në mënyrë të veçantë, sidomos atyre Vendeve Anëtare me më shumë se një gjuhë zyrtare.

Krijimi i terminologjisë është një aktivitet unik të cilin të paktë janë ata që mund ta ndërmarrin. Ndryshe nga përkthimi, që krijon kënaqësi kur produktiviteti është i lartë, krijimi i terminologjisë është si të bërit të bizhuterive, vlera e tyre matet me cilësinë e mirë, të secilës pjesë të vogël. Terminologjistët mund të harxhojnë orë të tëra, madje ditë për të gjetur termin e duhur, duke nxjerrë kuptimin dhe duke fshirë elementet sipërfaqësore, me qëllim që të gjejnë ekuivalentin e duhur në gjuhën në shqyrtim.

Gjatë këtij aktiviteti të përvitshëm, me këmbënguljen e duhur, ashtu si bleta që ndërton kosheren, përkthyesit tanë ndërtojnë bazën e terminologjisë së auditimit që përdoret aktualisht nga institucionet kombëtare dhe të tjera jashtë BE-së.

## Përdorimi i teknologjive të reja

Fillimisht të vetmet mjete në dispozicionin tonë ishin lapsi dhe letra. Progresi teknologjik gradualisht hyri në sektorin publik dhe në mënyrë të veçantë në fushën e përkthimit, e cila iu përshtat në mënyrë të veçantë inovacionit. Në drejtorinë tonë, përkthyesit dhe asistentët kanë nisur përdorimin e mjeteve të sofistikuar të TI në punën e tyre.

Programe modern të përkthimit fillimisht duhet të testoheshin, përshtateshin dhe implementoheshin. U krijuan memorie të mëdha përkthimi, të cilat u mbajtën dhe u pasuruan me kalimin e kohës. U krijua një bazë të dhënash të terminologjisë dhe qindra terma auditimi të cilat çuan në pasurimin me 8 milionë terma të bazës së të dhënave mbarëkombëtare (IATE). Kjo punë u bë nga përkthyesit dhe asistentët jashtë punës së tyre të përditshme, duke treguar edhe njëherë vlerën e komunitetit të përkthimit.

Përkthyesit e Gjykatës tashmë përdorin programe memorie-përkthimi, makina përkthimi, programe të menaxhimit të terminologjisë, bazë të dhënash të terminologjisë, programe të përkthimit të menaxhimit të projekteve, si dhe njohës zëri. Sot shumë prej këtyre mund të shihen nëpërmjet kufjeve dhe mikrofonit përpara dy ekraneve të mëdhenj, duke diktuar një përkthim i cili transkriptohet nga programi i njohjes së zërit. Ata të cilët përdorin makinën e përkthimit redaktojnë rezultatit e përkthimit, duke rregulluar gabimet dhe u siguruan që teksti është gati për publikim. Përkthyesit kanë ecur përpara duke u transformuar në profesionistë të IT.

Mos kjo nënkupton se ne mund të mbështetemi plotësisht në teknologji për përkthimet tona? Absolutisht jo! Megjithatë parashikimi është tërheqës, ne nuk kemi iluzione, puna njerëzore është absolutisht e pazvëndësueshme. Edhe për ato kombinime gjuhës për të cilat funksionon, makinat e përkthimit janë shumë herë me inferiore se faktori njerëzor. Kompjuterët mund të mundin njeriun në lojën e shahut, por ato nuk munden ende të zëvendësojnë trurin e njeriut kur bëhet fjalë për përkthim.

### Diversifikimi i shërbimeve

Fillimisht puna e përkthyesit ishte vetëm, thjesht të përkthente. Më vonë, si Gjykata u zgjerua dhe krijoi një mori produktesh, Drejtoria e Përkthimit mori përsipër diversifikimin e shërbimeve në lidhje me ofrimin e asistencës gjuhësore, shkrimit të titrave të videove dhe përkthimeve në internet, por jo vetëm kaq. Ky proces u shoqërua me modernizim të burimeve, që solli përfitime në efikasitet dhe një rritje në produktivitet. Kjo gjithashtu pasuroi burimet njerëzore në komunitetin e përkthimit, talentet e të cilëve u vunë në shërbim të Gjykatës.

Skuadra e gjuhës angleze ishte kyçe në procesin e përgatitjes. Për disa lloje dokumentesh, përkthyesit e anglishtes tashmë operojnë ngushtë me audituesit, përgjatë procesit të përgatitjes duke i ndihmuar për të nxjerrë një tekst që jo vetëm është gramatikisht i saktë, por që rrjedh natyrshëm dhe mund të lexohet qartësisht.

Asistenca gjuhësore është gjithashtu një nga shërbimesh më të çmuara të përkthyesve përpara, përgjatë dhe pas misionit të auditimit. Përkthyesit janë bashkë me audituesit gjatë takimeve të auditimit në vendet Anëtare dhe sigurojnë komunikimin e rrjedhshëm midis audituesve dhe të audituarve. Kjo punë kërkon një njohje të shkëlqyer të gjuhëve, ashtu si elasticitet, takt dhe aftësi për të kuptuar çështje komplekse dhe përballuar situata të vështira, si dhe aftësi sociale dhe komunikimi.

Disa elemente kombinohen për të bërë që asistenca gjuhësore të jetë një shërbim i vetëm: një ndjesi përkatësie (përkthyesit bëhen pjesëtarë të skuadrës së auditimit), një klimë besimi (përkthyesit dhe audituesit janë kolegë të cilët e njohin njëri tjetrin prej punëve të mëparshme), gatishmëri të plotë (përkthyesit punojnë për orë të gjata, edhe pa



ndërprerje), njohuri mbi çështjet (përkthyesit kanë njohuri mbi fushën e auditimit) dhe një objektiv të përbashkët (duke i shërbyer Gjykatës).

Gjatë viteve të kaluara Drejtoria e Përkthimit ka qenë e përfshirë gjithashtu në fushatën e Gjuhës së qartë të Gjykatës. Nëpërmjet konferencave, workshopeve, komunikimeve në intranet ose edhe thjesht nëpërmjet sigurimit të asistencës, përkthyesit u siguruan që lexuesit të kuptonin mesazhin që në leximin e parë.

Përgjatë këtij krentimi, kur ne shohim me krenari arritjet e Gjykatës, duhet të falënderojmë ata pa të cilët asgjë nuk do të ishte bërë e mundur.

Përkthyesit – njerëzit të cilët kanë punuar prapa skene, që nuk kanë qenë gjithmonë të dukshëm, por që puna e tyre ka qenë e rëndësishme për të vënë në punë makinën, me kapacitet dhe shpejtësi të plotë – kanë vendosur zemrën dhe shpirtin në shërbim të Gjykatës. E vetmja ambicie e tyre ka qenë arritja e përsosmërisë në cilësi, ndërsa dobësia e tyre e vetme, dëshira për të bërë gjithçka vetë. Dhurata e tyre është të parit përtej fjalës në faqe. Asgjë nuk mund t'i përcaktojë ata më mirë se fjalët e shkrimtares irlandeze Emma Donoghue:

*“Kur unë mendoj për këtë profesion, unë mendoj për dedikimin e devotsbëm dhe të palodhsbëm për të bërë gjënë e dubur”.*

## DËSHMI

### 40 vjet IT në ECA

#### Hyrje

Shfletimi përmes dyzet viteve të menaxhimit të informacionit në ECA ofron një perspektivë të mirë se si puna e një institucioni të auditimit evoluon me kalimin e kohës. Jo çuditërisht, teknologjia e informacionit ka qenë një nga drejtuesit kryesorë të ndryshimit. Por e kundërta është gjithashtu e vërtetë: mënyra se si IT ka evoluuar ka qenë rezultat i presioneve të krijuara nga prioritetet dhe rreziqet e reja të auditimit si dhe nga kornizat dhe standardet e tij.



Magdalena Cordero, Drejtor i  
Drejtorisë së Informacionit dhe  
Inovacionit në ECA

Ky artikull synon së pari të ofrojë një pasqyrë të gjerë të aspekteve kyçe që kanë kontribuar në organizatën tonë aktuale të IT duke identifikuar momentet kyçe dhe duke i detajuar ato nga këndvështrimi organizativ. Qeverisja IT dhe bashkëpunimi ndërinstytucional kanë qenë elementë kyçë në këtë histori. Ajo gjithashtu detajon sfidat kryesore, së bashku me rezultatet më të mëdha. Dhe së fundi, informacioni nuk do të ishte i plotë pa përmendur tendencat aktuale të IT-së në lidhje me sfidat në rritje të biznesit.

#### Datat kryesore

Tre momente shumë të rëndësishme kanë shënuar historinë e IT në ECA: vendimi i Gjykatës së 1987 për të caktuar burime të dedikuara për IT, raporti i vitit 2006 që e rriti atë në nivelin aktual të saj strategjik dhe miratimi në vitin 2009 të Planit IT në lidhje me përcaktimin e qeverisjes së duhur për IT në ECA.

Në vitin 1987, Gjykata zyrtarisht e njohu rëndësinë e informatikës në ECA dhe ndikimin e saj në auditim, si dhe nevojën për sistemet e informacionit për qëllime administrative dhe futjen e mjeteve mbështetëse, si përpunimi i tekstit dhe postës elektronike. Gjykata kuptoi se ishin të nevojshme burime adekuate, personel i specializuar dhe stafi IT i dedikuar.

Kjo shënoi fillimet e IT në Gjykatë dhe u zhvillua gjatë viteve deri në një ngjarje me rëndësi strategjike: një seminar për anëtarët e Gjykatës për "*Tendencat në aplikimin e teknologjive të IT-së në fushën e menaxhimit financiar*". Seminari trajtoi çështjen e aplikimit të mjeteve të auditimit të IT-së për performancën dhe auditimet financiare, përfitimet e mundshme dhe risqet e aplikimit të teknologjive IT dhe pasojat e moszbatimit të tyre. Si

rezultat, u krijua një grup pune që paraqiti konkluzionet e tij në vitin 2006. Më të rëndësishmet ishin: zhvillimi i një strategjie IT bazuar në nevojat e auditimit, duke mbuluar menaxhimin e njohurive dhe iniciativat “pa letra” në ushtrimin e punës; formimi i karakterit strategjik të IT duke krijuar një Komitet të Menaxhimit IT në nivel anëtar; krijimi i një politike të auditimit IT që do të formulohet dhe reflektohet në manualin e auditimit dhe të mbulohet nga udhëzimet metodologjike bazuar në kornizën COBIT<sup>50</sup>.

Në fund të vitit 2009, Gjykata vendosi një Plan IT për 2010-2012. Ajo krijoi një kornizë për qeverisjen e IT-së dhe përcaktoi parimet, qëllimet dhe objektivat për periudhën.

## Struktura

Organizimi i IT-së në ECA ka evoluar paralelisht me nevojat e organizatës dhe karakterizohet nga një shkallë e lartë e decentralizimit. Vendimi i vitit 1987 për të pasur staf të dedikuar për IT ka çuar në rekrutimin e ekspertëve IT dhe emërimin e një eksperti për çdo sektor të specializuar në auditimin kompjuterik, për t'i shërbyer nevojave të veçanta të sektorit. Stafi mori pjesë në programe trajnimi të përshtatura për përvojën e tyre personale.

Deri në vitin 1993, shërbimi i informatikës ishte tashmë një divizion me 12 zyrtarë me një profil të përzier të ekspertëve IT dhe personelit që kryen detyrat e auditimit kompjuterik. Në vitin 1994, përgjegjësitë e auditimit kompjuterik u transferuan nga Divizioni i Informatikës në njërën nga subjektet e auditimit. Ky vendim ndikoi në evolucionin e ardhshëm të IT në ECA: të dy grupet punuan me një ritëm të ndryshëm - jo gjithmonë të koordinuar - dhe rëndësia strategjike e njëres dhe tjetres ndryshonte me kalimin e kohës. Shpërndarja e roleve dhe përgjegjësiave asnjëherë nuk ka qenë e qartë. Në vitin 1996, Divizioni i Informatikës u integrua në Divizionin e Personelit dhe Informatikës, duke zvogëluar rëndësinë e informatikës në Gjykatë në terma relativë. Kjo vazhdoi deri në krijimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Informatikës, kur IT përsëri u caktua në strukturë si një divizion. Duhet të theksohet se, në mënyrë të pavarur nga entiteti, IT në ECA u udhëhoq nga menaxherët me një sfond auditimi, por jo domosdoshmërisht profesionistë të IT. Në vitin 2006, anëtarët e gjykatës rekomanduan ngritjen e një njësie të auditimit të dedikuar për IT me detyrat e mëposhtme: për të kryer auditime të sistemeve të IT, për të mbështetur punën e IT në njësitë e tjera të auditimit dhe për të ndihmuar audituesit e IT-së në përdorimin e mjeteve CAAT <sup>51</sup>. Kjo konfirmoi ndarjen e funksioneve të IT-së të krijuar në vitin 1994. Pas vendimeve të vitit 2006, Drejtorja e parë

---

<sup>50</sup> COBIT (Objektivat e Kontrollit për Teknologjinë e Informacionit) është një kornizë e krijuar nga shoqata profesionale ndërkombëtare ISACA për menaxhimin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe qeverisjen IT

<sup>51</sup> Teknikat Audituse Kompjuterike

për Teknologjinë e Informacionit dhe Telekomunikacionet u krijua më 1 tetor 2008. Në vitin 2010 u krijuan tre njësi brenda drejtorisë, një për sistemet e informacionit, një tjetër për infrastrukturë dhe shërbimet e përdoruesit, dhe e treta për qeverisjen IT. Profesionistët e IT u emëruan për këto role menaxheriale.

Në janar të vitit 2012, ekipi i Bibliotekës dhe Arkivave iu bashkua drejtorisë, e cila pastaj mori një emër të ri, Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë. Ky ishte një ndryshim shumë i dobishëm pasi lejoi që shumica e aktiviteteve qendrore rreth menaxhimit të informacionit dhe njohurive të mbeten nën të njëjtën ombrellë dhe të ndajnë të njëjtin vizion. Në vitin 2016, ekipi i ndërtuesve u transferua në drejtori, ndërsa drejtoria e re u riemërua si Drejtoria e Informacionit, Punës dhe Inovacionit. Megjithëse ky riorganizim ka sjellë vlerë të shtuar për ECA, pasi të dy vendet e punës - digjitale dhe fizike - po afrohen gjithnjë e më shumë me çdo ditë, pesha e teknologjisë së informacionit në ECA nuk është rritur ndjeshëm, kryesisht për shkak të kapacitetit menaxherial, i cili ka mbetur i pandryshuar sepse menaxherët ekzistues, profesionistët e IT-së, nuk kishin përvojë dhe njohuri për fushën e re.

## Qeverisja

IT në ECA u drejtua, për shumë vite nga një komitet këshillues i cili u krijua në vitin 1987 si një organ i përhershëm i ngarkuar me propozimet, identifikimin e nevojave dhe përcjelljen e vendimeve. Ky komitet, i riemëruar në vitin 1993, përbëhej nga përfaqësues nga grupet e ndryshme të auditimit, administrata dhe Komiteti i Stafit. Një anëtar i Divizionit të Informatikës ftohet në takime, por vetëm si vëzhgues. Ky është një tregues i rëndësisë shumë të kufizuar që i bashkëngjitet IT si një burim për transformimin e organizatës, në vend që të luajë rolin e ofruesit të shërbimit.

Ndarja e funksioneve të IT midis Shërbimit të Informatikës dhe Auditimit IT në vitin 1994 ka shkaktuar anomali të forta në qeverisjen e informatikës në ECA: u morën vendime, pa marrë parasysh analizën dhe mendimin e ekspertëve teknikë të shërbimit të informatikës. Për fat të keq, në vitin 2006, Gjykata konfirmoi ndarjen organizative midis Teknologjisë së Informacionit dhe Auditimit IT, e cila mbeti si pjesë e departamenteve të auditimit, një ndarje që është ende në fuqi.

Në prill të vitit 2007 Gjykata miratoi një Strategji gjithëpërfshirëse të IT-së që propozoi transformimin e Komitetit Administrativ në Komitetin Administrativ dhe IT, i cili u bë organi strategjik për çështjet e IT-së.

Plani i IT-së për vitet 2010-2013 krijoi një strukturë qeverisjeje tre-nivelesh: konsultim me përdoruesit, hartimin e strategjisë me anëtarët e gjykatës dhe koordinimi i saj me drejtorët. Rrjedhimisht, Komiteti Administrativ mbajti rolin e tij në çështjet e teknologjisë informative, dhe paralelisht u krijua Komiteti Drejtues i IT-së (ITSC), i përbërë nga drejtorët dhe kryesohej nga Drejtori i IT-së dhe Komiteti i përdoruesve IT (ITUC) zuri vendin e komitetit këshillues. Kjo strukturë është dëshmuar të jetë e përshtatshme për

zhvillimin e IT në Gjykatë: prioritetet vendosen me konsensus dhe zbatimi i tyre vijon në mënyrë të përsosur.

### Auditimi i IT-së në ECA

Ndërsa Auditimi IT dhe Informatika punuan së bashku në fillimet e informatizimit në ECA, që në vitin 1994 filluan të ndiqnin një rrugë të ndryshme, duke mos ecur në mënyrë paralele. Periudhat e aktivitetit sfiduese të auditimit IT u pasuan nga ato me aktivitet të ulët apo të ngjashëm, Informatika po implementonte shërbime të reja dhe siguronte infrastrukturën, nganjëherë më ngadalë dhe në kohë të tjera më shpejt se ritmi i kërkuar nga organizata.

Që në fillim të vitit 1987, dokumentet strategjike identifikuan auditimin kompjuterik si një aktivitet që do të kryhej në të gjitha sistemet e informacionit të përfshira në procesin e auditimit. Për çdo sistem, ishte kryer një vlerësim i kontrolleve të brendshme që do të garantonin besueshmërinë e informacionit të prodhuar dhe do të përcaktonte efektivitetin e tyre në dhënien e informatave adekuate për përdoruesit. Për më tepër, programi kompjuterik duhej të përdorej për nxjerrjen dhe përpunimin në masë të informacionit. Ky aktivitet i kontrollit duhej të plotësohej nga një rishikim i menaxhimit për të gjitha instalimet kompjuterike të rëndësishme. Ky specifikim i shkëlqyer dhe ambicioz i asaj se çfarë auditimi kompjuterik mund të mbulojë, është ende i vlefshëm sot, ECA ende zbaton atë që ishte përshkruar tashmë 30 vjet më parë.

Jo të gjitha vendimet e marra në vitin 2006 janë zbatuar dhe ECA mbetet larg të pasurit të metodologjive dhe praktikave të përbashkëta për Auditimin e IT. Ka patur pak iniciativa për analizën e të dhënave dhe një numër i kufizuar i auditimeve, të fokusuara në qeverisjen e sistemeve të IT-së, dhe rezultati ka qenë zhgënjyes gjatë viteve të fundit. Kjo kryesisht për shkak të zvogëlimit të madhësisë së ekipit të auditimit kompjuterik, faktit që ishte dedikuar në mbështetjen e sistemeve të informacionit për audituesit dhe, së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mungesës së një vizioni të duhur në këtë fushë. Pa dyshim, auditimi dhe shërbimet më të integruara dhe të koordinuara të IT-së do të ofronin sinergjitë e nevojshme për të bërë përparim të mjaftueshëm në këtë kontekst.

### Bashkëpunimi ndërinstytucional

Si organizatë e përmasave të mesme, ECA ka kërkuar gjithmonë shkrirje me organe të tjera. Funkzioni IT nuk është i ndryshëm në këtë drejtim. ECA është një anëtar shumë aktiv i Komitetit Ndërinstitucional IT (CII) që mbledh së bashku strukturat IT të të gjitha institucioneve të Bashkimit Europian. Ky Komitet ka nën-komisione që merren me projekte dhe dosje specifike në fushën e sigurisë, kontratave, telekomunikacioneve, vendeve të punës dhe arkitekturës. Një nga fushat më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi është prokurimi. Pjesëmarrja në tenderët ndërinstytucional i mundëson

ECA-s të përfitojë nga infrastruktura IT dhe lejon kursime të konsiderueshme në lidhje me barrën administrative.

Institucioni është gjithashtu anëtar i CERT-EU, Grupi i Reagimit të Emergjencave Kibernetike të Institucioneve Europiane që nga themelimi në vitin 2012. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, ECA mund të përdorë sisteme të shumta ndërinstitucionale të informacionit, veçanërisht në fushat e administratës, burimeve njerëzore, trajnimit, financave dhe përkthimit. ECA tashmë filloi përdorimin e sistemeve administrative nga Komisioni në mesin e viteve '80. Dhe në vitin 1997, Gjykata, Këshilli dhe Gjykata e Drejtësisë punuan bashkërisht për një projekt ndërinstitucional për të krijuar një administrim buxhetor dhe një aplikim të integruar të kontabilitetit. Ky bashkëpunim i frytshëm ka vazhduar deri më sot me zbatimin e sistemit SAP. ECA merr pjesë në Grupin Punues IT të EUROSAI. Në këtë forum ka dhënë një kontribut kyç në hartimin dhe zbatimin e metodologjisë së vetëvlerësimit të IT (ITSA) dhe ka vepruar si udhëheqës i projektit “*Sistemet e Informacionit në Mbështetje të Procesit të Auditimit (ISSAP)*” deri në vitin 2015.

### Iniciativat kryesore

Kompjuterizimi i ECA-s ka qenë një proces gradual; Pajisja e të gjithë stafit me një kompjuter zgjati më shumë se 5 vjet. Dhe vetëm në vitin 1992 ECA vendosi të krijojë Helpdesk-un. Në atë kohë, tre të katërtat e stafit të ECA kishin një kompjuter.

Kapaciteti për të përpunuar të dhënat e transferuara nga institucionet e tjera u zhvillua në fillim të viteve nëntëdhjetë. Përpunimi i të dhënave është ofruar nga Informatika si një shërbim. Me zbatimin e një metodologjie për Deklaratën e Sigurimit (të njohur si DAS) në vitin 1994 ky aktivitet u rrit dhe u prezantua programi i parë i marrjes së kampionëve, MUS (Sampling Monetary Unit). Sfida ishte për të matur matematikisht madhësinë e kampionit, si një funksion i shkallës së gabimit.

Fundi i shekullit u shënuar me vendimin për të marrë Sistemin e Mbështetjes së Auditimit, për të përmbushur një sërë ambiciesh: zgjerimin e njohurive, përmirësimin dhe standardizimin e dokumentacionit të auditimit, automatizimin, lëvizjen më të lehtë për audituesit, procedurat e menaxhimit të kontrollit të cilësisë dhe planifikimin e standardizuar. *Asysst* (asistenti), një aplikacion i bazuar në platformën bashkëpunuese “*Lotus Notes*”, u përzgjedh dhe u fut në prodhim në janar 2003.

Për shkak të pranimit të kufizuar të tij, në vitin 2010 ECA vendosi të zhvillojë mjetin e vet dhe në vitin 2013, u aplikua modul *Asysst 2*. Edhe pse përdorimi i tij për SoA (Deklarata e Sigurimit) është bërë e detyrueshme, përdorimi për auditimin e performancës është i kufizuar, për shkak se sistemi nuk ka fleksibilitetin e kërkuar.

Një tjetër arritje e madhe e ECA është dixhitalizimi i proceseve administrative dhe të auditimit që lejojnë fleksibilitet në një vend pune, duke lehtësuar punën e largët dhe *teleworking*. Bazuar në paradigmen e re kurdo, kudo, për çdo gjë, gjatë periudhës 2010-2017 u ndërmor një reformim dixhitalizimi për proceset më të rëndësishme administrative. Si rezultat, kërkesat, faturat, etj... të gjitha, më shumë se 50 000 forma letre në vit u zëvendësuan nga një udhërrëfyes elektronik. Me iniciativat e saj plotësuese, “*laptopë për të gjithë dhe internet kudo*”, së bashku me një akses të plotë, ECA u bë lider në mesin e institucioneve “të shkathëta” evropiane.

Për më tepër, është duke u zhvilluar një zgjidhje e re për qasje të largët për të lehtësuar modelin *BYOD* (Bring Your Own Device/Sillni kompjuterin tuaj). Ky do të jetë një instrument kyç i Planit të Punës së ECA, pasi do të lehtësojë qasjen në burimet kyçe të IT-së, nga çdo pajisje (laptop, tabletë, telefon), duke përfshirë pajisjet private.

Të gjitha këto janë mbështetur nga një infrastrukturë moderne dhe elastike. Një qendër e re e të dhënave dhe një rrjet i ri u implementuan, pas ndërtimit të ndërtesës K3. Kjo është bërë për të vazhduar dixhitalizimin dhe për të transformuar proceset e letrës, duke nxitur lëvizjen dhe *teleworking*.

### Sfidat e mëdha

Parimet e qeverisjes të miratuara në vitin 2010, ndihmuan IT dhe auditimin për të bashkëpunuar në zbatimin e shërbimeve kryesore. Megjithatë, siç u përmend më parë, ende mungon një vizion i qartë i potencialit të IT për auditim. Fakti që bota e sotme është gjithnjë e më shumë dixhitale, se qeveria po shndërrohet në *e-qeverisje* dhe se “gjërat” do të përfaqësohen në formë elektronike, nuk merren parasysh mjaftueshëm. Një përkufizim i qartë i roleve dhe përgjegjësisve të ndara në mes të auditimit dhe organizimit IT, e cila ka një peshë strategjike, mbetet një sfidë.

Për të kryer punën e saj të auditimit, ECA duhet të ketë qasje në bazën e të dhënave, veçanërisht në Komisionin Europian. Nevoja për një zgjidhje për të pasur qasje në këto të dhëna tashmë është shprehur qartë në vitin 1987: “*Negociatat do të ndërmerren me Komisionin për të vendosur të drejtën e pakufizuar të Gjykatës për qasjen në informacionet financiare dhe të menaxhimit të mbajtura në dosjet magnetike. Informacioni do të përpunohet me softuer të përshtatshëm*”. Realiteti është se, ende sot, negociatat trajtohen sipas rastit. Nuk është arritur një zgjidhje globale për problemin e qasjes në sisteme.

Pasi ECA është një organizatë e bazuar në njohuri, shpërndarja e dijes së akumuluar është një proces bazë që mund të përfitojë rrënjësisht nga dixhitalizimi. Prandaj, sistemet e dokumentacionit të auditimit, mjetet bashkëpunuese, sistemet e fuqishme të kërkimit të ndërmarrjeve dhe aftësitë e pasura të Intranetit dhe internetit duhet të bëhen instrumente thelbësore për audituesit. Për më tepër, do të sigurohet një portal i fuqishëm dhe i njohur për njohuri që sjell vlerë të shtuar në auditim. Zbatimi i një sistemi integral të menaxhimit

të dokumenteve ka qenë objektivi që nga viti 1996. Megjithatë, disa përpjekje kanë dështuar dhe është ende një sfidë për të ofruar një proces dixhital dhe të integruar nga fundi në fund për të mbuluar ciklin e plotë të dokumentit, duke përfshirë nënshkrimin elektronik, autorizim elektronik dhe arkivimin.

### E ardhmja: një auditim tërësisht digjital

Planet e ardhshme për IT në ECA duhet të marrin në konsideratë strategjinë e publikuar kohët e fundit, 2018-2020. Qëllimet janë për të përmirësuar gamën e produktit duke rritur vlerën e shtuar të Deklaratës së Sigurimit në kontekstin e menaxhimit financiar të sotëm, për t'u përqendruar në aspektet e performancës së veprimeve të BE-së dhe për të prodhuar mesazhe më të qarta për audienat e ECA-së.

Frymëzuar nga këto qëllime, tani është duke u përgatitur një plan i ri IT. Plani duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë kapacitetit të IT-së për të transformuar funksionin e auditimit.

Është e qartë se ndërsa bota bëhet gjithnjë e më dixhitale, këtë transformim po pëson edhe auditimi. Bëhet fjalë për qasje në të dhëna, të dhëna të mëdha dhe të dhëna të hapura; e njëjta analizë që mbështet identifikimin e zonave të riskut do të kontribuojë gjithashtu në vlerësimin e zbatimit të politikave. Kombinimi i një larmi burimesh të të dhënave, duke përfshirë të dhëna të mëdha, do të lejojë përfitime në të kuptuarit e çështjeve ndërsektoriale. Teknologjitë që eksplorojnë gjuhën natyrore, tekstin dhe të mësuarit në makinë, do t'u japin liri audituesve për të deleguar "*funksionet e leximit*" tek kompjuterët në mënyrë që ata të përqendrojnë përpjekjet e tyre në planifikimin dhe interpretimin.



Gjenerimi i besimit do të kërkojë komunikimin me palët e internist në një formë më bindëse. Këtu përsëri, vizualizimi i të dhënave do të lejojë prezantimin e sasive të mëdha të të dhënave në tabela të thjeshta dhe të kuptueshme, duke lehtësuar interpretimin për të lejuar përdorimin e tij si dëshmi të fakteve të vërejtura.

Aftësitë e fuqishme të auditimit të IT-së duhet të garantojnë që burimet e të dhënave të jenë të besuara, relevante dhe të besueshme. Kjo mund të arrihet vetëm nga ekipet multidisiplinare, ku ekspertët IT, shkencëtarët e të dhënave dhe audituesit punojnë së bashku gjatë gjithë hapave të procesit të auditimit.

Sponsorizimi nga menaxhimi i lartë dhe menaxhimi i mirë i palëve të interesuara, për të përfshirë të gjithë aktorët në zhvillimin e proceseve dhe sistemeve të reja, janë faktorët kryesorë të suksesit. Strategjia e re e ECA është guri themeltar për këtë realitet të ri.







## 5. ECA E PARË NGA JASHTË

---



## DR ARŪNAS DULKYS, AUDITOR I PËRGJITHSHËM I REPUBLIËS SË LITUANISË

### DËSHMI

#### 40 vjet histori: datat, njerëzit, bashkëpunimet



Audituesi i Përgjithshëm i SAI-t të Lituanisë, Dr Arūnas Dulkys (majtë) në takim me Presidentin e ECA, Klaus-Heiner Lehne, 2016

Vitet ndoshta nuk janë mënyra më e mirë e matjes së performancës apo rezultateve të një institucioni. Sa për njerëzit, përvjetorët për institucionet janë si pikë referimi, që përdoren për të pasqyruar momentet më të bukura të jetës së tyre dhe për të uruar të gjithë të mirat për të ardhmen. Me kalimin e viteve datat zbehet - duke u bërë të njëjlojta dhe më pak të dukshme- por ne i theksojmë ato për t'i dhënë çdo date vlerën dhe sukseset e veta, të arritura nga aspiratat, puna dhe rezultatet tona. Njerëzit që kemi takuar në të kaluarën na ndihmojnë të kujtojmë datat dhe ta bëjmë historinë tonë si njerëzore ashtu edhe kuptimplotë.

Për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Lituanisë (NAOL), bashkëpunimi zyrtar me Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA) daton me Deklaratën e Luksemburgut të nënshkruar më 23 tetor 1996, e cila përcaktoi objektivat e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit të Vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore si dhe ECA.

Vitet e anëtarësimit të Lituanisë në Bashkimin European (u anëtarësua në BE në 2004) u shënuan nga një kalendar intensiv aktivitetesh që synojnë forcimin e kapaciteteve të institucioneve kombëtare për zbatimin e *acquis communautaire*. Rolet e reja të institucioneve shtetërore kërkonin një mandat të duhur për NAOL.

Mes datave "të para" për t'u kujtuar - Shtatori i vitit 2001 ishte vizita e parë e Presidentit të atëhershëm të Gjykatës Evropiane të Audituesve, Z. Jan O. Karlsson, tek NAOL. Koha e vizitës përkonte me diskutimin e projektligjit të ri për Zyrën Kombëtare të Auditimit në Seimas (Parlamentin), dhe ne kishim nevojë për mbrojtje dhe përkrahje të fortë kombëtare dhe ndërkombëtare për të demonstruar avantazhin e konceptit të ri të auditimit mbi metodën tradicionale të kontrollit. Miratuar më 13 dhjetor 2001, Ligji për Zyrën Kombëtare të Auditimit prezantoi pavarësinë për NAOL, respektimin e standardeve të INTOSAI-t dhe i dha atij një mandat për auditimet e para të performancës. Parimet kryesore të ligjit janë ende të vlefshme.

Ne i kemi përjetuar personalisht çka do të thotë për një institucion të auditimit kombëtar në zhvillim që të mbështetet nga një institucion tjetër i fuqishëm profesional dhe i pavarur i auditimit si ECA. Një ndihmë e tillë është me rëndësi të madhe në periudhën kur hapat e parë janë bërë për leximin paraprak dhe zbatimin e standardeve të pranuar

ndërkombëtarisht, duke përfshirë auditimet e para të performancës, duke ndërtuar vetëbesim në këtë lloj auditimi dhe duke inkurajuar besimin tek publiku i gjerë.

Pasi kemi grumbulluar këtë eksperiencë të paçmueshme, tani duam ta shkëmbejmë atë me institucionet e tjera të auditimit që janë në një situatë të ngjashme, për t'i ndihmuar ata të bëjnë hapat e parë të tyre të vështira drejt sistemeve të auditimit profesional. Mbështetja që kemi marrë nga ECA në krijimin e një sistemi profesional të auditimit publik është duke u transformuar – tanimë, ne vetë ofrojmë asistencë në forcimin e sistemeve të auditimit publik si në Evropë dhe në nivel global.

Që nga kontakti i parë midis NAOL dhe ECA ka pasur komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Vitet pas takimeve të para u shënuan nga një shkëmbim më intensiv i drejtuesve dhe audituesve të institucioneve, veçanërisht pas anëtarësimit në BE, kur çështjet e auditimit të lidhura me BE u bënë një objektivi i përbashkët e gjithnjë më i nevojshëm për bashkëpunim profesional.

Aderimi në BE nxiti zhvillimin e sistemit të auditimit në vendin tim. NAOL u zhvillua me shpejtësi, ai "përthithte" të gjithë informacionin, pasi vendosmëria jonë për t'u bërë institucion profesional i pavarur, me të gjitha përfitimet që sjell kjo, ishte më i madh se frika jonë ndaj gabimeve.

Pavarësia e institucioneve më të larta të auditimit dhe roli i kontrollit parlamentar ishin ndër çështjet e diskutuara me parlamentarët lituanë gjatë vizitës në 2006 të z. Hubert Weber, kryetar i ECA dhe anëtar i parë i ECA nga Lituania, znj. Irena Petruškevičienė, tek NAOL të kryesuar nga Auditori i Përgjithshëm, znj. Rasa Budbergytė.

Një ekip gjithëpërfshirës dhe aktiv i NAOL-it bëri të mundur miratimin e ndryshimeve të shpejta në legjislacionin kombëtar dhe në të gjithë kuadrin institucional. Kjo çoi në aplikimin e drejtpërdrejtë dhe të suksesshëm të standardeve ndërkombëtare në auditim, si dhe krijimin e një baze metodologjike dhe kompetence për auditimet e performancës brenda një periudhe të shkurtër kohore. Sot kemi prova të qarta se rezultatet e këtyre zhvillimeve po ndryshojnë praktikën e vendosur në vend, si dhe kontribuojnë në menaxhimin dhe përdorimin me efikasitet të buxhetit të shtetit.

Vizita në vitin 2014 nga një delegacion i ECA i udhëhequr nga Presidenti, Vítor Manuel da Silva Caldeira, pranë NAOL, i kryesuar në atë kohë nga Audituesi i Përgjithshëm, Znj. Giedrė Švedienė, kontribuoi shumë në shkëmbimin e ideve për zhvillimin e mëtejshëm dhe forcimin e bashkëpunimit midis NAOL dhe ECA. Ne e konsiderojmë këtë vizitë të rëndësishme, pasi planifikimi i auditimit të NAOL u përqendrua më shumë në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Evropiane 2020 dhe në adoptimin e tyre në dokumentet kombëtare.

Kur vështruam fushat e gjera të auditit, të anketuarit u shprehën se teknologjia drejtonte punën e tyre. Në përgjigje të ligjeve, standardeve, teknologjive dhe pritshmërive të reja dhe në zhvillim të palëve të interesuara, auditues profesionistët – qoftë në sektorët publik apo privat - u shprehën se planifikojnë të përmirësojnë dijen e tyre teknike, të zgjerojnë të kuptuarit e tyre ndaj teknologjive në zhvillim dhe vënien në zbatim të tyre në auditim, dhe të shtojnë aftësitë e tyre ndër personale – duke mbajtur ndërkohë standarde të larta etike, pavarësi dhe skeptizëm.

Dhe në sektorin publik një nga pikat kryesore është nevoja për qartësi në raportimin financiar dhe në funksionin e auditimit – kjo doli e 14-ta nga 50 në studimin tonë “50 Drejtuesit e Ndryshimit në Sektorin Publik”<sup>53</sup>.

Çka ishte gjithashtu e qartë nga ky raport ishte rëndësia e dallimit ndërmjet funksionit të auditimit dhe funksionit të raportimit financiar. Të dyja kanë një rol thelbësor duke i siguruar përgjegjësi më të madhe qytetarit: përgatitja e llogarive rritet duke kryer një rishikim auditimi të pavarur mbi to.

**Në vitin 2015, ECA mori statusin e punëdhënësit të miratuar ACCA (Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar). Çfarë përparësish i sjell kjo Gjykatës, ACCA-s apo më e rëndësishme, studentëve të cilët punojnë në Gjykatë?**

**Maggie McGhee:** Urime për statusin Punëdhënës i Miratuar!

Të jesh punëdhënës i miratuar në ACCA është një distinktiv nderi dhe një shenjë e qartë tek punonjësit dhe bota e jashtme, që si një punëdhënës ti punon me ACCA-n për të trajnuar dhe zhvilluar standardet më të larta financiare.

Programi ynë me punëdhënësit ndihmon në forcimin e standardeve të larta për punonjësit dhe më pas i mbështet ata gjatë gjithë rrugëtimit të tyre në ACCA.

Gjithashtu, do të thotë se, si punëdhënës takohesh me pika referimi globalë për përsosmëri në trajnim dhe mbështetje. Do të thotë gjithashtu se punëdhënësit tuaj, studentët ACCA ose anëtarë me një punëdhënës të miratuar nuk kanë pse të detajojnë dëshmitë e tyre të trajnimit apo detyrimet e tyre vjetore – Zhvillim i Vazhdueshëm Profesional (CPD). Kështu krijohet më shumë kohë për tu fokusuar në punën e tyre të përditshëm.

**Gjatë viteve, përfaqësues të ndryshëm të ECA kanë ndjekur aktivitetet e ACCA, për shembull, z. Lazarou, anëtari qipriot i ECA-së bëri një prezantim në konferencën e 3-të ndërkombëtare të Sektorit Publik në vitin 2011. Ka ndonjë**

---

<sup>53</sup> [http://www.accaglobal.com/content/dam/ACCA\\_Global/Technical/Future/pi-highlights-drivers-change-public-sector.pdf](http://www.accaglobal.com/content/dam/ACCA_Global/Technical/Future/pi-highlights-drivers-change-public-sector.pdf)

**aktivitet tjetër të rëndësishme, i cili mund t’u interesojë anëtarëve të gjykatës apo stafit?**

**Maggie McGhee:** Po, do të zhvillohen një numër aktivitetesh të tjera.

Do të më pëlqente shumë të mund t’i rendisja të gjitha këtu – por duke qenë se jemi në fazën e planifikimit nuk do të doja të premtoja shumë – por jemi shumë entuziastë që do të kemi përsëri një aktivitet global mbi sektorin publik këtë vit.

Këto aktivitete rezultojnë shumë të suksesshme dhe janë një mënyrë e shkëlqyer për të debatuar çështje/problematika dhe për të komunikuar. Po planifikojmë gjithashtu për të zhvilluar aktivitetin tonë *“Kontabiliteti për të Ardhmen”*, në fillim të muajit dhjetor 2017.

Dhe shumë e rëndësishme gjithashtu, kemi aktivitetin tonë të parë në ECA në 26 shtator, drejtuar nga Lazaros Lazarou, me fokus në *“Drejtesit e ndryshimit për sektorin publik: Afrimi i gjerive pranë qytetarëve dhe biznesëve në moshën digjitale përmes Etikës dhe besimit”*.

**Me stafin e kualifikuar të ACCA duke punuar në ECA dhe institucione të tjera europiane, ACCA mund të sigurojë informacione mbi tema të rëndësishme për Europën. A i kërkon pikëpamjet e stafit tuaj si një mënyrë për t’u njohur me ato çka ndodh në BE ?**

**Maggie McGhee:** Po, i kërkojmë pikëpamjet e tyre – jo vetëm për çështje që kanë të bëjnë me Europën, por me çështje globale gjithashtu që prekin profesionin.

Pikëpamjet e anëtarëve tanë janë thelbësore për të matur opinionin dhe për të kuptuar se si puna e tyre ndikohet nga politikat këtu në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Europë.

Ata shpesh ofrojnë argumente në mënyrë që ne të llojmë efektivisht. Ata gjithashtu na ndihmon të krijojmë pozita politike. Kemi pasur aktivitete për të sjellë së bashku anëtarë për të diskutuar Brexit dhe kemi anketuar anëtarësimin e Mbretërisë së Bashkuar me gjetje të cilat shpjegohen në këtë grafikë informuese<sup>54</sup>.

Ky konsultim me anëtarë dhe studentë dëshmoi se ata janë tepër të gatshëm të punojnë globalisht më shumë se ndonjëherë - kemi hasur një shqetësim në anketat nga qytetarët britanikë të cilët duan të jetojnë dhe punojnë në Australi, Zelandë të Re dhe Kanada, në javët që pasuan votimin e Brexit.

Gjatë kësaj kohe të pafund ndryshimi, është e rëndësishme të vazhdojmë dialogun në të njëjtën linjë me anëtarësinë tonë – të përditësojmë ata mbi çfarë po bëjmë në emër të tyre

<sup>54</sup> <https://infogr.am/the-impact-of-brexit-what-acca-members-think>

dhe të dëgjojmë opinionet e tyre – jo vetëm këtu në Mbretërinë e Bashkuar por në të gjithë Europën dhe padyshim në vende të tjera gjithashtu.

**ECA ofron një çmim vjetor për studentët që prezantojnë punë kërkimore mbi tema në lidhje me ECA-në. Mendoni se kjo do të jetë me interes për studentët ACCA-së?**

**Maggie McGhee:** Po, besoj se do të ishte me interes. Studentët tanë janë entuziast për të pjesë në të tilla evente. Për të përditësuar studentët mbi mandatin dhe veprimtarinë e ECA-s, mendoj se qasja më e mirë do të ishte një artikull në revistën tonë për studentët. Do të ishte një lexim interesant.

**Së fundi, si e shihni marrëdhënien midis ECA-së dhe ACCA-së në vitet e Ardhshme?**

**Maggie McGhee:** Kjo është një marrëdhënie shumë e rëndësishme dhe ne dëshirojmë ta shohim të rritet.

Puna jonë në Europë do të bëhet edhe më shumë e rëndësishme me fillimin e negociatave për Brexit. Anëtarët dhe llogaritarët ACCA të cilët punojnë në Europë do të jenë pjesë e këtij procesi.

Shumë nga çështjet rreth Brexit janë të paqarta, sidomos të drejtat e pasaportave, taksat, përputhshmëria dhe ndikimi i përgjithshëm në biznes.

Megjithatë, në mes të gjithë kësaj paqartësie është shumë e qartë që kontabilistët kanë një rol të vyer për të ndikuar në këshillimin e klientëve mbi implikimet tatimore dhe financiare si pasojë e tërheqjes sonë nga BE-ja. Transparenca në proces, dhe financat do të jenë jetësore dhe besoj se këtu është ku puna jonë në ECA do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme.

Dr INGEBOG GRÄSSLE, KRYETARE E KOMITETIT TË KONTROLLI TË BUXHETIT, MEP

## DËSHMI

### Vazhdimësia dhe ndryshimi ndërmjet institucioneve



*Dr Ingeborg Gräßle, kryetare e komitetit të kontrollit të buxhetit, MEP*

Mënyra më e mirë për të bërë ndryshime është për të marrë njerëz me ide të ndryshme rreth detyrave dhe mandateve. Në Parlamentin Evropian, ndryshimi është gjithmonë dramatik, sepse gjysma e parlamentarëve janë të reja pas çdo zgjedhjeje dhe gjithmonë kanë nevojë për dy ose tre vjet për t'u njohur me pyetjet komplekse të BE dhe kontrollin buxhetor. Kjo është arsyeja pse Gjykata është një lloj garantuesi i vazhdimësisë. Por këtu, gjithashtu, ka anëtarë të rinj - megjithëse në kohë të ndryshme. Ndryshimi ka ekzistuar gjithmonë në Gjykatë - aktualisht, ndoshta më shumë se më parë, sepse mirëkuptimi që ne të gjithë duhet të bëjmë më shumë me më pak është tani i pranishëm për të gjithë ata që janë përfshirë. Tatimpaguesi

evropian duhet të jetë në gjendje të mbështetet në faktin se Parlamenti, Gjykata dhe Këshilli të gjitha punojnë drejt trajtimit më të mirë të parave publike.

### Shembuj të vlerës së shtuar të ECA

Përveç produkteve standarde të ECA-së - Raporti Vjetor dhe raportet speciale - ekzistojnë gjithashtu "raporte të peizazhit" për fushat e politikave individuale ose problemet themelore. Kjo është një gjë e mrekullueshme për parlamentarët e rinj! Leximi i këtyre raporteve jep një vështrim të orientuar drejt problemit që mund të shpëtojë shumë orë leximi të dokumenteve të tjera. Produktet standarde janë me rëndësi të madhe: Raporti Vjetor i Gjykatës ofron një pasqyrë të mirë të cilësisë së operacioneve administrative në nivel të BE dhe në Shtetet Anëtare. Stafi i ECA-së sistematikisht analizon mijëra faqe të dokumenteve të Komisionit me një sy kritik. Komisioni për Kontrollin e Buxhetit vlerëson pikat kryesore të këtyre dokumenteve, prandaj Gjykata është një ndihmë e rëndësishme shtesë. Raportet e veçanta na japin një pasqyrë të mirëkuptuar sistematike të programeve dhe procedurave. Ato janë të domosdoshme për punën tonë dhe burimin më të mirë të informacionit në "dhomën e motorit" të Bashkimit Evropian. Nëse vërtet doni të dini se si funksionon (mirë) BE, nuk mund të jepni mendimin tuaj nëse nuk keni lexuar raporte të veçanta.

### Vizioni i bashkëpunimit të ardhshëm

Në 13 vjet që kam qenë anëtar i Komitetit të Kontrollit të Buxhetit, BE-ja jo vetëm që është bërë më e madhe, por edhe më e ndërlikuar. Kemi punuar shumë për çështjen e

llogaridhënies dhe kemi arritur shumë me mjete klasike. Fatkeqësisht, BE-ja ka fituar edhe "pika të bardha" të reja, të tilla si fondet e besimit dhe instrumentet financiare, për të cilat ne kemi nevojë për më shumë transparencë dhe njohuri. Shpresoj që Gjykata të bëjë sugjerime të qarta për legjislacionin e ri. Kjo mund të shpëtojë shumë telashe, mallkim dhe humbje.

Fokusi kryesor i auditimit po ndryshon dhe përfshin gjithnjë e më shumë aspekte jo-monetare

Unë e mirëpres ndryshimin në qendër të auditimit, dhe kjo gjithashtu i konsideron paratë e BE-së. Megjithatë, pres që "biznesi i bukës dhe gjalpë", domethënë auditimi i shpenzimeve dhe efikasitetit, të mbetet në qendër të punës së Gjykatës.

MARTINA DLABAJOVA, NËNKRYETARE E KOMITETIT TË KONTROLLIT BUXHETOR, APE

## DËSHMI

### Përvjetori i 40 i Gjykatës Evropiane të Audituesve



Martina Dlabajová, Nënkrjetare e Komitetit të Kontrollit Buxhetor (CONT), Anëtare e Parlamentit Evropian

Dyzet vjetët janë një moment historik si për një institucion, ashtu edhe për një individ. Në përgjithësi, moshë 40 vjeçare në jetën e njeriut është e lidhur ngushtë me diturinë e vërtetë dhe ekspertizën e fituar nga përvojat e jetës. Është gjithashtu një moshë ku një person i tillë po fiton gjithnjë e më shumë respekt dhe po bëhet një “i mençur në sytë e të tjerëve”. Për shumë vite, Gjykata Evropiane të Audituesve njihet si një institucion solid dhe profesional që promovon transparencën efektive, llogaridhënien publike dhe auditimin publik të financave të BE-së, një institucion që ndihmon në ndërtimin e një bashkimi të aftë për të treguar se si punon Europa për të arritur qëllimin e saj në promovimin e paqes, vlerave të saj dhe mirëqenien e qytetarëve.

Celebrimi i një institucioni nuk është më shumë festë se sa një rast solemn për t'u ndalur dhe për t'u kthyer prapa në kohë në këtë udhëtim dyzetvjeçar. Është një kohë për të reflektuar, për të matur prioritetet, por edhe për të bërë plane se si institucioni mund të kontribuojë më së miri në të ardhmen. Në një kohë presioni në rritje ndaj financave publike është më e rëndësishme se kurrë për të marrë maksimumin nga çdo Euro të shpenzuar. Institucionet e BE-së duhet të dërgojnë një sinjal të qartë për qytetarët e BE-së që fondet po përdoren në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, duke respektuar parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Është veçanërisht i rëndësishëm përmirësimi i vlerësimit tonë kolektiv mbi mënyrën e shpenzimit të fondeve. Kemi nevojë për një ndryshim mentaliteti në të gjitha nivelet, qofshin ato institucione apo shtete anëtare; ne nuk duhet të merremi vetëm me masat e gabimit, por të vlerësojmë vërtet vlerën e shtuar të investimeve tona: performancën dhe rezultatet e politikave të përbashkëta. Qasja e përgjithshme për përdorimin e fondeve nga buxheti i Komisionit Evropian duhet të bëhet një aspekt i fortë i integritetit evropian. Jo vetëm se për çfarë do të përdoret buxheti, por kryesisht sipas cilave rregulla dhe kritere do të kryhen shpenzime të tilla.

Për të arritur këtë dhe për të bërë një ndryshim të vërtetë drejt kësaj qasjeje të përdorimit të fondeve të BE-së, nevojitet një bashkëpunimi i drejtpërdrejtë më i fortë ndërmjet të gjitha institucioneve të BE dhe aktorëve të rëndësishëm të përfshirë në procesin buxhetor. Kontributi kryesor që jep Gjykata është padyshim ai përmes auditimeve dhe raporteve të veta që ndihmojnë subjektet e audituara të përmirësojnë menaxhimin

financiar si dhe asiston autoritetet mbikëqyrëse të zbatimit të buxhetit të BE. Jo vetëm si nënkryetare e Komitetit të Kontrollit Buxhetor (CONT) kam mundësinë të jem në kontakt të rregullt me Gjykatën dhe punonjësit e saj. Marrëdhëniet tona reciproke të mira bazohen në besimin e fortë, ndershmërinë dhe respektin që rezulton kryesisht nga një bashkëpunim i mirë në aprovimin e buxhetit për Komisionin për 2014, për të cilin unë u caktova si një raportuese e PE (Parlamenti European), si një nga autoritetet aprovuese. Nëse do të ktheheshim pas në kohë tani, ka qenë një vit historik, një trampolinë për një qasje të re auditimi. Deri atëherë, procedura e aprovimit të buxhetit dhe auditimi në nivel BE-je në përgjithësi i kishin dhënë më shumë peshë aspektit formal të menaxhimit, si p.sh. respektimit të rregullave ose statistikave të gabimeve. Vendosa ta ndryshoj këtë praktikë dhe të përqendrohem në kriteret e shpërfillura më parë të performancës aktuale të zonave të mbështetura nga buxheti i BE-së dhe në rezultatet e ndikimit e tyre në jetën e qytetarëve.

Duke dalë me një vizion ambicioz, isha tejet e lumtur që logjika e "buxhetit të fokusuar në rezultate" u mbështet në mënyrë të barabartë nga organet e tjera të BE-së dhe palët e interesuara, veçanërisht nga ECA dhe nga struktura e saj e re vjetore e raportimit që fokusohej tek performanca. Gjithmonë e kam menduar se jo çdo gabim i zbuluar në shpenzimet e buxhetit të BE-së është mashtrim, jo çdo gabim të çon në keqshpenzim dhe prandaj i jam shumë mirënjohëse ECA-s për raportimin e zbulimeve të gabimeve në raportet e saj të fundit vjetore.

Besoj se kjo është ajo për të cilën Bashkimi European ka nevojë. Është koha që BE të komunikojë arritjen e tij. Është koha për të gjetur një ekuilibër të ri midis qasjes së përputhshmërisë dhe asaj të performancës. Kur Komisioni shpenzon paratë e BE-së, përdor fondet e BE-së, është një çështje e përbashkët që nënkupton se paratë janë përdorur me synim arritjen e objektivave. Veçanërisht tani, në këto vite të trazuar për Evropën, të gjithë kemi detyrimin moral për të optimizuar përdorimin e burimeve dhe për të shmangur çdo humbje potenciale; ua detyrojmë këtë të gjithë qytetarëve të BE-së.

Me këtë rast, do të doja të falënderoja Gjykatën Europiane të Audituesve për punën e shkëlqyer në nxjerrjen e konkluzioneve bazuar në të gjitha të dhënat dhe informacionet relevante të mbledhura, ashtu sikurse për rekomandimet e propozuara. Është kryesisht falë raporteve të saj që puna dhe vendimet tona si politikëbërës të mund të bazohen në evidenca. Jo vetëm që duhet të gjejmë gabime për t'u korigjuar, por gjithashtu duhet të mësojmë t'i përgjigjeni më mirë të ardhmes, në mënyrë që të njëjtat gabime të mos përsëriten. Gjithashtu, na ndihmon të përcaktojmë objektiva realiste dhe të arritshme për të mbështetur qëndrueshmërinë në alokimin e buxhetit të BE-së.

Së fundmi, do të doja të falënderoja Gjykatën Evropiane të Llogarive për bashkëpunimin dhe ndihmën e madhe që më është dhënë mua dhe kolegëve të mi nga Parlamenti European. Bashkëpunimi i hapur dhe shkëmbimi aktiv i informacionit është një përfitim i madh për ne dhe shpresoj që kjo marrëdhënie do të nxitet dhe ushqehet edhe më tej në të

ardhmen. Gjithmonë kam vlerësuar pikëpamjet e ndryshme të Gjykatës dhe anëtarëve të saj dhe do të vazhdoj të bëj përpjekjet e mia maksimale për të bashkëpunuar me Gjykatën dhe institucione të tjera për të shqyrtuar performancën më të lartë të mundshme dhe vlerën e shtuar të buxhetit Evropian.

Për përvjetorin e saj të 40-të, dua të uroj Gjykatën të vazhdojë me punën e saj të shkëlqyer, duke fituar gjithnjë e më shumë respekt për të përmirësuar më tej llogaridhënien e BE-së dhe institucioneve ndaj qytetarët të saj. Unë besoj se vetëm përmes shkëmbimit të praktikave të mira dhe marrja e mësimëve nga gabimet e kaluara në të gjitha Shtetet Anëtare, mund të konsolidojmë vlerën e shtuar evropiane sipas thënies “Të Bashkuar në Diversitet”.



## LAZAROS S. LAZAROU, ANËTAR I ECA-S PËR RAPORTIMIN VJETOR

### Dëshmi

#### Vitet pas raportimit vjetor

"Det er vanskeligt at spaa, isar naar det galder fremtiden"<sup>1</sup>



Lazaros S. Lazarou, Anëtar i ECA-s

Në përkujtimin e përvjetorit të 35-të të ECA-s, Giorgio Clemente (Anëtar i ECA-s, 1993-2006, nga Italia) na udhëhoqi gjatë dhjetë viteve të para të Deklaratës së Sigurisë së ECA-s<sup>2</sup>. Për përvjetorin tonë të 40-të do të doja t'ju njihja me disa pikëpamje për të ardhmen e raportit tonë vjetor, *edhe pse është e vështirë të bësh parashikime, sidomos për të ardhmen*.<sup>3</sup> Ky artikull përfshin pikëpamjet personale dhe nuk është (domosdoshmërisht) përshkrim i politikave (të ardhshme) të ECA-s.

Duke zbatuar standardet dhe udhëhequr sipas shembullit, ne ofrojmë një bazë të mirë për ...

Si kolegë dhe si staf, ne bashkojmë vërtet prejardhje të ndryshme në ligj, kontabilitet, auditim, gjuhë dhe kulturë. Së bashku, ne jemi auditues të pavarur të BE-së, duke u dhënë siguri qytetarëve të BE-së mbi financat e saj. Për t'u siguruar që puna jonë të jetë vlerë-shtuese, ne duhet ta vendosim atë në një kontekst përgjithësisht të pranuar dhe të kuptuar mirë. Duke zbatuar standardet ndërkombëtare të auditimit, duke u referuar atyre në opinionin tonë të auditimit<sup>3</sup>, ne punojmë në këtë kontekst të rëndësishëm. Duhet të tregojmë se jemi shembullorë dhe se puna jonë zhvillohet sipas standardeve. Në këtë mënyrë do të mund *"të ndihmojmë qytetarët e BE-së, nëpërmjet auditimeve të pavarura, të gjykojmë nëse mund t'i besojnë institucioneve të BE-së që ato të vendosin në emër të tyre"*<sup>4</sup>, ashtu sikurse përcaktohet në strategjinë tonë 2018-2020. Në auditimet tona do të përdorim punën e të tjerëve si burim të evidencave të auditimit, kudo që të jetë e mundur dhe që sjell efektivitet në kosto.

Kemi aplikuar standardet ndërkombëtare të auditimit dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë. Me ECA-n që mban postin e nënkryetares së Komitetit të Standardeve Profesionale të INTOSAI-t<sup>5</sup>, ne do të kontribuojmë më tej në zhvillimin e standardeve dhe në mbledhjen dhe shpërndarjen e praktikave të mira.


... duke përçuar mesazhin tonë...

Të paturit e një baze shembullore për punën tonë, është parakusht për përçimin e mesazheve tona. Raporti ynë vjetor hartohet duke ua raportuar Anëtarëve<sup>6</sup> që ndihmohen nga ekspertët tanë të politikave / auditimit dhe duke u përdorur nga komitetet e

specializuara në Këshill dhe Parlament. Raporti ynë vjetor mbulon një audiencë të gjerë në shtypin evropian. Anëtarët e ECA-s prezantojnë dhe diskutojnë raportin tonë vjetor dhe raportet e veçanta në parlamentet kombëtare dhe kjo e rrit më tej jehonën e tyre. Megjithatë, nuk duhet të jemi të kënaqur me atë që kemi arritur deri më tani. Duhet t'i shtojmë përpjekjet tona. Raportet tona duhet të jenë të qarta dhe koncize, duke paraqitur pamjen ashtu siç është dhe në një mënyrë të ekuilibruar. Procesi ynë i punës është akoma i orientuar sipas dokumenteve; ne shkruajmë me qëllim që të publikojmë raporte si dokumente. Raporti ynë vjetor me mbi 50.000 fjalë<sup>7</sup> dhe ai i shkurtuar i BE-së (15.000 fjalë / 60 faqe)<sup>8</sup> nuk përshtatet lehtësisht në ekranin e faqes *web* ose *tablet-it*<sup>9</sup>. Duhet të shqyrtojmë mënyra të tjera për të përcjellë mesazhin tonë. Për shembull, duke i bërë mesazhet tona më të dukshme, duke u siguruar akses të lehtë përmbledhjeve dhe udhëzuesve të rekomandimeve tona.



*Numri i raporteve speciale të ECA-s po rritet*




*(Burimi: Raporti vjetor i vitit 2016, Kapitulli 3)*

... me më shumë theks në performancë ...

Deklarata jonë e sigurisë (opinionin ynë i auditimit) ka qenë tradicionalisht baza e raportit tonë vjetor. Kjo deklaratë paraqet opinionin tonë mbi besueshmërinë e llogarive (auditimi financiar) dhe mbi rregullsinë e të ardhurave dhe pagesave (auditimi i përputhshmërisë). Ndërsa raportimi i mirë financiar dhe i pajtueshmërisë me rregullat është ende i rëndësishëm, të diturit nëse paratë e shpenzuara kanë arritur objektivat e politikave, po kthehet gjithnjë e më shumë në qendër të vëmendjes. ECA ka nisur procesin e vënies së theksit në performancë, siç tregohet (gjithashtu) në rritjen e numrit të raporteve të veçanta të ECA-s (grafiku) në dhjetë vitet e fundit.

Raporti vjetor u zhvillua së bashku me këtë. Kapitulli ynë mbi performancën po spikat gjithnjë e më shumë dhe, që nga viti 2014, kapitujt e menaxhimit kanë përfshirë një seksion për performancën. Do të na duhet ta zgjerojmë këtë edhe në pjesë të tjera të raportit vjetor, duke u ofruar përdoruesve tanë një tablo më të gjerë të shpenzimeve të BE-së.

... dhe duke ofruar një informacion të mëtejshëm mbi veprimin e BE-së në Shtetet Anëtare dhe rajonet



*Informacioni sipas vendit në Raportin Special 04/2017 - Mbrojtja e buxhetit të BE-së nga shpenzimet e parregullta: Komisioni përdori masa parandaluese në rritje dhe korrigjime financiare kohezive gjatë periudhës 2007-2013.*

Një zhvillim i mëtejshëm në këtë spektër është dëshira për të pasur më shumë njohuri mbi veprimet e BE-së në Shtetet Anëtare dhe rajonet. Me nisjen e programeve dhe shpenzimeve 2014-2020, përmirësimet e pritura në sistemet e kontrollit të menaxhimit duhet të na lejojnë të vlerësojmë mbikëqyrjen e Komisionit dhe të sigurojmë informacione mbi veprimin e BE-së në Shtetet Anëtare dhe rajone. Do të na duhet të fitojmë përvojë për të përgatitur analiza të forta dhe të rëndësishme.

Gjithashtu, performanca përkatëse e Komisionit, krahasuar me praktikën e mira, ka gjetur vendin e saj në raportet tona. Shembujt përfshijnë analizën në raportin e veçantë mbi qeverisjen e

Komisionit dhe në kapitullin e tretë të Raportit Vjetor të vitit 2016 mbi performancën e Komisionit dhe kuadrin e saj.

Në raportin tonë të veçantë mbi qeverisjen, ne rekomandojmë që Komisioni të shkojë drejt një raporti të integruar duke sjellë elemente të paraqitura tashmë në raporte të tjera dhe duke zgjeruar fushën e raportimit vjetor për të përfshirë raportimin jofinanciar, informacionin mbi aktivitetet gjatë vitit dhe arritjen e objektivave të politikave. Një

dokument i tillë i llogaridhënies së Komisionit duhet të paraqitet për auditimin e llogarive, në mënyrë që audituesi të mund të kontrollojë nëse informacionet e tjera janë në përputhje me llogaritë.

Si përfundim, raporti vjetor do të vazhdojë të evoluojë, duke e zgjeruar fushëveprimin e raportimit.

Raporti vjetor do të vazhdojë të evoluojë duke adresuar një fushë më të gjerë informacioni. Ne do të vazhdojmë punën tonë sipas standardeve dhe do të shqyrtojmë mënyra për të tërhequr interes të gjerë në gjetjet tona. Po ashtu dhe fusha e raportimit do të zhvillohet, duke përqendruar pikëpamjen tonë në performancë, duke dhënë informacione vend pas vendi. Do ta ndihmojmë Komisionin për të ecur drejt një qasjeje më të integruar të raportimit të saj. Në përvjetorin e ardhshëm të ECA-s do të vlerësojmë progresin në përgatitjen e raportit vjetor si një mjet më me vlerë të shtuar për qytetarët e BE-së.

### Shënime në fund

1 Citim i atribuar një Dane-i të panjohur, i përkthyer në gjuhën angleze: Është e vështirë të bëhen parashikime, sidomos për të ardhmen (burimi: <http://quoteinvestigator.com/2013/10/20/no-predict/>, Farvel Og Tak: Minder Og Meninger nga K. K. Steincke, (Farvel Og tak: Obsession en Tilvaerelse IV (1935-1939)), faqja e citimit 227, Forlaget Fremad, København. (Botues Fremad, Kopenhagen, Danimarkë).

2 Reflektime/Reflexions, Gjykata Evropiane e Audituesve, përvjetori i 35-të / Cour des comptes européenne anniversaire 35, fq. 24, [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/REFLECTIONS\\_35TH\\_ANNIVERSARY/Reflections\\_35anniversary.pdf](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/REFLECTIONS_35TH_ANNIVERSARY/Reflections_35anniversary.pdf).

3 Deklarata jonë e Sigurisë është opinionimi ynë i auditimit për besueshmërinë e llogarive dhe rregullshmërinë e të ardhurave dhe pagesave në themel të këtyre llogarive.

4 Nxitja e besimit përmes auditimit të pavarur - Strategjia e Gjykatës Evropiane të Audituesve për vitet 2018-2020, fq. 4.

5 <http://www.eca.europa.eu/en/Pages/NewsItem.aspx?nid=6289>.

6 Raporti vjetor miratohet nga Gjykata (Neni 11 i rregullave të procedurës së Gjykatës së Llogarive të Bashkimit Evropian dhe neni 64 (a) i vendimit të Gjykatës Nr. 38-2016 që përcakton rregullat për zbatimin e rregullave të procedurës së Gjykatës së Llogarive).

7 Raporti ynë vjetor i vitit 2015 për zbatimin e buxhetit përmbante rreth 50.000 fjalë, pa përfshirë *footnotes*-at dhe përgjigjet e Komisionit. Raporti ynë vjetor 2015 për aktivitetet e financuara nga fondet evropiane të zhvillimit (EDF-të) 8, 9, 10 dhe 11, përfshinin 5.200 fjalë pa përfshirë *footnotes*-at dhe përgjigjet e Komisionit. Publikimi në Gazetën Zyrtare i këtyre raporteve (<http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/annualreports-2015/annualreports-2015-EN.pdf>) duke përfshirë *footnotes*-at dhe përgjigjet e Komisionit ishte rreth 110.000 fjalë në një dokument prej 320 faqesh.

8 Raporti i shkurtuar mbi auditimin tonë të BE-së u botua së bashku me raportin vjetor të vitit 2012. Ai përmbledh dhe shpjegon gjetjet kryesore në raportet tona vjetore mbi zbatimin e buxhetit të BE-së dhe Fondet Evropiane të Zhvillimit. Raportet vjetore para vitit 2012 i shoqëronte një “shënim informacioni”.

9 Raporti i shkurtuar i auditimit të BE-së për vitin 2015 është i disponueshëm në versionin HTML: <http://eca-publications.eu/audit-in-brief/2015-annual-reports/> në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së.

GASTRON MOONEN DHE ANDREAS BOLKART, DREJTORIA E PRESIDENCËS, ECA

## DËSHMI

### Strategjia e ECA-s për vitet 2018-2020: Nxitja e besimit përmes auditimit të pavarur

Zhvillimi i strategjisë: një proces gjithëpërfshirës



*Gastron Moonen dhe Andreas Bolkart,  
drejtorja e presidencës, ECA*

Si audituese e jashtme e BE-së, misioni i ECA-së është të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit financiar të BE-së, për të promovuar llogaridhënien dhe transparencën dhe si një rojtari i pavarur i interesave financiare të qytetarëve të Bashkimit. ECA paralajmëron për risqet, ofron siguri, konstaton mangësitë dhe sukseset, si dhe u jep udhëzime politikëbërësve dhe ligjvënësve të BE-së sesi të përmirësojnë menaxhimin e politikave dhe programeve të BE-së dhe të sigurohen që qytetarët evropianë të kenë djepin për mënyrën se si po shpenzohen paratë e tyre.

Për të zbatuar misionin e saj, të arrijë ndryshime strategjike dhe të sigurojë një orientim të gjerë, ECA ka përdorur strategji shumëvjeçare që nga viti 2008. Strategjia 2008-2012 është ndjekur nga strategjia 2013-2017 dhe strategjia 2018-2020 u miratua nga anëtarët e ECA-s, fill pas u botua në Korrik 2017.

Zhvillimi i strategjisë u drejtua nga një grup pune i përbërë nga Presidenti i Anëtarëve të ECA-s Klaus-Heiner Lehne, Daniele Lamarque dhe Alex Brenninkmeijer (kryetar) si dhe Sekretari i Përgjithshëm, Eduardo Ruiz García. Grupi u mbështet nga Andreas Bolkart dhe Gaston Moonen. Ne përdorëm doracakun e planifikimit strategjik të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t.

Puna përgatitore për strategjinë e re filloi me një analizë të së ardhmes së mjedisit tonë. Kjo përfshinte tendencat aktuale dhe të pritshme të politikës së ardhshme të BE-së, zhvillimet në Menaxhimin financiar të BE-së, si dhe zhvillimet në mjedisin tonë profesional, siç janë metodat dhe teknologjitë e reja të auditimit.

Procesi i zhvillimit të strategjisë mbështetej shumë në konsultime, si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Nga jashtë, Gjykata u drejtohej anëtarëve të Parlamentit Evropian, përfaqësuesve të Shteteve Anëtare të BE-së, Komisionit Evropian, organizatave simotra dhe aktorëve jo-institucionalë, siç janë akademikët, *think-tanks*-at, OJQ-të dhe gjithashtu audituesit privatë. Janë marrë në konsideratë, gjithashtu, edhe çështje që rrjedhin nga

kontaktet tona të rregullta me palët e interesuara, të tilla si në kontekstin e aprovimit buxhetor të Komisionit Europian ose të ushtrimit vjetor të planifikimit të auditimit. Strategjia u diskutua në mesin e anëtarëve të ECA-s, përfshirë këtu seminarin e përvitshëm të Anëtarëve të 2016, si dhe gjatë tre raundeve të diskutimeve në grupe fokusi me stafin e ECA-s. Pjesëmarrja në këto grupe ishte e hapur për këdo dhe u reklamua brenda për brenda. Përveç kësaj, pati edhe një periudhë ekspozimi të brendshëm të dokumentit të draft- strategjisë.

### "Besimi", si faktor parësor

Në strategjinë e saj të re, ECA e identifikon periudhën 2018-2020 si tejet të rëndësishme për Bashkimin Europian, gjatë të cilës do të merren vendime të rëndësishme. Pasojat e krizës financiare, presioni i emigrantëve në kufijtë e BE-së, gjendja ndërkombëtare e sigurisë dhe sfidat e ndryshimeve klimatike kanë një ndikim në mënyrën sesi BE qeveriset në nivel rajonal, kombëtar, ndërqeveritar dhe ndërkombëtar. Zhvillimet në politikën e përgjithshme të BE-së, financimi i saj, gjithashtu duke marrë parasysh edhe *Brexit*-in, menaxhimi financiar i BE-së dhe mjedisi profesional i ECA-s paraqesin sfida të mëdha, por edhe mundësi për Gjykatën.

Përballimi me sukses i sfidave të Bashkimit Europian do të kërkojë informacion të qartë, të besueshëm dhe të aksesueshëm për qytetarin e BE-së për atë që është arritur me paratë e BE-së dhe ndërhyrje të tjera. Qytetarët duhet të jenë në gjendje të shohin se BE vepron me integritet, zbaton sundimin e ligjit, shpenzon paratë e taksapaguesve me kujdes, është e qartë në lidhje me objektivat e saj dhe arrin rezultatet që ka premtuar. Dështimi për t'u demonstruar qytetarëve europianë se sfidat e përbashkëta janë përmbushur dhe rezultatet pozitive janë arritur me paratë e BE-së sjell riskun që besimi i qytetarëve në BE të zvogëlohet.

ECA beson se është e vendosur për të ndihmuar në adresimin e këtyre sfidave dhe mundësive të qeverisjes së BE-së dhe të shpenzimeve të duhura të fondeve. Përmes auditimeve të pavarura, ECA mund të ofrojë një pasqyrë se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon në shpenzimet dhe veprimet e BE-së, të ndihmojë qytetarët e BE-së të vendosin nëse institucionet japin rezultate për ta dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në nxitjen e besimit në BE. Për ta realizuar këtë, auditimet e ECA-s duhet, gjithashtu, të lidhen me shqetësimet e palës së fundit të interesit, qytetarit europian. Kohët e fundit BE nuk ka të bëjë më me shifrat, por me njerëzit.

### Objektivat strategjike të ECA-s për vitet 2018-2020

Për të zhvilluar mundësi të reja dhe rritur shërbimin e saj ndaj shtetasve të BE-së, ECA ka identifikuar katër objektivat strategjike:

Qëllimi 1: Përmirësimi i vlerës së shtuar të Deklaratës së Sigurisë në kontekstin aktual të Menaxhimit Financiar të BE-së. Zhvillimet pozitive në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit i japin ECA-s mundësinë për t'i hedhur një vështrim të ri Deklaratës së Sigurisë (SoA). ECA, çdo vit, jep një opinion mbi besueshmërinë e llogarive të BE-së dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të tyre. Për qasjen SoA 2018-2020, ECA, ndërsa do të mbetet plotësisht konform standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik, do të vlerësojë mundësitë e përdorimit të informacionit mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë, të ofruar nga institucionet e audituara, duke përfshirë masat korrigjuese që ato kanë marre. Kjo do të çonte në zvogëlimin e testimit të drejtpërdrejtë të pagesave dhe rritjes së kosto-efektivitetit të punës së SoA-s. Në këtë kontekst, ECA do të marrë në konsideratë një rinovim më të gjerë të Raportit të saj Vjetor.

Qëllimi 2: Rritja e fokusit në aspektet e performancës së veprimit të BE-së. Përveç sigurimit të përputhshmërisë, një çështje tjetër kryesore për shumicën e qytetarëve të BE-së është nëse shpenzimet dhe veprimet e BE-së kanë çuar në rezultate të prekshme dhe nëse ndikimi është arritur në mënyrë eficiente. Në vlerësimin e performancës, ECA do të përqendrohet, për shembull, në: vlerën e shtuar të veprimit në nivel BE-je krahasuar, aty ku është e mundur, me veprimin në nivele të tjera; duke dhënë përgjigje të shpejta për pyetjet e ngutshme dhe të synuara mbi veprimin e BE-së; duke promovuar shembuj dhe praktika të mira në mënyrën se si fondet dhe politikat e BE-së janë zbatuar; duke dhënë informacione mbi dallimet gjeografike për të nxitur të mësuarit e ndërsjellë; duke vlerësuar cilësinë e sistemeve të parandalimit dhe zbulimit kundër mashtrimit dhe korrupsionit me fondet e BE-së.

Qëllimi 3: Marrja e mesazheve të qarta nga ECA tek audienca e saj. ECA mund të menaxhojë në mënyrë që të kontribuojë në besimin në BE nëpërmjet produkteve të saj vetëm nëse ato arrijnë tek palët e interesuara, duke filluar nga autoritetet politike mbikëqyrëse si Parlamenti Europian, tek qytetarët e BE-së. Veprime specifike të parashikuara për përcimin sa më të mirë janë: formulimi i mesazheve kryesore të qëndrueshme, identifikimi i çështjeve horizontale të bazuara në gjetjet në shumë fusha, si dhe ristrukturimi i tyre në të gjithë gamën e produkteve të ECA-s; shtimi i përpjekjeve për të krijuar një narrativë imponuese, me një strukturë të qartë dhe shmangien e zhargonit, me evidencat e mbledhura të auditimit dhe të dhënat e analizuar; komunikimi më i mirë i punës së planifikuar dhe asaj në kryerje e sipër, si dhe krijimi i produkteve informuese për të maksimizuar ndikimin e punës së ECA-s.

Qëllimi 4: Angazhimi i ECA-s në produktet e saj. Pas riorganizimit të kohëve të fundit si më fleksibël dhe e fokusuar në auditim, ECA synon të përdorë organizatën e saj të rinovuar për arritjen e tre qëllimeve të lartpërmendura. Kjo do të thotë, për shembull: përfitime më të mira nga njohuritë e stafit të saj, duke përmirësuar lidhjet dhe shkëmbimet midis stafit, por edhe me komunitetet e ekspertëve jashtë ECA-s; shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga teknologjia inovatore në punën e auditimit, sikurse optimizimi i përdorimit të të dhënave të mëdha dhe analizave të tekstit masiv; gjatë planifikimit të



punës së auditimit, të qenurit më i përgjegjshëm dhe fleksibël për zhvillimet në Bashkimin Evropian, duke marrë parasysh pesë fushat e politikave me prioritet të gjerë, të përcaktuara nga ECA për vitet 2018-2020.

### Çfarë vjen më pas?

Në ECA, zbatimi i strategjisë 2018-2020 tashmë ka filluar. Një grup teknik pune, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm, është duke punuar në një propozim të veçantë për të zbatuar qëllimin 1 sa i përket SoA-s. Kolegji i ECA-s do ta diskutojë këtë propozim në vjeshtën e vitit 2017 dhe, nëse miratohet, qasja e rishikuar do të zbatohet duke filluar me punën për Deklaratën e Sigurisë për vitin 2018.

Lidhur me të katër qëllimet strategjike, ECA ka miratuar një plan veprimi që identifikon aktivitetet specifike dhe ndan përgjegjësitë në gjithë sektorët e organizatës. Puna me këto aktivitete ka filluar tashmë ose është planifikuar për vitin e ardhshëm. Për më tepër, ECA do të përdorë ciklin e programimit të punës së saj vjetore për të planifikuar, ekzekutuar dhe monitoruar zbatimin e strategjisë së saj.

Strategjia 2018-2020 shërben, gjithashtu, për të ndikuar në mentalitetin e njerëzve në ECA, për të marrë në konsideratë se si secili individ mund të kontribuojë në arritjen e objektivave strategjike. Do të varet nga kontributi i gjithsecilit nëse strategjia do të shndërrohet në një realitet të prekshëm apo jo.

### Duke rritur performancën e BE-së



Viti 2017 shënon 40 vjetorin e ECA-s. Nëpërmjet Deklaratës së Sigurisë, raporteve të saj mbi performancën e programeve të BE-së, opinionëve mbi legjislacionin e propozuar dhe rritjes së vëmendjes ndaj risqeve të mundshme, ECA ka kontribuar në përmirësime të rëndësishme në menaxhimin financiar të BE-së gjatë dekadave të fundit. Si audituese e jashtme e BE-së, ajo zbaton dhe promovon llogaridhënien, transparencën, profesionalizmin, integritetin, paanshmërinë dhe reagueshmërinë. Kjo ka bërë të mundur që ECA të luajë një rol kyç në procesin e llogaridhënies së BE-së dhe të nxisë një qeverisje “që nxjerr mësimë”. Për të vazhduar me

këtë, ECA ka përditësuar objektivat e saj strategjike për të siguruar informacionet dhe të kuptuarit e proceseve komplekse të BE-së. Duke zbuluar se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon në shpenzimet e BE-së dhe veprimet e saj, ECA ndihmon në përmirësimin e mënyrës se si BE punon dhe konceptohet. Kjo do të kontribuojë në nxitjen e besimit në aftësinë e BE-së për të trajtuar sfidat aktuale dhe të ardhshme. Me

implementimin e strategjisë së saj të re, ECA synon të rrisë vlerën e shtuar për vendimmarrësit e politikave dhe qytetarët e BE-së.

Shih për tekstin e Strategjisë 2018-2020:

[http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/STRATEGY2018-2020/STRATEGY2018-2020\\_EN.PDF.pdf](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/STRATEGY2018-2020/STRATEGY2018-2020_EN.PDF.pdf)

**The Members of the European Court of Auditors since 1977**

Year	1977	1978	1979	1980	1981	1982	1983	1984	1985	1986	1987	1988	1989	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Belgium	Paul GANDY		Fernand HERBET		S. LORIE		Patrick EVRARD		Robert REYNOLDS		Karel PINXTEN																																				
Bulgaria													Nadejda SANDJEVA		Ivana IVANOVA																																
Czech Republic											Jan KRST		Jan GRUBER																																		
Denmark	Anne JENSEN		Rolf BIELOTTE		Ole WAERBØ		Jørgen HØRST		Martin Louis LEVINGS		Nora O'DONOGHUE		Günther GIBSON																																		
Germany	Alburt LECHT		Ludwig HAASE		Bernhard FRIEDMANN		Wolfgang von WEDEL		Harald MOCK		Klaus Heiner LEHNE		Johan PARIJ																																		
Greece											E. O'SHEA		Senta CAROFF																																		
Ireland	Michael MURPHY		Richard RYAN		Barry DESMOND		Maire GEORGEHAN-O'NEIL		E. O'SHEA		Senta CAROFF																																				
France	G. VITALIS		Stavros VALLAS		C. ANDROUPOPOULOS		Kiriaki HIRILOU		Kameli SARRAS		Nikolaos MELLINOIS																																				
Spain			Jaume SUBIRATS		Antoni CASTELL		J.M. FABRA VALLES		J. RAMALLO MASSANET		Baudilio TOMÉ MUSEVIZIA																																				
France	Pierre LEONG		Daniel STRASSER		Jean-François BERNICOT		Michele CRETIN		Bernard LAMARQUE		Naveen MATS																																				
Italy	Roberto ANGOLI		Giorgio CLEMENTE		Marilena VARI		Nikolaos KAZANIAN		Lazaros Stavros LADAROU																																						
Cyprus									Nikolaos KAZANIAN		Lazaros Stavros LADAROU																																				
Latvia									Igor LUDRIGS		Michailas KOCYUS																																				
Lithuania									Irena PETRUSKIVICIENE		Rasa BUDZIKYTE		Michailas KOCYUS																																		
Luxembourg	Marcel HERT		Maurice TROSS		François COLLING		Hansjörg GRIEN		Gejza HOLÁZ		Spatulos FADNAS		Indira GALE-PELZ																																		
Hungary									Gejza HOLÁZ		Spatulos FADNAS		Indira GALE-PELZ																																		
Hungary									Josef BOHNIČ		Luis GALÁN		Leo EDUCAT																																		
Holland									Maarten ENGWERDA		G. de VRIES		Alex BERENIKEMELER																																		
Netherlands	André NIDDELKOEK		Maarten ENGWERDA		Hubert WEBER		G. de VRIES		Alex BERENIKEMELER																																						
Romania									Hubert WEBER		R. WEGENER		Gábor HERCZ																																		
Poland									Hubert WEBER		R. WEGENER		Gábor HERCZ																																		
Portugal									José Carlos DECE ENRICE		Augustina KUBIK		Joanna WOKSZECHOWSKA																																		
Portugal	Carlos ROMERO		A. de SOUSA RIBEIRO		Walter Manuel da SILVA CALDEIRA		Dimitris ILEPIS		George PUFAN																																						
Romania									Walter Manuel da SILVA CALDEIRA		Dimitris ILEPIS		George PUFAN																																		
Bulgaria									Dimitris ILEPIS		George PUFAN																																				
Slovenia									Vajza A. ANTONČIČ		Milan Martin CVILJ		Samo JURE																																		
Slovak Republic									Vajza A. ANTONČIČ		Milan Martin CVILJ		Samo JURE																																		
Slovak Republic									Adriana BOLNAR		Ladislav BALCO																																				
Finland									Jan O. HANSSON		Olavi A. HISSILÄ		Vito ITALIA																																		
Sweden									Lars HERRENSTEN		H. G. WESSBÄCK																																				
United Kingdom	Sir Norman PRICE		John CAREY		John WIGGERS		David BOSTOCK		Phil WYNNE OWEN																																						

## Çfarë duam të arrijmë përmes Strategjisë 2018-2020

Kontribumi në nxitjen e besimit në BE;  
 ndihma në përmirësimin e funksionimit të BE-së;  
 ndihma në përmirësimin e të kuptuarit të BE-së;  
 dhënia e informacioneve mbi çfarë funksionin dhe çfarë jo në BE.

## Çfarë ndodh në strategjinë 2018-2020

Përcjellja e mesazheve të qarta tek të audituarit;  
 rritje e fokusit mbi aspektet e performancës së veprimit të BE-së;  
 përmirësimi i vlerës së shtuar të Deklaratës së Sigurisë;  
 angazhimi i organizatës në produktet tona.



### Kolegji i ECA-s nga Shtatori i vitit 2017

**Rreshti i katërt:** Juhan PARTS - Leo BRINCAT - Mihails KOZLOVS - Jan GREGOR - Rimantas ŠADŽIUS - João FIGUEIREDO - Ildikó GÁLL-PELCZ

**Rreshti i tretë:** Janusz WOJCIECHOWSKI - Oskar HERICS - Nikolaos MILIONIS - Danièle LAMARQUE - Phil WYNN OWEN - Bettina JAKOBSEN - Samo JEREB

**Rreshti i dytë:** Neven MATES - Iliana IVANOVA - Kevin CARDIFF - Ville ITÄLÄ - Baudilio TOMÉ MUGURUZA - George PUFAN - Alex BRENNINKMEIJER

**Rreshti i parë:** Hans Gustaf WESSBERG - Ladislav BALKO - Karel PINXTEN - Klaus-Heiner LEHNE (President) - Henri GRETHEN - Lazaros S. LAZAROU - Pietro RUSSO

## **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit

Gjykata Evropiane e Llogarive-40 vjet auditim publik :

1977-2017 / RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit ; red. Ina

Sokoli, Redi Ahmetllari. – Tiranë: KLSH, 2017

180f. ; 13.5x16.5 cm.

ISBN 978-9928-159-64-9

*Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), E-mail [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)*

*Seria: botime KLSH - 13/2017/80*

ISBN: 978-9928-159-64-9



Kontrolli i Lartë i Shetit

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3

Tiranë Tel/Fax 04/228485, Tel.04/251267

Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), E-mail [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)

Shtypur në Shtypshkronjën

"Classic Print"

